

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

**BOTIME TË VEÇANTA LXXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
Libri 32**

Gavril Dara (i Riu)

KËNGA E SPRASME E BALËS

**Transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme
nga Shaban Demiraj**



**PRISHTINË
2006**

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

**SPECIAL EDITIONS LXXV
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS
Book 32**

Gavril Dara (i Riu)

THE LAST SONG OF BALA

**Transcription and adaption into modern Albanian
by Shaban Demiraj**

Approved at the Meeting of the Section of Literature and Linguistics,
held on 8 December 2006, on the grounds of the reports of
academician Idriz Ajeti and academician Enver Gjerqeku

Editor: Eqrem Basha, secretary of the Section of Literature and Linguistics



**PRISHTINA
2006**

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

**BOTIME TË VEÇANTA LXXV
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
Libri 32**

Gavril Dara (i Riu)

KËNGA E SPRASME E BALËS

**Transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme
nga Shaban Demiraj**

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë
dhe të Letërsisë mbajtur më 8 dhjetor 2006, në bazë të recensionëve të
akademik Idriz Ajetit dhe akademik Enver Gjerqekut

Redaktor: Eqrem Basha, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë



**PRISHTINË
2006**

GAVRIL DARA (i Riu)

KËNKA E SPRASME

E

BALËS

Tuzës i Kjarënjëvet
çë rrëzoi varrit katrë qint vjeç
Vllamien e Arbrit
E e kallëxoi Qevarrivet e Europës
Ndë Kuventën e Berlinit
Si farë e mbiell
çë me motin u nkalloft
Këta kënk e llamies të moçëme
Gavrili i Darënjëvet
Kushëriu kushëriut
Naforisën

KËNGA E SPRASME E BALËS

Poemë e pabotuar e **Gavril Darës**

Petro Kiarës
Që ngjalli nga varri katërqindvjeçar
Vllamjen e Arbërisë
E ua kallëzoi qeverive të Europës
Në Kuvendin e Berlinit
Si farë e mbjellë
Që me kohën lulëzoftë
Këto këngë të Vllamjes së moçme
Gavrili i Darenjëvet
Kushëriri kushëririt
Ia kushton

PASQYRA E LËNDËS

Dy fjalë

Faqe

Hyrje:

- I. Kushtet historike, jeta dhe vepra e Darës.
- II. Analiza e veprës:
 - A. Brendia.
 - B. Vetat veprues (personazhet).
 - C. Veçoritë e veprës.
 - D. Gjuha e veprës
 - E. Literatura e përzgjedhur

Poema Kënga e Sprasme e Balës

Parathënëme t'arbëreshëvet.

Prapathënëme.

Pjesa e parë

- I. Bala.
- II. Përrallëza.
- III. Kënga e hënëzës.
- IV. Vasha e Lalës.

Pjesa e dytë

- I. Plaku.

Pjesa e tretë

- I. Humbja e kusarit.
- II. Kënga e zogut.

Pjesa e katërt

- I. Dita e Valkalit.
- II. Kënga e Beratit.

Fjalorth.

DY FJALË

Kur para më shumë se dyzet vjetësh vendosa të transkriboja dhe të përshtatja në shqipen e sotme veprën me vlerë të poetit të talentuar arbëresh, Gavril Darës (të Riut), u mbështeta kryesisht në botimin e Katanxaros të vitit 1906 si edhe në botimin e traskribuar të të ndjerit Prof. Ziaudin Kodra të vitit 1955. Por në këtë ndërkohë kam pasur mundësi ta krahasoj botimin e vitit 1906 me botimin pjesë-pjesë të kësaj vepre në të përdyjavshmen “La Nazione Albanese” të Anselmo Lorecchio-s gjatë vjetëve 1900-1903 e kohët e fundit edhe me fotokopjen e një dorëshkrimi të kësaj vepre, që Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e kishte sjellë disa vjet më parë nga Biblioteka e Kopenhagës. Nga këto krahasime doli se në botimin e vitit 1906 jo vetëm që mungonte përkushtimi i kësaj vepre për Petro Kiarën, por edhe se aty-këtu kishte ndonjë ndryshim jo të parëndësishëm të karakterit fonetik. Për këtë arsye dhe duke pasur parasysh edhe vlerën e madhe të kësaj vepre, e pashë të nevojshme që t’i rishikoj me kujdes botimet e mia të mëparshme duke përfshirë edhe atë të vitit 1991, të bërë nga Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. Dhe përmirësimet e bëra sidomos tekstit të transkribuar ishin të nevojshme. Por nuk është vënë dorë (qoftë edhe në formë shënimi) në Parathënien dhe Pasthënien e veprës si edhe në shënimet e vetë Autorit në fund të faqeve, kur ai ka shprehur ndonjë mendim të diskutueshëm. Edhe Hyrjen kushtuar këtij Poeti dhe veprës së tij e kam plotësuar më tej me të dhëna të reja mbi jetën dhe veprimtarinë

e tij si edhe me një analizë më të hollësishme të veprës dhe të gjuhës së saj.

Dhe shpresoj se ky botim i ri i përmirësuar do të shërbejë për ta bërë të njohur edhe më mirë veprën e këtij poeti të talentuar arbëresh, që studiuesja Erminia Tuttolomondo e quan me të drejtë *Un grande nell'ombra* [“Një i madh në hije”].

Shaban Demiraj

H Y R J E

GAVRIL DARA

I. Kushtet historike, jeta dhe vepra e tij

1. Gavril Dara (i Riu), një ndër shkrimtarët më të talentuar të arbëreshëve të Italisë, jetoi dhe punoi në një kohë të ngjeshur me ngjarje vendimtare për të ardhmen e Italisë, e cila para bashkimit të saj në një shtet të vetëm politik (1861) ishte e ndarë dhe e përçarë e pjesërisht ende nën sundimin e huaj. Në lëvizjen atdhetare të popullit italian, që gjeti shprehjen më të lartë në lëvizjen kryengritëse nën drejtimin e Garibaldit, u përfshinë edhe arbëreshët, të cilëve pushtimi i huaj në atdheun e ri italian, ku kishin gjetur strehë qysh prej disa shekujsh, nuk mund të mos u sillte ndër mend gjendjen e rëndë të dheut amë të të parëve të tyre, Shqipërisë, e cila aso kohe lëngonte ende nën sundimin shekullor të osmanllive. Në ndërgjegjen e arbëreshëve të Italisë, pra, gjatë shekullit XIX rëndonte dëshpërimi jo vetëm për gjendjen e mjeruar, në të cilën ishin katandisur nën sundimin despotik të Burbonëve, por edhe për gjendjen e pashpresë të Dheut të të parëve të tyre, për të cilin ruanin gjithnjë një mall të pashuar, të trashëguar brez pas brezi.

2. Rrethanat historike, që luajtën një rol vendimtar për zhvillimet e reja në letërsinë italiane sidomos gjatë shekullit XIX, nuk mund të mos ushtronin një ndikim të fuqishëm edhe mbi lëvizjen letrare të arbëreshëve të Italisë. Kjo lëvizje, që kishte nisur me botimin e veprës së Matrëngës më 1592, d.m.th. vetëm 37 vjet pas botimit të veprës së Buzukut (1555) dhe që kishte nxjerrë edhe disa poetë me vlerë gjatë shekullit XVIII, si Jul Variboba, Nikollë Keta e Nikollë Brankati, mori një

zhvillim të rëndësishëm gjatë shekullit XIX me krijimtarinë e frytshme të disa shkrimtarëve të talentuar. Në këtë rast nuk është fjala vetëm për një prodhimtari letrare më të pasur, por më fort për një ndryshim cilësor në përmbajtjen dhe në nivelin artistik të krijimeve letrare arbëreshe. Vendin e veprave kryesisht fetare dhe me një vlerë letrare relativisht të kufizuar filluan ta zënë gjithnjë e më shumë krijimet me përmbajtje laike-atdhetare dhe me një vlerë artistike të spikatur. Siç dihet, shenjën e parë për këtë ndryshim cilësor e dha De Rada me kryeveprën e tij *Milosaat* në vitin 1836. Kjo vepër e bukur romantike si edhe veprat e tjera të poetit të Makjit, në kushtet e reja historike, shërbyen si një nxitje e fuqishme dhe si një shembull frymëzues edhe për një varg shkrimtarësh të tjerë arbëreshë, si Gavril Dara i Riu, Santori, Serembja etj. E kjo lëvizje letrare ka luajtur pa dyshim një rol të rëndësishëm edhe për zhvillimin e një lëvizjeje të gjerë kulturore-shkencore ndër arbëreshët e Italisë. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, veprën e Vinçenc Dorsës, *Su gli albanesi* [“Mbi shqiptarët”] të vitit 1847, si edhe veprën madhore të Dhimitër Kamardës, *Saggio di grammatologia comparata siulla lingua albanese* [“Sprovë e një gramatike të krahasuar mbi gjuhën shqipe”] në dy vëllime, të botuar më 1864 dhe 1866.

3. Në këtë atmosferë frymëzuese, për krijimin e së cilës kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, u mbrujt edhe poeti Gavril Dara (i Riu). Natyrisht, në formimin shpirtëror të këtij poeti të talentuar një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe tradita e bukur kulturore e familjes së moçme të Darenjve, ku ai lindi dhe u rrit. Si i gjyshi, Gavril Darë Plaku¹, ashtu edhe i ati, Andrea Dara²,

¹ Gavril Darë Plaku (1765-1832), i diplomuar në drejtësi e mjekësi, është ndër mbledhësit e parë të këngëve popullore arbëreshe. Krijoi edhe ai vetë ndonjë vjershë në frymën e poezisë popullore. Prej tij na ka arritur një

kishin bërë një punë të madhe me mbledhjen e këngëve popullore të ruajtura brez pas brezi ndër arbëreshët (shih shënimet 1 dhe 2). Këto këngë popullore si edhe tradita familjare për të ruajtur gjuhën amtare të trashëguar brez pas brezi, kanë luajtur pa dyshim një rol vendimtar për të mbajtur të gjallë edhe në zemrën e Gavrilit të ri kujtimin dhe mallin e pashuar të arbëreshëve për Dheun e Arbrit dhe për të kaluarën e tij të lavdishme. E këtë kujtim dhe mall të pashuar për Dheun e stërgjyshërve ai u përpoq t'i shprehte aq bukur nëpërmjet poemës së tij sa të madhërishme aq edhe mallëngjyese, *Kënga e sprasme e Balës*, që mbetet një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe në përgjithësi

4. Gavril Dara lindi në katundin arbëresh Pallac Adrian të Sicilisë më 6 janar 1827. Si mbaroi kolegjin italo-arbëresh të Palermos më 1846, vazhdoi studimet e larta në degën e drejtësisë të Universitetit të Palermos, ku u diplomua në vitin 1849. Shërbeu disa vjet si jurist në qytetin Xhirxhenti [Agrigento], ku në vitin 1858 drejtoi edhe gazetën letrare-artistike “Palingenesi”. Por Gavril Dara, ashtu si arbëreshët e tjerë, rritur dhe edukuar në Itali, nuk mund të mos përjetonte edhe shqetësimet dhe idealet e popullit italian, që aso kohe pjesërisht vuante ende nën sundimin e huaj. Prandaj ai mori pjesë gjallërisht në lëvizjen revolucionare të udhëhequr nga Garibaldi për çlirimin dhe bashkimin e Italisë në një shtet të vetëm, duke bërë pjesë në Komitetin Revolucionar të qytetit Xhirxhenti të Sicilisë (1860).

vjershë e bukur kushtuar *Lazërit*, për të cilin kanë shkruar edhe poetë të tjerë arbëreshë, të njohur e të panjohur (shih Skirò: 1923).

² Andrea Dara (1796-1872), i diplomuar në drejtësi, vazhdoi punën e t'et (shih shënimin 1) për mbledhjen e këngëve popullore, të gojëdhënave etj. dhe ka lënë gjithashtu edhe shkrime të vetat, të pabotuara.

Pas fitores së Revolucionit shërbeu në funksione të ndryshme administrative, kryesisht si nënprefekt në qytetet Bobbio, Aosta etj. e më 1867 u emërua prefekt i Trapanit, ku qëndroi dy vjet. Në vitin 1871 shkoi në Firence e pastaj në Romë, ku drejtoi për dy vjet të përkohëshmen “La Riforma”. Vjetët e fundit i kaloi në varfëri në Xhixhenti, ku vdiq më 1885, në moshën 59-vjeçare, i nderuar për kulturën e gjerë dhe për karakterin e tij të lartë.

5. Gavril Dara (i Riu) nuk u mor vetëm me drejtësi e me gazetari. Ai kishte një dëshirë të zjarrtë për t’u marrë edhe me krijimtari letrare, sidomos me poezi, e për këtë dëshmojnë shkrimet e tij të shumta. Ai i kishte dhënë shenjat e para të frymëzimit poetik qysh kur ishte ende nxënës në Kolegjin e Palermos. Dhe me krijimtari letrare u mor gjatë tërë jetës. Shumica e shkrimeve të tij janë në gjuhën italiane, por për këto nuk është rasti të ndalemi këtu; të interesuarit mund të konsultojnë veprën e Erminia Tuttolomondo-s të vitit 1921 me titullin *Un Grande nell’ombra* [“Një i madh në hije”], ku bëhet një analizë mjaft e hollësishme e atyre shkrimeve. Këtu po mjaftohemi të shënojmë se vetëm një pjesë e vogël e atyre shkrimeve u botuan me gjallje të Darës³ dhe një pjesë tjetër mbetën pa u botuar⁴. Ndër këto të dytat është edhe kryevepra e tij, poema *Kënga e sprasme e Balës*. Të kihet parasysh se, siç ka shënuar vetë Dara në Parathënien e kësaj vepre, këtë poemë ai më parë e përktheu italisht në vargje të rregullt e më pas i bëri

³ Të tilla janë: 1. *I nostri mali* “Të këqiat tona”, epistul në strofa treshe. Firenze 1870. 2. *Non plus ultra*. epistull në strofa treshe (Firenze 1871). 3. *Francesca da Rimini* - tragjedi lirike (Girgenti 1878). 4. *Un’escursione sulle Alpi* “Një ekskursion në Alpet” 5. *Lettera sulla topografia d’Agrigento* (Girgenti 1883).

⁴ Sipas Tuttolomondo-s (1921, 13-14 dhe 24vv.), Dara kishte shkruar 14 vepra.

edhe një përkthim fjalë për fjalë. Por, ndërsa përkthimi i parë ka mbetur i pabotuar, përkthimi i dytë u botua krahas versionit shqip pas vdekjes së autorit (shih Tuttolomondo: 1921, 159vv.).

Sipas Tuttolomondo-s (1921, 133), Gavril Dara (i Riu) ka hartuar edhe një tjetër poemë italisht me temë shqiptare me titullin “Anna Maria”. Në atë poemë, që frymëzohet nga historia e një princeshe të pafat dhe që ka mbetur e pabotuar, ai ka paraqitur gjendjen e Shqipërisë midis vjetëve 1460-1485.

Kuptohet vetiu që shkrimet italishte të Gavril Darës i përkasin letërsisë italiane, megjithëse, kur trajtojnë subjekte nga Shqipëria, nuk janë pa interes edhe për ne. Gjithsesi, për letërsinë shqipe paraqit më shumë interes çka ai ka shkruar në gjuhën amtare arbërishte dhe në këtë rast ne njohim prej tij vetëm poemën *Kënga e sprasme e Balës*. Sipas G.D. (1900), ai ka shkruar edhe një vjershë për *Lazrin* si edhe një Fjalor shqip [= arbërisht] - italisht, mbetur pa botuar.

6. Poemën *Kënga e sprasme e Balës* Gavril Dara ia kushton kushëririt të tij, Petro Kiarës (*Tuzës i Kjarënjëvet*), “i cili ngjalli nga varri katërqind vjetësh Vllamjen e Arbërit dhe ua bëri të njohur qeverive të Europës në Kuvendin e Berlinit”. Poemës i prijnë një Parathënie (*Parathënëme*) dhe një Pasthënie (*Prapathënëme*). Në Parathënien e veprës, duke ndjekur një modë të përhapur aso kohe në Europë pas botimit të veprës “*Poemat e Osianit*” të poetit skozez Makferson (1736-1796), Dara na e paraqit poemën e tij si veprën e një bardi popullor me emrin *Balë*, që paskësh qenë një luftëtar i kohës së Skënderbeut. Ai, pas mërgimit të tij në Itali bashkë me arbëreshë të tjerë, e kalonte jetën i vetmuar duke kënduar ngjarjet “e Motit të Madh” të Skënderbeut. Ky bard popullor, sipas Darës, në rini të vet paskësh bërë edhe “këngët e para”, por këto paskëshin humbur. Gjithnjë sipas Darës, një pjesë të këngëve të Balës e paskësh mbledhur i gjyshi, Gavril Darë Plaku. Pastaj i ati, Andrea Dara,

paskësh mbledhur edhe pjesë të tjera nga *Kënga e sprasme e Balës*. Kurse vetë Poeti Gavril Dara (i Riu) paska shtuar, përveç Parathënies dhe Pasthënies (shih § 8), vetëm “*Këngën e Zogut*” (kënga e dytë e pjesës së tretë të poemës), të cilën ai thotë se e kishte mësuar në fëmëni nga një plakë e moçme arbëreshe, Zonja Marë e Bidherënjëve.

Por, siç u vu në dukje edhe pak më sipër, këtu kemi të bëjmë me një vepër të vetë Gavril Darës (të Riut). Ky pa dyshim është mbështetur shumë edhe në të dhënat e sidomos në frymën e poezisë popullore arbëreshe, por ato i ka shtjelluar më tej dhe i ka integruar në një vepër letrare, që është fryt i fantazisë së tij krijuese. Kështu p.sh. heroi kryesor i poemës, Nik Peta, aq i njohur në poezinë popullore arbëreshe, në veprën e Darës paraqitet në një veprimtari shumë më të gjerë sesa në këngët popullore. Mjafton të kihet parasysh se dashuria e tij me *Bijën e Lalës* dhe shtjellimet e lidhura me të janë fryt i fantazisë krijuese të Poetit. Në shtjellimin e kësaj vepre (e sidomos në shënimet historike në fund të faqeve) Gavril Dara (i Riu) ka pasur parasysh edhe disa të dhëna historike, që jep Barleti për kohën kur zhvillohen ngjarjet e poemës. Edhe në jetëshkrimin e shkurtër të Poetit, që botoi G. D. në të përkohëshmen “*La Nazione Albanese*” (viti 1900, nr. 13) pohohet hapur se poema “*Kënga e sprasme e Balës*” është një vepër e Gavril Darës (të Riut). Një mendim të tillë e kanë shprehur edhe Ziaudin Kodra (1955, 6), Xhuvani (1980, 164v.), Demiraj (1961, 4, 1994, 9), Klara Kodra (1983, 28, 49) etj. Edhe gjuha e përdorur nga autori si në vargjet e poemës ashtu edhe në Parathënien dhe Pasthënien e saj (shih edhe §§ 23-26) dëshmon qartë se kemi të bëjmë me një vepër origjinale të një poeti të talentuar.

7. Siç u vu në dukje edhe në § 5, poemën *Kënga e sprasme e Balës* Gavril Dara nuk arriti ta shihte të botuar as në versionin shqip, as në versionin italisht. Ajo u botua pjesërisht

(vetëm kënga I e pjesës I) dy vjet pas vdekjes së tij (1887) në të përkohëshmen “*Arbri i Ri*” të Zef Skiroit. E plotë vepra u botua pjesë-pjesë në të përkohëshmen “*La Nazione Albanese*” të Anselmo Lorecchio-s gjatë vjetëve 1900-1903. Më 1906 ajo u botua edhe në një vëllim më vete në Katancaro të Kalabrisë. Pjesë të kësaj poeme, të përshtatur në shqipen e sotme, botoi edhe Aleksandër Xhuvani në të përkohëshmen “*Diturija*” të Lumo Skëndos në vitin 1927. Më 1955 Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve në Tiranë e ribotoi të tërë versionin arbërisht të poemës, të pajisur edhe me shënime dhe me një parathënie nga Profesor Ziaudin Kodra. Më 1961 Ndërmarrja e Botimeve “Naim Frashëri” botoi përshtatjen e kësaj vepre në shqipen e sotme, të pajisur edhe me një parathënie nga Shaban Demiraj. Kjo përshtatje e poemës është ribotuar më 1965 edhe nga Drejtorja e Botimeve Shkollore. Ajo është ribotuar edhe nga “Rilindja”, Prishtinë, më 1976. Poema e Darës, e kthyer në shqipen e sotme, është botuar edhe nga Razi Brahimi më 1967. Më 1967 Shtëpia Botuese “Naim Frashëri” ribotoi edhe versionin italisht të autorit *Il canto ultimo di Bala*. Po kjo ndërmarrje botuese më 1994 e botoi versionin origjinal (arbërisht) dhe përshtatjen e kësaj poeme në shqipen e sotme, përgatitur nga Shaban Demiraj.

II. Analiza e veprës

A. Brenda

8. Poemën *Kënga e sprasme e Balës G. Dara* e shoqëron me dy proza pak a shumë të gjata, një Parathënie dhe një Pashënie.

Në Parathënie Poeti, si na flet për autorin e trilluar të poemës, Balën, dhe për kohën e lavdishme të popullit shqiptar

nën udhëheqjen e Skënderbeut, shfaq edhe mendimet e veta për çlirimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të Ballkanit, që lëngonin nën sundimin otoman. Shpëtimin e Shqipërisë ai e shihte, në radhë të parë, në bashkimin e të gjithë shqiptarëve pa dallim krahine dhe feje. Ata, thekson ai, “të kujtojnë se besa e tyre duhet të jetë një: besa e shenjtë e Arbërisë!” Ai shkon më tej duke i këshilluar shqiptarët që të bashkohen me popujt e tjerë të vegjël të Ballkanit në luftën e tyre të përbashkët kundër sundimit të huaj. Por koha tregoi se mendimi i tij për një si konfederatë të këtyre popujve, ku secili komb të ruante identitetin dhe kufijtë e tij, ishte një utopi. Edhe mendimi i këtij dhe i ndonjë tjetër arbëreshi për një lidhje burimore të ngushtë midis shqipes dhe greqishtes si dy gjuhë të një dege të përbashkët, është kapërcyer tashmë nga gjuhësia krahasuese, e cila ka vënë në dukje se, me gjithë bashkëpërkimet si dy gjuhë indoevropiane, ato kanë ndryshime të rëndësishme midis tyre. Në Parathënie ai bën fjalë edhe për Pellazgët, por pa pasur një ide të qartë për këtë çështje të errët, për të cilën edhe sot nuk mund të thuhet asgjë e sigurt.

Kurse në Pasthënie Dara flet shkurt për ngjarjet në Shqipëri pas vdekjes së Skënderbeut, përshkruan peripecitë dhe vuajtjet e të birit të Skënderbeut dhe të shokëve të tij gjatë shpërnguljeve të tyre nga Shqipëria për në Itali dymbëdhjetë vjet pas vdekjes së Heroit dhe pas një lufte të pabarabartë kundër armiqve.

9. Poemën *Kënga e sprasme e Balës* e përshkrijnë tejendatë dy ndjenja të thella njerëzore: dashuria e pastër e dy të rinjve dhe ndjenja e lartë e detyrës ndaj Atdheut. Autori ka ditur t’i gërshetojë me mjeshtëri ngjarjet e lidhura me këto dy ndjenja fisnike dhe të këndojë aq bukur edhe vetëmohimin e trimave shqiptarë të kohës së Skënderbeut në kryerjen e detyrës ndaj Atdheut.

Poema, që ngërthen gjithsej nëntë këngë me 1892 vargje, është e ndarë në katër pjesë.

Kënga e parë e pjesës së parë, që mban emrin e bardit popullor *Bala*, shërben si hyrje për tërë poemën. Në këtë këngë Bala paraqitet si një plak, që jeton i vetmuar dhe i dëshpëruar qysh prej dyzet vjetësh në dhe të huaj, në Itali. Atje ai kujton gjithnjë ngjarjet dhe shokët e tij të kohës së Skënderbeut. Këto kujtime ia sjell ndër mend sidomos emri i *Bijës së Lalës*, që është një nga personazhet e poemës. Një ndër këto kujtime është edhe ngjarja, që këndohet në këngën e dytë të pjesës së parë.

Në këtë këngë, që mban titullin “*Përrallëza*”, përshkruhet me mjeshtëri pendesa e Moisi Golemit pas tradhtisë së tij dhe qëndrimi zemërgjerë i Skënderbeut ndaj tij. Kësaj ngjarjeje historike, e cila nuk ka lidhje të ngushtë me subjektin e poemës, Dara i ka kushtuar një nga këngët më të bukura të veprës së vet.

Subjekti i poemës fillon të shtjellohet vetëm në këngën e tretë të pjesës së parë, që mban titullin “*Kënga e hënëzës*”. Atje paraqiten Bala dhe plaku Darë, tek ndiejnë zërin e ëmbël të trimit Nik Peta në një natë të bukur me hënë. Nik Peta, ulur mbi një gur, i lutet hënëzës me një këngë mallëngjyese, të shkojë e të përshëndesë me dritën e saj të dashurën e tij në Lalë të Moresë. Kur e dëgjon këtë, plaku Darë e qorton Nikun përse dashuron një vashë të huaj dhe përse mendon për martesë në një kohë, kur vringëllijnë shpatat e armiqve. Atëherë Niku zë e i rrëfen historinë e dashurisë së tij, që shtjellohet në këngën e katërt të pjesës së parë, me titullin “*Vasha e Lalës*”.

Në këtë këngë Nik Peta rrëfen se si ai dhe shoku i tij i luftës, trimi Pal Golemi, ishin njohur në Lalë të Moresë me të bijën e princit Kaur, Marën, e cila i kishte magjepsur të dy trimat me bukurinë dhe hijeshinë e saj. Pastaj, si përmend zënkën e tij me Pal Golemin për punë të Vashës së Lalës, Nik Peta përshkruan me nota mallëngjyese ndarjen e tij nga e dashura, së cilës i premtoi se do të kthehej, të shumtën, brenda

tre vjetësh. Më tej Nik Peta flet shkurt për luftën e tij kundër turqve, më parë nën urdhrat e Huniadit e pastaj nën urdhrat e Skënderbeut. Në këto fjalë e sipër, ia beh Pal Golemi dhe në atë çast të dy trimat përleshën keqas dhe sprapsen vetëm kur papritmas ndërhyjnë Skënderbeu, i cili me një vështrim i bën të ndahen. E këtu mbaron pjesa e parë e poemës, ku mbizotëron motivi i dashurisë.

Në pjesën e dytë, që përbëhet nga një këngë e vetme me titullin “*Plaku*”, subjekti i poemës shtjellohet më tej. Këtu përshkruhet takimi i Balës, që ishte ngarkuar nga Skënderbeu të zgjuante rojat e natës, me plakun Harun. Ky vinte nga kampi i armiqve për të lajmëruar Skënderbeun se Ballabani ishte nisur me urdhër të Sulltanit për të rrëmbyer Vashën e Lalës, Marën. Si përmend një nga një shokët trima të Skënderbeut të mbledhur në kuvend, Poeti na përshkruan edhe bashkëbisedimin e zhvilluar midis plakut Harun dhe Skënderbeut, i cili ia beson trimin Nik Peta shpëtimin e Marës. E në këtë mënyrë Poeti e përgatit lexuesin për ngjarjet, që do të shtjellohen në pjesën e tretë të poemës.

Pjesa e tretë ngërthen dy këngë. Në këngën e parë, që mban titullin “*Humbja e Kusarit*” [= “Lugina e Kusarit”], përshkruhet vendi, ku do të përleshet Nik Peta me Ballabanin. Si na përshkruan pamjen e jashtme dhe gjendjen shpirtërore të Nik Petës, i cili bashkë me shokët e vet kishte zënë pritë të “Humbja e Kusarit”, Poeti na bën të njohur fytyrën e tradhtarit Ballaban dhe në vargjet e fundit na tregon se si princi i Lalës, Kauri frikacak, ia dorëzon atij të bijën.

Kur Mara e sheh se edhe i ati e shiti, atëherë i lutet zogut të malit [“Kënga e zogut”], që të shkojë e të lajmërojë Nikun. Pastaj në këtë këngë, që është kënga e dytë e pjesës së tretë, vihet në dukje udha e gjatë dhe e vështirë, që Mara është e detyruar të bëjë, derisa arrin te “Lugina e Kusarit”. Aty zhvillohet një përleshje e rreptë, që përfundon me shpartallimin

e Ballabanit dhe me shpëtimin e Marës, të cilën Niku e shpie në shtëpi të tij. Me këtë përfundon motivi thjesht dashuror i poemës dhe këtu lexuesi mund të priste edhe mbylljen e saj me përshkrimin e lumturisë bashkëshortore të dy të rinjve, që pas shumë peripecish më në fund e panë të realizuar ëndrrën e tyre. Por Dara, duke e vendosur ngjarjen në një periudhë historike, kur populli shqiptar nën udhëheqjen e urtë të Skënderbeut luftonte trimërisht për jetë e vdekje, nuk mund të kënaqej me një përfundim të tillë, që nuk do të përfaqësonte realitetin historik të asaj kohe.

Nik Peta, duke iu përgjigjur kushtrimit të Atdheut, lë dasmë e valle dhe niset për të marrë pjesë në Betejën e Valkalit, e cila përshkruhet në pjesën e katërt të poemës. Në këngën e parë të kësaj pjese, “*Dita e Valkalit*”, Poeti na çon te kullat e Petës, ku gjithçka ndiell zi. Në mëngjesin e ditës së betejës edhe Mara, nusja e Nik Petës, ia ka marrë një kënge të trishtuar, që jepet në fillim të këngës së fundit të pjesës së katërt dhe të të gjithë poemës, “*Kënga e Beratit*”. Këtu, pas këngës së trishtuar të Marës, që përkujton kërdrinë e betejës së Beratit (1455), nëpërmjet tregimit të një përderësi dhe të vetë bardit Bala përshkruhet beteja e Valkalit (1465), ku, sipas poemës, gjetën vdekjen duke luftuar burrërisht trimat Nik Peta e Pal Golemi dhe ku shkoi e mbaroi edhe nusja e Nikut, Vasha e Lalës, Mara.

Siç shihet, Dara e ka parë të nevojshme që t’i jepte poemës së tij një mbyllje të tillë, që ishte më e natyrshme për kohën, kur zhvillohen ngjarjet e saj.

B. Vetat veprues (personazhet)

10. Personazhet e poemës së Darës mund të ndahen në tri grupe: 1) Personazhe të marra nga poezia popullore; 2) personazhe të trilluara nga vetë autori dhe 3) personazhe

historike. Në grupin e parë hyjnë dy heronjtë kryesorë të poemës, Nik Peta dhe Pal Golemi. Në grupin e dytë hyjnë bardi Balë, Vasha e Lalës, plaku Darë, Kauri, plaku Harun, përderësi etj. Në grupin e tretë hyjnë Skënderbeu, Ballabani a Badheri, Moisi Golemi, Vrana Konti, Sulltani etj.

Përveç këtyre, në ngjarjet e kënduara në poemë ndërhyjnë edhe elementë fantastikë, si *zogu i malit*, *Dreqëzat*, *Shtrigat* etj. Një vend i veçantë në këtë poemë i kushtohet edhe *hënës*, si dëshmitare e dashurisë dhe e brengave shpirtërore të Nik Petës dhe të Vashës së Lalës.

11. Nga dy personazhet e marra prej poezisë popullore arbëreshe rolin kryesor e luan Nik Peta. Ky është protagonist i poemës, ku këndohen në radhë të parë gjestet dhe ndjenjat e tij. Poezia popullore arbëreshe ka thurur rreth tij këngë dhe legjenda të ndryshme. Edhe në poemën e Darës Nik Peta i ruan tiparet kryesore, me të cilat e ka paraqitur tradita popullore arbëreshe. Ai është një trim sypatrembur, i singertë dhe besnik. Dara na e paraqit atë edhe si një këngëtar të ndjeshëm.

Zemrën e Nikut e përshkohnë dy ndjenja të larta njerëzore, për të cilat ai është gati të bëjë fli edhe jetën. Këto dy ndjenja janë dashuria plot vetëmohim për Atdheun, e mbrujtur me urrejtjen dhe përbuzjen ndaj armiqve të huaj dhe ndaj tradhtarëve si Ballabani, si edhe dashuria e pastër për vashën e tij të zemrës. Ai, si kalorësit endacakë të Mesjetës, bredh gjithandej, “për të gjetur zulm a varr”.

Nik Peta i Darës është një figurë thellësisht njerëzore. Zemra e tij, aq e egër kundër armiqve të Atdheut, është shumë e ndjeshme në dashuri. Ai e dashuron Vashën e Lalës me tërë zjarrin e nje zemre djaloshare dhe, kur mëson se edhe ajo i përgjigjet mallit të tij, i premtun dhe i jep fjalën e burrit se do të kthehet pranë saj patjetër brenda tre vjetësh. Mbarimi i tij burrëror dhe fjalët e fundit, që Poeti i vë në gojë në çastet e

fundit të jetës (shih Pjesën IV, Kënga II, vargjet 302-332), e bëjnë Nik Petën e Darës një hero të denjë për kohën e lavdishme të Skënderbeut.

Por krahas këtyre tipareve kryesore të karakterit të Nik Petës, Dara na ka dhënë edhe disa tipare të tjera të dorës së dytë, që e bëjnë atë edhe më njerëzor. Në poemë ai paraqitet edhe gjaknxehtë dhe i rrëmbyer, nuk duron asnjë fyerje, qoftë edhe nga shokët e tij të luftës. Ai përleshet me Pal Golemin në shtëpi të Kaurit të Lalës (shih Pjesën I, Kënga IV, vargjet 132-152), si edhe një herë tjetër më vonë, kur është duke biseduar me plakun Darë (*po aty*, vargjet 314-353). Ashtu si kalorësit e Mesjetës, ai nganjëherë sillet kundrejt armikut me mospërfillje. Te “Lugina e Kusarit” ai nuk e vret Ballabanin, megjithëse e ka në dorë, por vetëm e fyen dhe e bën t’ua mbathë këmbëve (shih Pjesën III, Kënga II, vargjet 174-183).

Nik Peta i Darës, pra, është një figurë më e ndërlikuar dhe më njerëzore se hero i legjendar i poezisë popullore arbëreshe.

12. Pal Golemi, një tjetër figurë legjendare e poezisë popullore arbëreshe, na paraqitet pothuaj me të njëjtat tipare si në traditën popullore arbëreshe. Edhe ai, ashtu si Nik Peta, është trim sypatrembur, i urren armiqtë dhe për Atdheun nuk kursen as jetën. Fjalët e fundit, që Poeti i vë në gojë atij në çastin e vdekjes (shih Pjesën IV, Kënga II, vargjet 250-280), tregojnë qartë se me ç’zemër e me ç’ndjenja fisnike na i paraqit Dara luftëtarët trima të kohës së Skënderbeut.

Por Pal Golemin Dara na e paraqit nganjëherë të rrëmbyer edhe kryelartë. Edhe ai, ashtu si Nik Peta, e dashuron Vashën e Lalës dhe për këtë i vërsulet dy herë Nik Petës (shih Pjesën I, Kënga IV, vargjet 137-150 dhe 328-342). Për Nik Petën dhe Pal Golemin shih edhe & 19.

Megjithatë, kur i thërret zëri i Atdheut, këta dy trima i harrojnë grindjet e vjetra dhe luftojnë me vetëmohim kundër të

njëtit armik të përbashkët. Që të dy gjejnë vdekjen në fushën e betejës së Valkalit, ku edhe i varrosin pranë njëri-tjetrit si dy shokë lufte të pandarë. Ata kështu mishërojnë ndjenjat e larta të dashurisë dhe të vetëmohimit për Atdheun.

13. Ndër figurat e trilluara një rol me rëndësi luan Vasha e Lalës (Mara), me emrin e së cilës janë të lidhura ngjarjet kryesore, që këndohen në këtë poemë. Ajo edhe pas vdekjes i qëndron para syve plakut Balë të mërguar në Itali. Në këtë poemë ajo paraqitet si një vajzë e bukur, e ndershme, e singertë, besnike dhe trime. Ajo e dashuron Nik Petën me tërë zjarrin e zemrës së saj vajzërore, kur sheh që ai është një trim i mirë dhe i singertë. Pas largimit të Nikut gazi i zemrës i shuhet dhe jeta s'i hyn në sy. Pasi i ati burracak ia dorëzoi Ballabanit, derisa e mban shpresa se i dashuri mund ta shpëtojë, e mban të mbyllur në zemër dhembjen krenare. Por ajo është e vendorsur që, kur të ketë humbur çdo shpresë shpëtimi, t'i japë fund jetës me thikëzën, që e mban të fshehur në gji. Te “Lugina e Kusarit” ajo mbrohet me guxim kundër turqve, që i vërsulen për ta vrarë. Por, megjithëse munda të shpëtonte nga kthetrat e armiqve, nga kthetrat e vdekjes nuk shpëtoi dot. Zemra e saj e djegur nuk mundi ta duronte helmin e madh dhe i pushoi së rrahuri, kur pa të shoqin të shtrirë në fushën e Valkalit.

Vasha e Lalës në poemën e Darës është përfytyruar me tiparet më të bukura, që mund t'i vishen një vajze të ndershme, besnike dhe trime.

14. Një tjetër personazh i trilluar, që luan një rol me rëndësi në ngjarjet e poemës, është Bala. Ai në këtë poemë përfaqëson një luftëtar tipik të kohës së Skënderbeut. Sipas Darës, ai ishte edhe një poet popullor i talentuar. E mund të pohohet se nëpërmjet Balës Dara ka dashur të tipizojë luftëtarët trima të kohës së Skënderbeut, që pas vdekjes së Heroit u

detyruan të mërgonin në Itali, ku ditët e fundit të jetës i kaluan të malluar e të vërsosur për Mëmëdheun e robëruar. Siç u vu në dukje edhe në § 8, Dara e ka shfrytëzuar figurën e trilluar të këtij bardi popullor edhe për ta paraqitur si krijuesin e poemës së vet.

15. Ndër personazhet e tjerë të trilluar janë edhe plaku Darë, Kauri dhe plaku Harun.

Plaku Darë, që paraqitet si stërgjyshi i poetit Gavril Darë, na del në poemë si një ndër kapedanët shqiptarë të kohës së Skënderbeut (shih Pjesën I, Kënga II, vargjet 30-35). Ai, si plak atdhedashës, e qorton Nik Petën, kur merr vesh se ky dashuron një vajzë të huaj dhe e këshillon që të mos e fëlliqë kështu gjakun e tij të kulluar, por të martohet me një vashë arbëreshe. Ai i tërheq vërejtjen Nik Petës edhe përse mendon për martesë në një kohë kur vendi kërcënohet nga shpatat e armiqve.

Kauri në këtë poemë paraqitet burracak dhe tinëzar. Ai mendoi të vriste tinëzisht Nik Petën dhe Pal Golemin në shtëpinë e vet. Dhe, për të shpëtuar jetën dhe pronën e tij, pranoi t'i jepte të bijën armikut turk.

Figurën e plakut Harun Dara e ka trilluar, për të përligjur shtjellimin e mëtejshëm të ngjarjeve.

16. Ndër personazhet historikë, që përmenden në poemën e Darës, ata që luajnë rol të dukshëm, janë Skënderbeu dhe Ballabani.

Skënderbeu, megjithëse nuk është nga personazhet kryesorë të poemës, me autoritetin e tij paraqitet si një figurë, që lidhet gjithnjë me ngjarjet kryesore të saj. Në Këngën II të Pjesës I ai qesh e gëzon bashkë me shokët e vet pas fitores mbi armiqtë dhe sillet me zemërgjerësi ndaj Moisi Golemit të penduar. Në betejën e Valkalit (Pjesa IV, Kënga II) ai paraqitet si një figurë, që mbizotëron. Ai bën kërdrinë mbi armiqtë. Tek

binte kordha e tij e rëndë, binin krerët breshërimë. Ai bën çmos edhe për të shpëtuar dhjetë kalorësit trima, që u rrethuan nga armiqtë. Në paraqitjen e figurës së Skënderbeut Dara është mbështetur shumë në traditën popullore arbëreshe si edhe në historinë e Barletit.

Për sa i takon Ballabanit a Badherit, ky në poemë paraqitet, në njëfarë mase, si antagonist i Nik Petës. Trimërinë e tij ai e ka vënë në shërbim të armikut, i cili e ka bërë për vete duke i dhënë grada të larta, ndere e dhurata. Ai ka mohuar atdheun dhe u bindet verbërisht urdhrave të Sulltanit. Por shpata e tij, e lyer me gjak sklevërish, nuk mund të qëndrojë përballë guximit të trimave të Arbrit. Te “*Lugina e Kusarit*” (Pjesa III, Kënga I) ai ua mbath këmbëve për turp dhe shkul mjekrën nga dëshpërimi. Ballabani në këtë poemë paraqitet edhe tinëzar. Ai e qëllon tinëzisht Nik Petën te “*Lugina e Kusarit*” dhe e vret atë duke e qëlluar nga prapa në betejën e Valkalit. Dara e ka paraqitur atë ashtu siç del edhe në traditën popullore arbëreshe dhe në Historinë e Barletit.

C. Veçoritë e veprës

17. Siç del edhe sa nga sa u parashtrua në §§ 8-9, poema e Darës nuk ka një kompozicion të ndërlikuar. Veprimi i kësaj poeme, që në të vërtetë nis me këngën III të pjesës I (“*Kënga e hënëzës*”), vjen duke u zhvilluar e duke u rritur, derisa arrin pikën kulmore në përleshjen midis Nik Petës e Ballabanit te “*Lugina e Kusarit*” (Pjesa III, kënga I). Pastaj ngjarjet rrokullisen shpejt drejt epilogut, që është një ndër më të bukurit e më madhështorët, që njeh letërsia shqipe (“*Kënga e Beratit*”).

Poema në tërësi, duke lënë mënjanë, në njëfarë mase, këngën II të pjesës I, ka unitet. Këngët janë të lidhura me mjeshtëri njëra me tjetrën. Pjesa e fundit e çdo kënge e përgatit

lexuesin në mënyrë të natyrshme për ngjarjet, që këndohen në këngën pas saj. Kështu p.sh. kënga III e pjesës I të përgatit për episodet, që këndohen në këngën IV të asaj pjese, “*Vasha e Lalës*”, e kështu lidhen midis tyre edhe këngët e tjera. Edhe episodi i Plakut Harun lidhet ngushtë me veprimin e poemës; nëpërmjet këtij episodi Poeti përlligj veprimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe pikërisht ndeshjen e Nik Petës me Ballabanin të “*Lugina e Kusarit*”. Por Dara nuk është kënaqur vetëm me një lidhje *formale* të këngëve të poemës së tij. Ai në çdo këngë e përgatit lexuesin me mjeshtëri edhe nga ana shpirtërore për ato që do të ndodhin më pas. E nga kjo pikëpamje vlen të vihen në dukje sidomos dy këngët e fundit të poemës. “*Dita e Valkalit*”, një këngë e shkurtër prej pesëmbëdhjetë vargjes, të përgatit shpirtërisht për ato që do të përshkruhen te “*Kënga e Beratit*”. Edhe fillimi i “*Këngës së Beratit*” është një hyrje e përzishme, që të bën të parandiesh kërdrinë e betejës së Valkalit, ku gjetën vdekjen, duke luftuar trimërisht, dy heronjtë e poemës, Nik Peta e Pal Golemi, dhe ku shkoi e mbaroi edhe Vasha e Lalës.

18. Dara e ka gërshetuar me mjeshtëri aksionin themelor të poemës së tij me disa nga ngjarjet kryesore të periudhës historike, në të cilën ai e ka përfytyruar zhvillimin e episodeve të trilluara, që përshkruan. Pra, ai kështu edhe ka përkujtuar një nga periudhat historike më të lavdishme të popullit shqiptar, por pa rënë në historizëm. Duke ecur kështu në gjurmët e Poetit të madh të Makjit⁵, ai ka pasqyruar me mjeshtëri edhe gjendjen e përgjithshme shpirtërore të arbëreshëve të Italisë, të cilët e kanë ruajtur të gjallë brez pas brezi mallin për Atdheun e të parëve të tyre dhe kujtimin për të kaluarën e tij të lavdishme.

⁵ Të kihet parasysh se edhe De Rada episodet e kënduara te *Këngët e Milosaos* i përfytyron si të shekullit XV.

Lidhja e ngushtë e poetit Gavril Dara me ndjenjat dhe kërkesat shpirtërore të vëllezërve të tij arbëreshe është shprehur fare qartë edhe nëpërmjet mbështetjes së tij mjeshtërore në poezinë popullore arbëreshe. Madje, ka mjaft të ngjarë që edhe për një nga motivet kryesore të poemës së tij ai të jetë frymëzuar nga ndonjë këngë popullore arbëreshe si ajo që ka botuar De Rada në f. 40 të *Rapsodive* të tij (1866), ku bëhet fjalë për rrëmbimin e një vashë arbëreshe nga “qeni” turk. Ky, sipas poezisë së botuar nga De Rada, e gjen vashën arbëreshe vetëm, e ndjek mal më mal dhe më në fund e arrin në të tretin mal, e kap për gërshetash, e shtrin përtokë dhe e lidh në bisht të kalit, të cilin pastaj e nget me shpejtësi. Nga të thirrurat e vashës oshëtinin përrënjtë. Në atë kohë Nik Peta me disa shokë ishin duke gjuajtur dhe e ndjenë zhurmën dhe e panë turkun tek vinte kaluar me një vajzë të hequr zvarrë. Atëherë trimat i dolën turkut përpara. Qëlloi njëri prej tyre, por më kot; edhe i dyti po më kot goditi; edhe të tretin e gënjeu dora. Atëherë “qenit” turk i doli përpara Nik Peta, i cili e goditi mu në zemër dhe e rrëzoi përtokë; pastaj shkoi e kapi kalin dhe në atë çast pa se vasha e vdekur ishte e shoqja e tij.

Edhe në poemën e Darës të rrëmbyerit e Vashës së Lalës dhe të shpëtuarit e saj nga Nik Peta janë dy nga episodet më të rëndësishme. Por natyrisht subjekti i kësaj poeme ka marrë përmasa më të gjera dhe më të ndërlikuara se në poezinë popullore. Për më tepër, në poemën e Darës vasha e rrëmbyer nuk është e arbëreshe dhe i dorëzohet Ballabanit nga i ati frikacak. Atë pastaj e shpëton Nik Peta, i cili e shpie në shtëpi të tij dhe më në fund vdesin që të dy në Valkal, njëri nga goditja tinëzare e Ballabanit dhe tjetra nga helmi i vdekjes së të shoqit.

Nga poezia popullore arbëreshe Dara ka marrë edhe motive të tjera. P.sh. të ndarët e unazës më dysh, për të treguar zgjidhjen e nyjës së martesës, siç e gjejmë në vargjet 23-24 të “*Këngës së Beratit*”, ndeshet edhe në këngën legjendare

“Konstandini i vogëlith”, e cila i ngjan shumë legjendës sonë, që njihet me emrin e “Aga Ymerit”. Kur Konstandini niset të vejë në ushtri, heq nga gishti unazën e martesës dhe e ndan më dy pjesë, njërën e mban për vete dhe tjetrën ia jep së shoqes.

Edhe motivi i të falurit të jetës Ballabanit të “*Lugina e kusarit*” (vargjet 249-253), haset në poezinë popullore arbëreshe, si p.sh. në një prej rapsodive të botuara nga De Rada. Në atë rapsodi paraqitet Skënderbeu në një përleshje me turqit të komanduar nga Ballabani. Heroi shqiptar bën kërdrinë mbi armiqtë, por Ballabanin e zë të gjallë dhe e lëshon, për t’i çuar lajmin sulltanit, pasi i pret veshin e djathtë, për ta turpëruar. (De Rada, *Rapsoditë*, 78-79).

Edhe të mbirët e bimëve në varret e të vdekurve, sidomos kur këta janë burrë e grua a të dashur, është një motiv, që e ndeshim në poezinë popullore si tek arbëreshët ashtu edhe te ne, si simbol të përjetësimit të dashurisë. Në poezinë popullore arbëreshe në raste të tilla trimi simbolizohet me një qiparis dhe vasha me një hardhi., ndërsa në poemën e Darës te varri i Nik Petës dhe i Vashës së Lalës mbijnë një qiparis dhe një mollë e bardhë (“*Kënga e Beratit*”, 383-384).

19. Siç u vu në dukje në §§ 11-12, edhe dy trimat kryesorë të poemës, Nik Peta e Pal Golemi, janë figura legjendare të poezisë popullore arbëreshe, e cila u ka kushtuar atyre edhe disa këngë të bukura, që Dara me siguri i ka njohur. Mjafton të kemi parasysh se fjalët e fundit, që Dara i vë në gojë Pal Golemit të plagosur për vdekje në betejën e Valkalit (“*Kënga e Beratit*”, 267-280), u ngjajnë aq shumë porosive të këtij heroit legjendar, që lexojmë në një elegji popullore të botuar nga De Rada dhe arbëreshë të tjerë. Në atë elegji Pal Golemi i plagosur për vdekje në fushë të luftës u lutet shokëve, ndër të tjera, që në krye të varrit t’i bëjnë një “dritësore” e atje t’i lidhin murgjarin dhe në fund të varrit t’i varin armët, shokët e tij të luftës. Por ka

më shumë të ngjarë që për porosinë e fundit të Pal Golemit Dara të jetë frymëzuar nga rapsodia e botuar prej De Radës (faqe 85-86), ku paraqitet Skënderbeu në çastin e vdekjes. Ai e porosit të birin, ndër të tjera, që, para se të largohet me gjithë t'ëmën për në Itali, të lidhë kalin e t'et në një lis në breg të detit; përmbi kalë të shtjellë flamurin e në mes të flamurit të lidhë shpatën e tij. Kur të fryjë veriu, murgjari do të hingëllijë, flamuri do të valëvisë dhe shpata do të tringëllijë. Turku do t'i ndiejë dhe, duke kujtuar vdekjen që fle tek ajo shpatë, nuk do t'i ndjekë nga pas.

Për sa i takon protagonistit të poemës, Nik Petës, ky, ashtu si në poemën e Darës, ku ngarkohet nga Skënderbeu për t'i zënë pritë Ballabanit (*"Plaku"*, 344-367), ashtu na paraqitet edhe në një këngë popullore arbëreshe, kushtuar një tjetër heroi legjendar të kohës së Skënderbeut, *Milo Shinit*. Në atë këngë popullore thuhet, ndër të tjera: "Pa se ng'ishin gjëm n qiellsh - por in turqit preivestar - me vantile, të gapëjin udhën - të zënur ka Nik Peta..." (De Rada, *Rapsodie*, f. 41)⁶.

20. Nga poezia popullore arbëreshe Dara ka marrë ndonjëherë edhe vargje të tëra, duke i përfshirë me mjeshtëri në pjesë të caktuara të poemës së tij. I tillë është p.sh. rasti i vargjeve 70-81 të *"Këngës së Beratit"*, që janë marrë nga një këngë popullore, në të cilën përkujtohet një luftë e arbëreshëve të ardhur prej Moresë së Greqisë. Në atë këngë popullore arbëreshe lexojmë, ndër të tjera:

Atje lart ka Muskovatë
gjegjeshin gjëmë e bumbardha.

⁶ "Pa se s'ishin gjëmë qiejsh, por ishin pararojet turke me flamurë, që (donin) të hapnin udhën e zënë nga Nik Peta."

Gjëmëshit, bumbardhashit
gjithë jeta më gjëmoj,
kamnoi i dufeqevet
gjithë malet mjegulloj,
zbardhëllimit cabievet
gjith fushatë më shkëlqein;
gjakut e ushtorëvet
embloneshin lumëratë;
copëshit stilevet
bëneshin urë e stiseshin...⁷
(shih G. Camarda, *Appendice al Saggio...*, f. 126).

Përveç këtyre, nga poezia popullore arbëreshe Dara ka marrë edhe masën e vargjeve. Ai ka përdorur kryesisht vargun tetërrokësh trokaik të parimuar e këtë e përzien nganjëherë edhe me vargun shtatërrokësh gjithashtu të parimuar, ashtu siç ndodh edhe në poezinë popullore të arbëreshëve të Italisë. Mirëpo në poemën e Darës gjejmë edhe vargje të rimuar, si p.sh. në fillim të “*Këngës së Beratit*” etj.

Nga poezia popullore arbëreshe Dara nuk ka marrë vetëm formën dhe disa motive e vargje. Ai ka ditur t’i hyjë asaj në thelb, duke marrë prej saj, në radhë të parë, ndjenjat e larta të atdhedashurisë, të vetëmohimit dhe të dashurisë së pastër të heronjve të tij. Gjithsesi, në çështjen e të mbështeturit në poezinë popullore arbëreshe Dara ka një meritë të madhe. Ai është frymëzuar nga poezia popullore, por pa u bërë një imitues i thjeshtë i saj. Si poet i talentuar, duke u mbështetur mjaft në poezinë popullore arbëreshe, ai me aftësinë dhe fantazinë e tij

⁷ Siç shihet, këto vargje nuk ndryshojnë fare nga ato të “*Këngës së Beratit*” (vargjet 70-81), ku Dara ka zëvendësuar vetëm toponimin *Muskovatë* (nga katundi arbëresh *Muskov* i Moresë) me *Muzëkatë* (= Myzeqe?). që ai në një shënim fund faqeje për vargun 38 të I/I e shpjegon: si “vend buruar kronjesh”.

mundi të krijonte një kryevepër të bukur origjinale, ku personazhet dhe episodet e kënduara mbajnë vulën e krijimtarisë së tij. Kështu p.sh. Nik Peta dhe Pal Golemi, megjithëse ruajnë tiparet kryesore, me të cilat i ka karakterizuar bardi popullor (dashuria për Atdheun, guximi dhe burrëria), në poemën e Darës lëvizin e veprojnë brenda një fushe dhe kohe më të gjerë e më të përcaktuar. Ata në poemën e Darës vihen në kontakt edhe me personazhe historike si Skënderbeu, Ballabani, Huniadi etj., si edhe me personazhe të trilluara, si Mara [Vasha e Lalës], Kauri, plaku Harun, plaku Darë etj. Ata në fund që të dy gjejnë vdekjen e varrosen në fushën e betejës së Valkalit, që është zhvilluar në vitin 1465.

21. Një tjetër gjë, që bie në sy në poemën e Darës, është edhe shfrytëzimi mjeshtëror i natyrës në shtjellimin e ngjarjeve dhe në paraqitjen e gjendjes shpirtërore të personazheve. Shfrytëzimi i këtij mjeti artistik, që është karakteristik sidomos për poetët romantikë, por që ndeshet jo rrallë edhe në poezinë popullore arbëreshe (dhe shqiptare në përgjithësi), në këtë vepër ka marrë përmasa të tilla, që të krijojnë përshtypjen se Dara e ka paraqitur natyrën si një pjesëmarrëse të gjallë në shtjellimin e ngjarjeve kryesore të poemës, gati-gati si një nga vetat veprues kryesore të saj. Në këtë vepër vështirë se gjen një episod kryesor (ose edhe dytësor me njëfarë peshe), ku pamje të ndryshme të natyrës rreth e rrotull të mos shërbejnë për të paraqitur gjendjen e trishtuar apo të gëzuar të personazheve, ose faza të rrezikshme apo gazmore të zhvillimit të ngjarjeve kryesore. Mjafton të përmendim këtu, sa për shembull, pamjen e turbullt të natyrës në këngën e parë të poemës, ku paraqitet plaku Balë i menduar dhe i trishtuar në dhe të huaj, apo përshkrimin e natyrës së trishtuar të natyrës në pragun e betejës së përgjakshme të Valkalit (pjesa IV, Kënga I dhe fillimi i Këngës II). Në përputhje me vetë zhvillimin e ngjarjeve, pamjet

e trishtuara në këtë poemë janë pa krahasim më të shumta se pamjet e gëzuara të saj. Këto të dytat jo vetëm që ndeshen shumë rrallë (gjë që është plotësisht e kuptueshme), por edhe dalin kryesisht nëpërmjet krahasimeve, si p.sh. në vargjet 294-296 të “Këngës së zogut” (Pjesa III, Kënga II), kur Vasha e Lalës e sheh veten të çliruar nga kthetrat e Ballabanit.

Lidhur me shfrytëzimin mjeshtëror të natyrës do pasur parasysh se Dara në shtjellimin e ngjarjeve të poemës ka ndier nevojën të fusë në veprim edhe zogj. Mjafton të kujtojmë këtu “Këngën e zogut”, ku Vasha e Lalës i lutet zogut shtegtar që të shkojë e të lajmërojë të dashurin e saj për rrezikun, që i kërcënohet. Një ndërhyrje e tillë fantastike ishte mjeti letrar më i përshtatshëm, përmes të cilit mund të shprehej sa më mirë gjendja shpirtërore e Vashës së Lalës në çastin, kur edhe i ati e shiti dhe kur asaj, duke mos pasur se kujt t’i qante hallin, s’i mbetej tjetër veçse t’i drejtohej një zogu me shpresë se ky do t’i vinte në ndihmë. Siç shihet, kemi të bëjmë me një sajësë të fantazisë poetike e kjo nuk është e panjohur në poezinë popullore arbëreshe (dhe shqiptare në përgjithësi), as në krijimet letrare shqiptare dhe jo-shqiptare.

22. Dara është mjeshtër i rrallë edhe në përdorimin e mjeteve artistike, sidomos të krahasimeve, similitudave, epiteteve dhe kontrasteve, çka dëshmon jo vetëm për talentin e tij të rrallë por edhe për kulturën e tij të gjerë. Duke ia lënë lexuesit t’i shijojë vetë këto bukuri të poemës, po përmendim këtu vetëm nja dy krahasime të gjata (similituda), që dëshmojnë edhe për njohuritë e tij të shumanshme. Në vargjet 126-140 të “Këngës së Beratit” nëpërmjet një krahasimi të gjatë paraqitet me një mjeshtëri të rrallë mënyra se si u gjendën të rrethuar dhjetë trima shqiptarë në betejën e *Valkalit*. Si mjet krahasimi këtu Dara ka shfrytëzuar një pamje të rrallë të natyrës shqiptare, për të cilën jo të gjithë shqiptarët kanë dijeni. Është fjala për

kalimin e ujërave të Drinit të Zi nga burimi nëpër ujërat e liqenit të Pogradecit. Ja si si e përshkruan ai atë ngjarje:

Ashtu Drini i Zi në dimër,
mbushur nga përrrenjtë e maleve,
vjen i fryrë dhe i tërbuar,
përpjek ujërat e liqerit,
i merr zvarrë e i ndan dysh;
ngrihet lart tallazi i bardhë
e rreth brigjeve gjëmon;
por si ujërat e liqerit,
që, si ndahen, kthehen prapë,
kthehen vrap e bëjnë shesh,
sa edhe lumin e mbulojnë,
ashtu bëri hordhia e bushtë;
si pa që pak po sulmonin,
duke u mbledhur e shtrënguar,
pas të dhjetëve u mbyll...

Krahasimi i dytë, që deshëm të përmendim këtu, ndeshet në vargjet 273-274 të “*Këngës së zogut*”, ku përshkruhet pamja e Ballabanit të thyer e të turpëruar nga Nik Peta. Ai atje paraqitet me flokët si driza dhe me sytë të dalë, të shkëlqyeshëm si dy urë, që feksin natën nga shpella. Ky krahasim të kujton pak a shumë vargjet e Dante Aligerit: “Karont djalli *me sy prush*”.⁸

⁸ Caron *dimonio con occhi di bragia* (La Divina Commedia, pjesa I, III, vargu 109).

Ia vlen të përmendim këtu edhe krahasimin e bukur, me të cilin Dara përshkruan gëzimin e madh, që ndien Vasha e Lalës në çastin kur e sheh veten të shpëtuar nga i dashuri i saj:

Si u qetua pak nga pak
krisma e luftës e bërtima
atje larg-o te shkretira,
vajza, fluturëz e lehtë,
poshtë prej shkëmbit kërceu
e me sytë mbushur lot,
më të qeshur, më të qarë,
si një re e ndritur diellit,
që shkëlqen edhe derdh shi.
("Kënga e zogut", 287-295)

D. Gjuha e veprës

23. Së fundi, po ndalem pak edhe në disa veçori të gjuhës së kësaj vepre. Siç u vu në dukje në & 6, gjuha e përdorur në të gjithë veprën e Darës, duke përfshirë edhe Parathënien dhe Pasthënien, dëshmon qartë se ajo, fund e krye, është shkruar nga e njëjta dorë. Natyrisht, Poeti ka përfshirë në të edhe vargje të poezisë popullore arbëreshe, e cila ka ndikuar patjetër edhe në gjuhën dhe stilin e tij. Edhe nga një vështrim i shpejtë i gjuhës së kësaj vepre duket qartë se autori i saj, duke ndjekur traditën familjare, është përpjekur të njohë mirë jo vetëm të folmen e katundit të tij, Pallac Adrianit, por edhe të katundeve të tjera arbëreshe. Madje, siç na dëshmon edhe botuesi G. D. i kësaj vepre në një jetëshkrim të shkurtër të Poetit, botuar në të përdyjavëshmen "La Nazione Albanese", viti 1900, Nr. 13, f. 5 (si edhe në botimin e vitit 1906, f. 10), ky poet "i kushtoi kujdesin më të madh studimit të gjuhës shqipe, gjuhës së

stërgjyshërve të tij, e cila, siç thoshte ai, ka një harmoni, një ëmbëlsi, që nuk e ka asnjë gjuhë tjetër.” Për më tepër, ky autor është interesuar të njohë edhe vepra të autorëve të tjerë arbëreshë, prej të cilëve herë pas here në shënimet e tij përmend Ketën, peshkop Krispin, Kamardën, De Radën etj. Kujdesin dhe interesimin për gjuhën amtare na i dëshmon gjithashtu edhe vetë gjuha e përdorur nga Autori, i cili përveç thesarit të të folmeve popullore arbëreshe ka shtënë në përdorim edhe një varg fjalësh të reja të krijuara prej tij (shih & 26). Madje, nuk duhet përjashtuar mundësia që ai të jetë interesuar edhe për shqipen e përdorur nga shqiptarët e Shqipërisë. E për këtë të bën të mendosh prania, qoftë edhe e rrallë, e disa trajtave gege, sidomos e trajtës *shpnesë*⁹ (=shpresë), që e ndeshim edhe te ndonjë poet tjetër arbëresh dhe që e ka përfshirë edhe Emanuele Xhordanoja (krahas më të zakonshmes *shpresë*) në veprën e tij Fjalor i Arbëreshëve të Italisë të vitit 1963, f. 478; e po kështu edhe Kamsi:2000, f. 266.

24. Gjuha e përdorur nga Dara në veprën e tij paraqitet me disa veçori arkaike të të folmeve arbëreshe, kryesisht të katundit të lindjes, nga të cilat po përmendim këtu vetëm disa, sa për ilustrim. Kështu, gjejmë tek ai trajta fjalësh me grupet bashkëtingëllore /kl-/ , /gl-/ dhe me /-l-/ ndërzanore të pashndërruar në /-j-/ , si: *kle kluar* (= qe quajtur), *klanj* (qaj), *gluhë* (gjuhë), *i glatë* (i gjatë) etj.; *bular* (bujar), *bulëreshë* (bujareshtë), *ndëlenj* (ndëjenj > ndjej), *val* (vaj) etj. Në përgjithësi, gjuha e veprës së Darës paraqitet me trajta fonetike karakteristike të toskërishtes, siç janë p.sh. rotacizmi dhe zanorja e theksuar /ë-/ e përftuar nga një /a-/ ose /e-/ para një

⁹ P.sh., në I/II, v. 99, I/IV, v. 159, II/I, v. 169, 170, III/II, v. 90 etj. Trajta *shpnesë*, ku përkundrejt trajtës më të vjetër *shpresë* < *shpëresë* bie në sy zëvendësimi i /-r-/ me /-n-/ me rrugë analogjike, dëshmohej edhe te Buzuku. Por Budi dhe Bardhi kanë *shpëresë*.

bashkëtingëlloreje hundore. Ai përdor zakonisht edhe togun zanor /-ua/, por në ndonjë rast gjejmë tek ai edhe togun zanor /-ue/ të gegërishtes, si p.sh.: *drueti*¹⁰.

Një gjë tjetër, që të tërheq vëmendjen në veprën e Darës, është edhe përdorimi i pjesoreve dhe i mbiemrave prejpjesorë me togun zanor /-ua-/ të toskërishtes dhe me prapashtesën /-m/, karakteristike për gegërishten, si p.sh.: *gatuam-e, i helmua-m, (më) të kullua-m, i pandëlgua-m, e shkrua-m-ja*, (ndë monë) *shkua-m* etj. Të kihën parasysh edhe emrat prejpjesorë *vra-m-je* (I/III, v. 148, IV/II, v. 184 etj.), *pa-m-je* (III/II, v. 68, IV/II, v. 213 etj.), *le-m-je* (në Parathënie, dhe në shën. e v. 31 të IV/II). Të kihën parasysh edhe *rre-më* [= rrenë] (II/I, v. 250, III/II, v. 31) si edhe mbiemri prejpjesor i emëruar *të nxi-m-e-t* (IV/II, v. 48) etj. Tek ai gjejmë edhe ndonjë trajtë pa rotacizëm, si p.sh. në I/IV, v. 178: *idhënimi*. Të kihet parasysh edhe përdorimi i pjesores (*prë-n* me prapashtesën /-n(ë)/ (te forma e përcjellores *tue prën*)¹¹, ku pritej të kishim *prurë*. Edhe më i papritur është përdorimi i trajtës nëndialektore gege *shpnesë* (shih & 23). Përdorimi i këtyre trajtave të papritura në veprën e një autori, gjuha e të cilit përmban tiparet fonetike të dialektit jugor, mbetet për t'u shpjeguar, aq më shumë kur ai ka përdorur trajtën me rotacizëm atje ku as në toskërishte nuk del kështu, si te (ndë) *vorë* < vonë (III/II, v. 282) dhe *më vorë* < vonë (IV/II, shën. 2). Në pak raste (vetëm në pjesët në prozë) ai ka përdorur edhe shprehjet e ngurosura *vien-më-thën(ë)* dhe *vien-më-rar(ë)* (= do me thënë)¹², ku bie në sy paskajorja perifrastike *me thënë*, përkatësisht *me rarë*

¹⁰ Por ai përdor edhe fjalët popullore me të njëjtin kuptim *droe, dre*.

¹¹ Në botimin te "La Nazione Albanese" dhe në atë të vitit 1906 kjo trajtë është ndryshuar në *tue pru-n*.

¹² Të kihet parasysh se në Pashëniën e tij Dara ka përdorur edhe formën *pa me luftuar* në vend të *pa luftuar*: ...e shkruatin Jusufit tue thënë se, mos ai qasej horëvet e katundëvet tire, do të mbahëshin ndë një an, *pa me luftuar*.

25. Lidhur me gjuhën e veprës së Darës vlen të përmenden këtu edhe nja dy veçori të shqipes së dikurshme, që janë mënjanuar në shqipen e sotme. Është fjala për përdorimin e rrjedhores së shquar shumës më /-sh-i-t/, për përdorimin e rrjedhores pa parafjalë, për përdorimin e rasave gjinore, dhanore e rrjedhore të shquar shumës me nyjën e prapme (në shqipen e sotme ato përdoren rregullisht pa një nyjë të tillë, kurse rrjedhorja e shquar ka dalë jashtë përdorimit prej kohësh). Ja disa shembuj:

a) *bëma-sh-i-t*, *copë-sh-i-t*, *delme-sh-i-t*, *duar-sh-i-t*, *gardhe-sh-i-t*, *gjurmë-sh-i-t*, *ledhe-sh-i-t*, *shkëmbe-sh-i-t*, *shpella-sh-i-t* etj.

b) *ikur turqësh-i-t*, të pandëlguam *Elinësh-i-t*, (Toçi thot se) ndër buletet *më të parësh-i-t...* ishin...; Katër *angonash-i-t* e jetës // viin shqipun llojë-llojë // gjith *shpellësh-i-t* e malevet russhin bishka këtu e këtje etj.

c) *cilona e të krëmëve-t*, te velat *e shpateve-t*, Mbërkuri e Njanji *i Darenjëve-t*, gjërinj Kastoriotit, për an *e Vojsavës*, së bilës *e Prënkut i Mirëditëve-t*, ndë mesët *e shkruamëve-t* e tij; *horëve-t e katundëve-t* tire, *shoqëve-t* mi etj.

26. Për sa i takon fjalorit të përdorur nga Dara në veprën e tij, po vëmë në dukje shkurt se ai jo vetëm që ka shfrytëzuar më së miri leksikun e të folmeve arbëreshe, por është përpjekur të krijojë edhe fjalë të reja. Nga fjalët e vjetra shqipe prej burimi popullor, që ka përdorur Dara, mund të përmenden këtu, sa për shembull, disa fjalë, që në shqipen e sotme ose ndeshen rrallë, ose përdoren me kuptim të ndryshuar, ose nuk përdoren fare, si: *bretëk-u* (mashkulli bretkosës), *djalishk-u* (djalëth), *gëlasëmë-a* (të ngjarë), *gjegj-ënj* (ndëgjoj), *ier* “endur, thurur”, *mend-i*

(çast), *ndëlgonj* (kuptoj), *ngjedh-ënj*¹³ ~ *ngjodha* “ngjesh, shtrëngo”, *nkallon-et* (lulëzon)¹⁴, *perëndi-a* (mbretëri-a), *perëndeshë-a* (perandoreshë), *përderës-i* (lypës), *prire* ~ *u pror-a* (kthehem ~ u kthe-va), *rrahader-i* (endacak), *rrëmb-i* (rreze), *të tim* (të ftohtë), *trizet* (gjashtëdhjetë) etj. Kurse nga fjalët e reja të krijuara prej tij vlen të përmenden sidomos fjalët e prejardhura *atë-rí* (atdhe), *bulër-í* (bujari-a, bujarë-t), *bushtë-rí* (mizori), *flamur-ar* (flamurtar, i lavdishëm), *hënë-tar* (hënor), *lerë-m* (frymë, njeri) etj. si edhe fjalët e përbëra *grund-zi* (flokëzi), *gji-halkom* (gjoks bronzi), *krip-drizë* (me flokë si driza), *krip-shprishur* (flokëshprishur), *krah-rrënkët* (krahfortë), *para-thënëme* (parathënie), *prapa-thënëme* (pasthënie), (deti) *Tej-a-dhen* (deti Jon), *vesh-shtuara* (veshngritur), *moti i mesëm* (mesjeta), *Këmba e Malit* (Piemonte) etj.

+ +
+

27. Edhe nga sa u shtjellua shkurt këtu më sipër, del pak a shumë e qartë se “Kënga e sprasme e Balës” e Gavril Darës është një poemë e bukur, që i ka të rralla shoqet në letërsinë shqipe. Ajo nuk shquhet vetëm për bukuritë e saj të shumta artistike, por edhe për ndjenjat e larta atdhetare dhe njerëzore, që e përshkojnë tejendane. Aty brendia dhe forma janë në harmoni të plotë e këtu qëndron edhe vlera e madhe artistike e

¹³ Giordanoja (f. 322) e ka: *ngjidh-ënj* ~ *ngjodh-a*. Kjo folje nuk ndeshet as tek autorët e vjetër shqiptarë.

¹⁴ Këtë folje të formuar nga emri *káll-i* Dara e ka përdorur vetëm një herë në kapakun e veprës, që është botuar në “La Nazione Albanese” të vitit 1900, Nr. 14. Ai e ka përdorur në formën e mënyrës dëshirore joveprore: *u nkalloftë*. Në të folmen e Borshit dëshimohet trajta *u n-gallua* (me shndërrimin /-k-/ > /-g-/ nën ndikimin e paraprijës /n-/ (shih Çabej: 2002, 57).

kësaj poeme. Me këtë vepër, që s'ka mort, Gavril Dara (i Riu) i siguroi vetes një vend nderi në historinë e letërsisë shqipe, duke u ngritur në radhën e poetëve të mëdhenj atdhetarë, si De Rada, Naimi, Gj. Fishta etj.

Literaturë e përzgjedhur

Arbri i Rii	Arbri i Rii (La Giovane Albania). Pubblicazione mensile diretta da Franc. Stassi-Petta e Giuseppe Schirò. (Anno primo - 1887. Palermo.
Ashta: 2000	Ashta, Kolë. Leksiku historik i gjuhës shqipe. I. Shkodër.
Bala: 1975	Bala, Vehbi. Këngët janë testamenti i të parëve tanë. “Drita”, 16 nëntor 1975.
Brahimi: 1976	Brahimi, Razi. Gavril Dara (i Riu). Kënga e sprasme e Balës. Kthyer në shqipen e sotme nga... Tiranë.
Camarda: 1866	Camarda, Demetrio. Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese. Prato.
Çabej: 2002	Çabej, Eqrem. Studime etimologjike në fushë të shqipes. VI. Tiranë
Dara: 1900-1903	Dara Gabriello. Kënka e sprasme e Balës (Il canto ultimo di Bala). Në: “La Nazione Albanese” të Anselmo Lorecchio-s. Catanzaro.
Dara: 1906	Dara, Gabriello. Kënka e sprasme e Balës. (Il canto ultimo di Bala). Catanzaro.
Demiraj: 1961	Demiraj, Shaban. Kënga e sprasme e Balës. Poemë e Gavril Darës (të Riut). Përshtatur në shqipen e sotme. Tiranë.
Demiraj: 1994	Demiraj, Shaban. Gavril Dara (i Riu). Kënga e sprasme e Balës. Transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme. Tiranë.

- hr/>
- Demiraj: 2002 Demiraj, Shaban. Gramatikë historike e gjuhës shqipe (botim i përmbledhur). Tiranë.
- Demiraj: 2003 Demiraj, Shaban. Rreth autorësisë së poemës ‘Kënga e sprasme e Balës’. “Studime filologjike” 3-4/2003.
- De Rada: 1866 De Rada, Girolamo. Rapsodie d’un poema albanese. Firenze.
- G. D.: 1900 G. D. Gabriello Dara. Në: “La Nazione Albanese”, viti 1900. Nr. 13; dhe në Dara: 1906.
- Jorgaqi: 1988 Jorgaqi, Nasho. Përmasa të reja të Gavril Darës. “Drita”, 19 qershor 1988.
- Kamarda (shih Camarda).
- Kamsi: 2000 Kamsi, Kolë. Fjalor arbërisht - shqip. Shkodër.
- Kodra, Kl.: 1975 Kodra, Klara. Mbi artin poetik të Darës. “Nëntori”, 1975/11.
- Kodra, Kl.: 1983 Kodra, Klara. Gavril Dara dhe vepra e tij “Kënga e sprasme e Balës” dhe disa tipare të formës së saj. SF 1983/2.
- Kodra, Z.: 1955 Kodra, Zijaudin. Kënga e sprasme e Balës. Tiranë.
- La Nazione Albanese Gazetë e përdyjavshme letrare, politike dhe kulturore (1897 - 1924). E drejtuar nga Anselmo Lorecchio. Catanzaro.
- Sasse: 1991 Sasse, Hans-Jurgen. Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Wiesbaden.
- Schirò: 1887 Schirò, Giuseppe. Hyrje për Gavril Darën në “Arbri i Rii” 1887, Viti I; nr. III.

- Schirò: 1907 Schirò, Giuseppe. Canti sacri delle colonie albanesi di Sicilia. Napoli.
- Schirò: 1923 Schirò, Giuseppe. Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia. Napoli.
- Scutari: 1997 Scutari, Pasquale. Uno studio fonologico e morfologico sulla parlata arbëreshë di San Constantino Albanese. Cosenza.
- Tuttolomondo: 1921 Tuttolomondo, Erminia. Un grande nell'ombra. La vita e le opere di Gabriello Dara. Girgenti.
- Varfi: 1976 Varfi, Andrea. Gavril Dara, poet demokrat-revolucionar. "Nëntori" 1976/1.
- Xhiku: 1980 Xhiku, Ali. Romantizmi arbëresh. Tiranë.
- Xhuvani: 1927 Xhuvani, Aleksandër. Kënka e sprasme e Ballës. "Diturija", vëll. II, nr. 8 (1927).
- Xhuvani: 1980 Xhuvani, Aleksandër. Gabriel Dara i Riu. SF 1980/1.

Kënga e sprasme
e
Balës

PARATHËNËME T'ARBRESHËVET

Përintët tan, çekur, ikur Arbrit, erdhën e stisën katundin i Pallac Adrianit ndë vitin 1482, ruatin po çelur ndë zëmërën kujtimën e mallin Atëris sbierr.

Ati birit e biri nipit rrëfiein punët të shkëlqieme e luftat të nderëme, cilat u luftuan ndë mon i Skanderbegut; se ahiera vetëm për së pari e, alëmenò, për së sprasëmi gjith bulëria, gjith trimëria e Arbrit, burra e gra, pleq e të ri, patën një zëmër, tue dashur nderjen e lefterin e dheut ç'i leu, e, çëdo njeri desh, e deshën të gjith.

Andaj asaj përzitje shejte u le fuqia, që për njëzet e pes vjet frajisi mundjen e turqëvet e përpiti, njerën pas tjetrën, ushtrat e Zotit Math, tek-ai që Europa e përmisëme llavej, sa i gjegjej embrin.

Pasandaj e pra që u shua, vit nka vit, te varri që e mblodhi, zulma e madhe e lartit Kastoriotit, u ftohën edhe shokët e tij; iu lips besa, u sgëloth nieja e zëmëravet; kush u shpruar këtej, kush atej; zun e sulën ndër ta, katund me katund, farë me farë, çet me çet. E pra sosi se armiku i keq iu ngul ndë mesët e, si ndodhëshin të ndar, shprishur e gërisur, i zepsi nën një zëgoi hekuri e pra i xarrisji gjith te gjith livadhet e apolës, sa të derdhin për të huajin gjakun arsitur horës vet.

Që ahiera embri i Arbrit u harrua ndë mon e ajo hor e ai gjak, cilët kishin thamasur jetën bëmashit urtëris, qëndruan nd'errët njera më nani. E daft Perëndia se të shuhet nëma e moçëme, që gërisën gjinden tan, ler sa të zotroft, në shtrëngoheshin prap ndë përzitën të par krështenj e maometan, katolik e orthodhoks, që të klofshin, tue llojasur se jan vet t'arbresh!

PARATHËNIE ARBËRESHËVE

Prindërit tanë, qëkur ikën nga Arbëria dhe erdhën e themeluan katundin e Pallac Adrianit në vitin 1482, ruajtën gjithnjë të ndezur në zemër kujtimin dhe mallin e atdheut të humbur.

Ati birit dhe biri nipit i rrëfenin punët e shkëlqyera dhe luftërat e ndershme, që u bënë në kohë të Skënderbeut; se vetëm atëherë për të parën dhe, fatkeqësisht, për të fundit herë gjithë bujarët, gjithë trimat e Arbërisë, burra e gra, pleq e të rij, patën një zemër, duke dashur nderin dhe lirinë e vendit ku lindën, dhe atë që donte njëri, e donin të gjithë.

Andaj nga ai bashkim i shenjtë lindi fuqia, që për njëzet e pesë vjet theu forcën e turqve dhe përpiu njërën pas tjetrës ushtritë e zotit të madh, ndërsa Europa e përmbysur tmerrohej, sa i dëgjonte emrin.

Pastaj, si u shua nga viti në vit në varrin që e mblodhi, zulma e madhe e të lartit Kastriot, u ftohën edhe shokët e tij; u mungoi besa, iu zgjith nyja e zemrave; kush shkoi këtej, kush andej; filluan të ziheshin midis tyre, katund me katund, fis me fis, çetë me çetë. E më në fund armiku i keq iu fut në mes e, pasi ata ishin të ndarë e të përçarë, i vuri nën një zgjedhë hekuri e pastaj i zvarisi të tërë tek gjithë fushat e lindjes, që të derdhnin për të huajin gjakun e mohuar vendit të vet.

Që atëherë emri i Arbërisë u harrua ndër shekuj e ai vend e ai gjak, që kishin habitur botën me ngjarjet e trimërisë, mbetën në t'errët deri tashti. E dashtë Perëndia që të shuhet nëma e moçme, që copëton gjindjen tonë të lindur për të zotëruar, po të shtrëngohen prapë në bashkimin e parë të krishterë e muslimanë, katolikë e ortodoksë, çfarëdo që të jenë, duke menduar se janë vetëm arbëreshë!

+

Por nani prirem atje nka zura.

Pas vdekjen e Skanderbegut e pas që me dhjet vjet luftash e përrrenjsh gjakut më të kulluamit ruatin ndë Kroj nderjen e lefterin Atëris, më të mirëtë e më t'urtit buler dëlpëkuan flamurat e, të helmuar, jo mundur, u shprishën ndër të huajit, tue sbierr horën, sa mos t'e ndërroin me besën e nderjen. Ndër këta të parëshit prindët time, se nomotisen njera sot, Mbërkuri e Njanji i Darënjëvet, gjërinj Kastoriotit për an` e Voisavës, së jëmës e tij, së bilës e Prënkut i Mirëditëvet (Filia Principis Tryballorum - Marinus Barletius). Por mbi gjith prindët e mi te të mbledhurit kujtimat të moçëme e “Kënkat e Pleqëris” lartohen gjishi im, Gavril i Darënjëvet, e ati im, Ndriza (Inzot i bekoft!), se naforisën gjellën tire, sa të koqisin nka dërmak zulmën e gjindes tan, për sa moti i bushtër s’e shkeli e s’e pështroi.

+

Gjishi im mblodhi për së pari “Kënkat e Pleqëris”, cilat pas atë kan klën pjes e pjes tipografisur nka Peshkëpi Krispi, nka Dhimitri Kamarda e nka tjerët, që kan ndëlguar sa vëlen nderja e Arbrit.

Ndë mesët e shkruamëvet e tij më të fëshehurat e më të shtrejtat ati im gjeti pas “Rënkimëvet e Nik Petës e Pal Golemit” nj’etër kënk, cila tek e shkruamja dukej kluar “Kënka e sprasëme e Balës”. Ishin do vjershe, ç’i cënuan zëmërën, pse nxein një rëfieme të plot, të sosëme e adhiasëme te pjesat e saj, më mirë edhe se Kënkat e Kostandinit e të Garentinës.

+

Por tashti po kthehem atje nga nisa.

Pas vdekjes së Skënderbeut dhe, pasi gjatë dhjetëra vjet luftërash dhe përrenjsh gjaku nga më të kulluarit ruajtën në Krujë nderin dhe lirinë e atdheut, bujarët më të mirë e më të urtë palosën flamurët e të helmuar, por jo të mundur, u shpërndanë ndër të huajt, duke humbur atdheun, që të mos e ndërronin me besën e nderin. Midis tyre ndër të parët ishin stërgjyshërit e mi, që përmenden deri sot, Mërkuri dhe Njanji i Darenjve, gjërinj të Kastriotit nga ana e Vojsavës, nënës së tij, që ishte e bija e princit të mirditasve (e bija e princit të Triballëve - Marin Barleti). Por mbi të gjithë të parët e mi në të mbledhurit e kujtimeve të moçme dhe të “Këngëve të Pleqërisë” u dalluan gjyshi im, Gavriili i Darenjve, dhe ati im, Ndrica (Zoti i bekoftë!), sepse flijuan jetën e tyre që të mblidhnin kokrra-kokrra [kujtimet rreth] zulumës së gjindjes sonë, për sa koha e bushtër s’e shkeli dhe s’e mbuloi.

+

Gjyshi im mblodhi së pari “Këngët e Pleqërisë”, të cilat janë botuar pjesë-pjesë nga Peshkop Krispi, nga Dhimitër Kamarda dhe nga të tjerë, që kanë kuptuar sa vlen nderi i Arbërisë.

Midis shkrimeve të tij më të fshehura dhe më të shtrenjta im atë gjeti, pas “Rënkimeve të Nik Petës dhe të Pal Golemit”, një këngë tjetër, e cila në dorëshkrim quhej “Kënga e sprasme e Balës”. Këto ishin do vargje, që i prekën zemrën, sepse përmbanin një tregim të plotë, të mbaruar dhe të lidhur në pjesët e tij më mirë edhe se “Këngët e Kostandinit e të Garentinës”.

Vrap ati im ndëlgoi se këto vjershe de klofshin do copash, mir a lik, traposur; e, tue shtëdhur, llojasi se lipsëshin shum pjes, pse e shkruamëja ngë sillëj tjetër se trizet vjershe e të parës pjes; aqë së ditës e pak më shum e së tretës. Më e më u ndënd ndë këtë druetin, tue par ndë këmbën e fletës këta porosima:

“Bala, ai që bë këta kënga, kle një ushtor i math, atirve që me Gjergjin Mirëshpin stisën këtë katund, ikur këtu pas vëdekjen e Skanderbegut e pas që ra Kroja e, me të, gjith Arbri ndë duarët e Turkut. Pleqët e plakat rëfienjën njera sot (1765) se Bala ish një plak i gjelbër e i rëmaksëm, pa përzit me njerëzit, se shkoj dit e muaj tue vatur mbi çukat e malëvet, u falur Arbit; e do her te velat e shpatevet tue ligjëruar me vetëhen e tue vajtuar shokët e trimëris tij e gjakun athun derdhur e naporisur atëris e lefteris saj.

“Her e her, kurë bushtëronej dimbri e malët me fushat sbardhëllonëshin borës, kërrusej ndë an vatrës e gëzohej tue rrëfier vashavet e kopilëvet punët atij moti, që ai e kluaj “Moti i math”. Bala, që thom u, shihet njera sot zografisur te hroaza ngritur ndë klishtën e Shën Mëris e Hirëvet, përjashta, fitirçelur, hundngrehur, me shapëkën e kuqe, me majën t’arët ndë karkalin si zakona e ushtorëvet tan.”

Tata s’desh tjetër; zu e rrjoth lart e posht si qen ndë gjen, tue pier pleqëvet e plakarushavet ndo dishin “Kënkat e Balës” e pak këtu e pak këtë mblodhi gol nka gol më të shumat pjes, që lipsëshin shkruamëvet e prindit e ia shtoi. Ashtu “Kënga e sprasëme e Balës” muar kurmërë e, do thosha, u shpi e tër ndë gjith pjesat e saj. E, ndo iu lipset ndonjë copëz këtu e këtë, dëmi ishtë i le, pse me trut tan mblonjëm ata pak të mbrazëta.

Im atë e kuptoi shpejt se këto vargje ishin do copa të lidhura mirë a keq; e, duke i lexuar, kuptoi se mungonin shumë pjesë, sepse e shkruara nuk përmbante më shumë se gjashtëdhjetë vargje prej pjesës së parë, aq prej pjesës së dytë e pak më shumë prej pjesës së tretë. Ai u fut gjithnjë e më shumë në këtë dyshim, kur pa në fund të fletës këto shënime:

“Bala, ai që bëri këto këngë, qe një ushtar i madh, një nga ata që me Gjergj Mirëshpinë themeluan këtë katund, ku u shpërngulën, si vdiq Skënderbeu dhe si ra Kruja e, bashkë me të, e gjithë Arbëria në duar të turkut. Pleqtë e plakat rrëfejnë edhe sot (1765) se Bala ishte një plak i fortë dhe i vrazhdë, nuk përzihej me njerëzit, kalonte ditë e muaj duke u ngjitur çukave të maleve për t’iu falur Arbërisë e herë-herë shkonte në thellësitë e shpateve duke ligjëruar me vete dhe duke vajtuar shokët dhe gjakun e derdhur dhe të blatur më kot për atdheun dhe lirinë e tij.

“Herë-herë, kur egërsohej dimri dhe malet e fushat zbardhëllonin nga bora, ai kërrusej ndanë vatrës dhe kënaqej duke u rrëfyer vashave dhe djemve punët e asaj kohe, që e quante “Moti i Madh”. Bala, që them unë, shihet edhe sot i vizatuar në pikturën e ruajtur në kishën e Shën Mërisë së Hireve përjashta, fytyrëçelur, hundëngritur, me shapkë të kuqe, me majën e artë në karkal, siç ishte zakoni i ushtarëve tanë.”

Im atë s’desh tjetër; zuri të bridhte lart e poshtë si langoi pas gjahut, duke pyetur pleqtë e plakat në dinin “Këngët e Balës” dhe pak këtu e pak këtje mblodhi gojë më gojë pjesët më të shumta, që mungonin në të shkruarat e prindit të tij, dhe ua shtoi. Kështu “Kënga e sprasme e Balës” mori kurm e, do të thosha, u shtjellua në të gjitha pjesët e saj. Dhe, sado që i mungon ndonjë pjesë aty-këtu, dëmi është i lehtë, sepse me mendjen tonë i mbushim ato zbrazëti.

U prana që arrëjta i treti e i sprasëmi e kurë gjindja e moçëme s'ish më ndë jetën, pak gjeta e pak i shtova, po sa vetëm “Kënkën e Zogut”, xën që mirencie, se pra, sa sgëlodha “Kënkën e Balës”, më duku e më duket ler e kulluame trush që puall tjerat e se shtonet vetëm vendit tek u e kam kllitur.

U llojas se as gjishi, as prindi im patën t'e gjegjën kurr, pse, ndë t'e kishin njohur, së harronëshin t'e shkruain, si shkruatin e më truatin, si për dhjat, tjerat kënga. Pata mbësuar “Kënkën e Zogut” golës e Zonjës Marës e Bidherënjëvet, së nunëlës sime emëtje, zonjës Marukës e Darenjëvet, s'ëmës tim kushëriu, Tuzës i Kjarënjëvet, cili ndë këta mot t'errëta çeli prap dritën e Arbrit e shtuall flamurin të nderëm mballa mbretërivet e qevarrivet e jetës e bë sa të njihej gjithasajtëna se këtu, afër Italis, te tjetëra rrëz e deitit tën rron edhe një gjinde e urtë e e shkluame, cila bërtet e do lefteri, qevarri katundare e vendin ç'i përket ndër tjerat gjinde e Europs. Por, si thosha, Zonja Marë e Bidherënjëvet kle ajo që më mësoi “Kënkën e Zogut”.

Ish ajo një bulëresh e madhe e e nderëme e, ndo se e moçëme, e gjelbër e e gjall. E kam te sit me atë kez krisomeni të shkëlqieme, me shqepin shtën prapa shirit, rar njera te këmbët, me kumbarën saravilusht, qëndisur ari, hapët ndë gjirin e shtrënguar me një tërkuzëz ari, se edhe plak vej, dimbër e ver, me kriet e llorët sbluar. Brezi i arët ish hisur rreth-rreth konëzash shejtërash e ndë mesët, ndë vent i vukullës, shihej Shën Gjergji nkaluar, tek-ai që stëlloj drangorin. Cilona e të krëmëvet vlej ajo vetëm sa një vistar; ier ari e mundafshi, si dromidhe, gjith tuf-tuf lulesh, sa të mirrin sit. Edhe kaliqet e saj ishin krisomeni mburthier me sumbulla t'arëta mbi tirqit të mundafështa, qëndisur ari.

Pastaj unë që erdha në botë i treti dhe i sprasmi, kur gjindja e moçme nuk ishte më në jetë, pak gjeta e pak i shtova, vetëm “Këngën e zogut”, të cilën e kisha mësuar që në vegjëli. E, sa lexova “Këngën e Balës”, m’u duk e më duket se kjo ka dalë e kulluar nga truri, që polli të tjerat dhe se shtohet vetiu në vendin, ku e kam shtënë unë.

Unë mendoj se as gjyshi, as prindi im nuk e patën dëgjuar kurrë këtë këngë, sepse, po ta kishin njohur, nuk do të kishin harruar ta shkruanin, ashtu siç shkruan e më truan si me testament këngët e tjera. Unë e pata mësuar “Këngën e zogut” nga goja e Zonjës Marë të Biderënjve, s’ëmës së tim kushëri, Petro Kiarës, i cili në këto kohë të errëta e ndezi prapë dritën e Arbërisë dhe shpalosi flamurin e nderuar përballë mbretërive dhe qeverive të botës dhe bëri të njihet kudo se këtu afër Italisë, në bregun tjetër të detit Jon rron edhe një popull trim e i shquar, i cili ngre zërin e kërkon liri, qeveri kombëtare dhe vendin, që i përket në mes të popujve të tjerë të Europës. Por, siç thashë, Zonja Marë e Biderënjve qe ajo që ma mësoi “Këngën e zogut”.

Ajo ishte një bujareshë e madhe dhe e nderuar dhe, ndonëse e moçme, e fortë dhe e gjallë. E kam para syve me atë kezën e artë e të shkëlqyer, me shqepin që e mbante të hedhur prapa qafës dhe që i binte deri te këmbët, me jelekun e mëndafshhtë të qendisur në ar, të hapur në gji dhe të shtrënguar me një brez të artë, sepse edhe në pleqëri rrinte dimër e verë me llërët zbuluar. Rreth e rreth brezit të artë ishin skalitur fytyra shenjtorësh dhe në mes, në vend të mbërtheckës, shihej Shën Gjergji kaluar, tek qëllonte dranguan. Vetëm kotulla e të kremteve i vlente sa një thesar, duke qenë e endur prej ari e mëndafshi si pëlhurë, gjithë tufë-tufë lulesh, që të merrnin sytë. Edhe kaliqet e saj ishin prej ari dhe mbërtheheshin me sumbulla të arta mbi tirqit e mëndafshhtë të qendisur në ar.

Kujtonem se, kurë shkoj ajo të vej te Klisha e Madhe për pashk, a te darësëmet e gjërivet, me kriet lart e sbluar e me ata bukura stoli, na dukej një perëndesh e ngë shuashim t'ë vërreim, njera çë perëndoj. Këjo bulëresh, po sa ish më e lart e e urt e e ndëlguame, aqë ish e mir zëmërje bëmash e haidhjare me gjith. Të qosëm e të vabëq, të varfër e të helmuamë, njerët vein t'ë heretisin, tjerët për hir, për ndihm, a për harom, e nka njeri prirej gëzuar, se dora e saj, po e hapët, fjala e ëmbël e lipsiare sivasin, ndo mos shërojin, gjith helmet. Por trashëgimi më i madh i saj ish harea e mirencievet (u po i ndodhesha), kurë, pra çë na kish thirr nka lakotea e saj, na jip kuleçëzit t'ëmblla, petullat gjeshur me mjaltin, nkriqëzit e her e her edhe,sa nxej luga, nka njerit një frogamosmi bër me fleta trëndafilësh shtipur si gjalpët e zier me zahar, se ajo na thosh se kluhej frogamosmi i Arbrit.

Pra ç'ishim citur, ulëshim rreth asaj e ndo na rrëfiej prallëzat të moçëme e Skanderbegut e trimavet tij, ndo na këndoj e na mbësoj “Kënkat e Pleqëris”, se i kish gjith ndë trut e, si zëj fill, ngë sosëj më. Tjerat u, si voglëth, i harrova; por ngë di si më qëndroi ngjitur e vetëm “Kënka e Zogut”, thomse pse më duku më e bukur e andaj e mbësova më vrap e më mirë. Zonja Marë na rrëfiej se këtë kënkë po e këndoj e nunëla e saj, zonja Martuka e Suljatëvet, cila, sepse ngë gjetën dhafn, vu kuror me gùrpar e me uvrì e andej i duallën kënkën, çë thot:

Mos bëni si Suljat,
Se me gùrpar e me uvrì
Vun kuror atë menat.

Pra ajo i shtoj se Bala ngë bë vetëm “Kënkën e Zogut” por shum të tjera, se zëin fill, çë kurë Skanderbegu, ikur

Më kujtohet se, kur kalonte ajo për të vajtur në kishë të madhe për pashkë apo në dasmat e gjërinjve, na dukej si një mbretëreshë dhe nuk nginjeshim së pari, derisa largohej fare. Kjo bujareshë, sa ishte e lartë, e urtë dhe e ndershme, aq ishte edhe e mirë nga zemra dhe nga veprat dhe e dashur me të gjithë. Të pasur dhe të varfër, bonjakë dhe të helmuar vinin tek ajo - disa për ta përshëndetur, disa për ndonjë hir, për ndihmë apo për të holla - dhe secili kthehej i gëzuar, se dora e saj gjithnjë e hapët, fjala e saj e ëmbël dhe plot dhembshuri, në mos ia shëronin, ia lehtësonin gjithë helmet. Por kënaqësia e saj më e madhe ishte gëzimi i fëmijëve (e unë gjendesha gjithnjë pranë saj), kur, pasi na thërriste nga çardaku, na jepte kuleç të ëmbël, petulla të ngjeshura me mjaltë, kryqe e herë-herë secilit edhe nga një lugë plot me reçel trëndafilash të shtypur si gjalpë e të zier me sheqer; për këtë ajo na thoshte se quhej reçel i Arbërisë.

Si ngiheshim, uleshim rreth saj e ajo nganjëherë na rrëfente përrallëza të moçme të Skënderbeut e të trimave të tij, ose na këndonte e na mësonte “Këngët e Pleqërisë”, se i kishte të gjitha në tru e, si zinte fill, nuk mbaronte më. Unë, si i vogël, të tjerat i harrova, por nuk di si më mbeti në kujtesë vetëm “Kënga e zogut”, ndoshta sepse m’u duk më e bukur dhe prandaj e mësova më shpejt e më mirë. Zonja Marë na rrëfente se këtë këngë e këndonte gjithnjë e nunëla e saj, Zonja Martukë e Suljatëve, e cila, pasi nuk gjetën dafina, vuri kurorë me kulpra e urthe e prandaj i nxorën këngën, që thotë:

Mos bëni si suljatët,
që me kulpra e me urthe
vunë kurorë atë menatë.

Ajo shtonte se Bala nuk bëri vetëm “Këngën e zogut”, por edhe shumë të tjera, të cilat zinin fill, qëkur Skënderbeu, si iku pej turqve, gënjeu me myhyrin e sulltanit pashanë, që ishte

turqëshit, gënjeu me unazën e Zotit Math pashallarín, ç'ish Krojë, e pra, luft nka luft, arrein njera te “Dita e Dibrës”, kurë klen zën Mozezi i Golemëvet me të shtat shokët e tij e vëdiqën Nik Peta e Pal Golemi, me katërqint trima te Sheshi i Valkalit.

Bala, si thuaj ajo, ish nka shpia e Balçëvet, se më parë ngë kluheshin ashtu, por muarën këtë embër, që kurë Balshi i pari afër njëqint vjet më prapa se Kastoriotët mundi turqit ndë amah të math, kle kluar Dhespoti të gjith Arbrit e pra u sgjërua mbi Malin-Ziun e horët përtej, e nka tjetëra an arrejti njera te Maqedhonia e andaj kle kluar “Dhespoti i Math” (vërre Ketën, Dhimitrin Kamardhin e tjerat).

Kam ligjëruar shumë mbi Zonjën Marën e Bidherënjëvet, pse puna edhe më holqi e pse, si tjerët pleq, u rronj ndë mon të shkuam; e trashëgonj tue kujtuar gjinden e zakonët perënduar. Ajo vëdiq ndë vitin e kukudhit 1837 e me të u shua e sprasëmja bulëresh, që po ruati zakonen të vej veshur si të moçëmet t'arbëresha.

U përvesha “Kënkën të sprasëme e Balës” për së pari italisht ndë vjershe e prap fjal nka fjal, sa t'e ndëlgonjën litinjët e sa edhe t'arbreshët e Arbrit, që kan përzier e trazuar gëluhën me turqit e me gjitonët, llojasëshin se gjaku in i shprishur ndër katundët t'arbresh Italis e ndër të huaj ka ruar që katërqint vjet jo vetëm këtë gëluh, por edhe të folët kulluar e stolisur, si flitej ndë mon t'arët i Arbrit, ndë mon i Skanderbegut. Pse dihet gjithasajtëna se horët e katundët, tek ven e jesënjën njerëzit përzën atëris tire, mbanjën e ruanjën pa përzit gëluhën siell ndë dhe të huaj e se, tek-ai që ndërronet e trazonet me motin te hora e lemjes, këtë qëndron si ish te moti i par.

Ashtu spanjollët thon se gëluha së vjetrës Kastiljes flitet më bukur se gjetëk ndë Mesik, tek e qellën Ferrandi Kortës e shokët e tij; e ashtu shohënjëm se gëluha më e mirë Italis

në Krujë, e pastaj nga lufta në luftë ato arrinin deri te “Dita e Dibrës”, kur qe zënë rob Moisiu i Golemëve me të shtatë shokët e tij e vdiqën Nik Peta e Pal Golemi me katërqind trima te sheshi i Valkalit.

Bala, siç thoshte ajo, ishte nga shtëpia e Balshajve, të cilët më parë nuk quheshin ashtu, por e morën këtë emër, qëkur Balsha i Parë, afër njëqind vjet para Kastriotëve mundi turqit në një betejë të madhe dhe u shpall sundimtar i gjithë Arbërisë e pastaj u shtri mbi Malin e Zi dhe viset përtej, e nga ana tjetër arriti deri në Maqedoni e prandaj qe quajtur “Dhespoti i Madh” (shih Ketën, Dhimitër Kamardën etj.).

Fola shumë për Zonjën Marë të Biderënjve, sepse më hoqi edhe puna dhe sepse, si pleqtë e tjerë, unë rroj me kohën e shkuar dhe kënaqem duke kujtuar njerëzit dhe zakonet e perënduar. Ajo vdiq në vitin e kolerës, 1837, e me të u shua bujaresha e fundit, që ruajti gjithmonë zakonin të dilte veshur si arbëreshet e moçme.

Unë e ktheva “Këngën e sprasme të Balës” së pari italisht në vargje si edhe fjalë për fjalë, që ta kuptonin italianët dhe që edhe arbëreshët e Arbërisë, të cilët e kanë përzier e trazuar gjuhën me ato të turqve dhe të fqinjëve, të kuptojnë se gjaku ynë i shpërndarë nëpër katundet arbëreshe të Italisë e ndër të huaj qysh prej katërqind vjetësh ka ruajtur jo vetëm këtë gjuhë por edhe të folurit e kulluar dhe të bukur, ashtu siç flitej në kohën e artë të Arbërisë, në kohën e Skënderbeut. Sepse dihet kudo se viset dhe katundet, ku erdhën të banonin njerëzit e përzënë prej atdheut të tyre, mbajnë e ruajnë të papërzier gjuhën e sjellë në dhé të huaj; e ajo, ndërsa në vendin e lindjes me kohë ndryshohet dhe përzihet, këtu qëndron siç ishte në kohën e parë.

Kështu, spanjollët thonë se gjuha e Kastiljes së vjetër flitet më bukur se gjatë në Meksikë, ku e shpunë Fernando Kortesi me shokët e tij; gjithashtu shohim se në Itali gjuha më mirë flitet në malet e ndër shpatet afër Pistoias e Sienas, në

kërruset mbi malët e ndër shpatet afër Pistojës e Sienës, te kalivet shprishur ndë shkreti, tek jesënjën si të huaj qush e delmer e flasënjën njera sot, si flisin Danti e Dini Kompanji.

Si përroi i shiut helqën dushqit e botën e fushës e së nget rehjet, ashtu lumi i motit le pa ngar zakonët e të folët rëkukur largu rrëzës e tij. U dafsha se “Kënka e Balës” kloft arbreshëvet (a shqiptarëvet) atë që klen elinëvet të moçëmëvet kënkat e Omirit: dhjata e përzitës, flaka e lefteris, kamastra e mallit, për të lidhur sa vëllezër flasin me një gëlulh, sa njihen të ler njëi gjaku, sa jesënjën nka këmba e Mali-Ziut e nka çukat e Mirëditës e Himarës njera te deiti i Artës e Janinës!

Arnaut, mirëdit, gjegj, toshk, çam, himariot e sa farë jan, të u kujtoshin se besa e tire do jet një: besa e shejte e Arbrit! E mos u dukët fritur të folët e mi, sikurse të vëfsha mballa-mballa të errëtin Bal me të llamparisëmin Omirin, pikën ujit me deitin, pse njeri e tjetëri gëlisen prej mallit i horës e tire e njeri e tjetëri i vu zëmërën, gjith gjakun, gjith gjellën, për sa nka njeri pat nka Perëndia.

E Bala, si Omiri, na përparën trimat e buletët e “Motit Math” e punëtë shkëlqieme tire si pasëqir, ku të vërrehëshin nipërat, sa të çelëshin urtëris e nderjes, pa njomur e pa shtrëmbuar kurr këmbë nka udha e madhe e prindëvet.

U ndëlgonj se, mos sбирëshin “Kënkat të para e Balës”, që pat shkruar ndë trimërin e tek kish mbledhur e zografisur ata lufta rezehtësh, cilat ai kle pjes e madhe, thomse edhe Arbri jin të kish pasur Omerëthin tij.

Por, sa i vogëlith e i xheshur që të kloft visarëthi, që na ruatin prindët tan, arren sa të njohënjëm sa të mira na vodhi fati jin i keq. Ki fat i keq së duket akoma glir helmëvet të pasosëme e Arbrit.

kasollet e shpërndara në vise të shkreta, ku banojnë si të huaj fshatarë e delmerë e flasin deri më sot, ashtu siç flisnin Danteja e Dino Kompanji.

Sikundër përroi i shiut vë përpara dushqet dhe dheun e fushës, ndërsa kodrat s'i nget, ashtu edhe lumi i kohës i lë pa ngarë zakonet e të folët e strukur larg bregut të tij. Unë do të doja që “Kënga e Balës” të ishte për arbëreshët (a shqiptarët), ashtu siç ishin për helenët e vjetër këngët e Homerit, dhjata e bashkimit, flaka e lirisë, hallka e dashurisë, për të lidhur të gjithë ata vëllezër, që flasin një gjuhë, ata që njihen të lindur prej një gjaku dhe banojnë që nga Mali i Zi e nga çukat e Mirditës e të Himarës deri te deti i Artës e i Janinës.

Arnautët, mirditasit, gegët, toskët, çamët, himariotët e sa farë janë, le të kujtojnë se besa e tyre duhet të jetë një: besa e shenjtë e Arbërisë! E të mos ju duket e zmadhuar kjo fjala ime, sikur unë të krahasoja Balën e panjohur me të shkëlqyerin Homer, pikën e ujit me detin, sepse që të dy i ngjajnë njëri-tjetrit nga malli për ardheun e tyre dhe si njëri si tjetri vunë për këtë gjithë zemrën, gjithë gjakun, gjithë jetën, që secili pati nga Perëndia.

E Bala, si Homeri, nxjerr përpara trimat e bujarët e “Motit të Madh” e punët e tyre të shkëlqyera si në një pasqyrë, ku të shihen nipërit, me qëllim që t'u ndizet trimëria dhe nderi, pa u dobësuar dhe pa u larguar kurrë nga udha e madhe e prindërve.

Unë mendoj se, po të mos kishin humbur “Këngët e para të Balës”, që ai pati shkruar në rininë e vet dhe ku kishte përmbledhur e përshkruar ato luftëra gjigantësh, në të cilat edhe ai vetë mori pjesë, ndoshta edhe Arbëria jonë do të kishte pasur Homerthin e saj.

Por, sado i vogël e i zhveshur të jetë, visari, që na ruajtën të parët tanë, mjafton të na bëjë të njohim se sa të mira na vodhi fati ynë i keq. Ky fat i keq duket se nuk është ngirë ende me helmet e pasosura të Arbërisë.

Gjindja jon e vogël ndodhet shtitur nka një an turqëshit, se i vun zëgojn; nka tjetëra Austris, se do t'i vër të sain. E, sa të mos kloft përpitur, do a mos, ka të kumbiset mbi gjitonët të vegjël si ajo, se ngë kan gërrik, sa t'e përcjellënjën; po sa shtuar e shtrënguar të pakët me të pakët, u bëshin gjith të rrënkët si domati roman.

Këta gjiton jan Mali-Ziu, Maqedhonia e Mbretëria e Elinëvet. E dihet se këta hor luftonjën ndë fëshehët sa të helqënjën prej pjesët të tire mallin e zëmërat t'arbreshëvet e se ndë këtë zjarm i frinjën turku nka një an e Austria nka tjetëra, të dia me një kufi, vjen-me-rar sa të mbanjën ndar Arbrin e t'e nakatosënjën si kulla e Babelit, më keq se si ndodhet; sa pra, arrejtur hera e tire, t'e përciellëshin thel-thel, ndo mos ndë një kapshore.

Por isht nevojshëm sa të vërrehen mballa-mballa të tri niet, ç'i mpërparen arbreshëvet, sa të llojasëshin cila kloft më kollaj, sa të sgëlidhet.

Mali-i-Zi isht i pakëz e i vogëlëth e pa mundje të rrituri, pas që Austria i mbillti gjith dierët, tue reshtur njera te Bosnia e tek Ercegovina. I shtonet se Mali-i-Zi isht i huaj Arbrit lemje, gëlujhe, zakonësh e kujtimash, sa kurr ndër ta kan bër përzit. Gjitionia e tire, që mot e smot, ka klën gjitoni luftash e vjedhurish; e sinorët tire janë sinorë gjaku. Vet ndë mon i Balçënjëvet t'arbreshët u kumbisën mbi Malin-Ziun; por ai mot kle shkëptim, që u shua ndë errësir. Edhe sot Arbri isht trazuar, pse turku te kuventa e Berlinit shiti Malit-Ziut do katundëz t'arbresh; e do vrasënjën e do vriten, sa të mos ia japënjën. Po si kloft se ai Arbër, që zihet e bën triqimi për di katundëz, të përzihet pra me gjith horët e katundet e tij e të shtrëngonet ndë përzit vllamje Malit-Ziut?

Populli ynë i vogël gjendet i shtrënguar nga njëra anë prej turqve, që i vunë zgjedhën, nga ana tjetër, prej Austrisë, e cila do që t'i vërë zgjedhën e saj. Prandaj, që të mos përpohet, do a s' do, duhet të mbështetet te fqinjët e vegjël si ai, sepse ata nuk kanë aq grykë, sa ta gëlltitin; dhe në këtë mënyrë, të bashkuar e të shtrënguar të pakët me të pakët, bëhen të gjithë të fuqishëm si demeti roman.

Këta fqinjë janë Mali i Zi, Maqedonia dhe mbretëria e helenëve. Dihet se këto vende luftojnë fshehtazi për të tërhequr secili nga ana e vet dashurinë dhe zemrat e arbëreshëve; dihet edhe se këtij zjarri i fryjnë turku, nga njëra anë, dhe Austria, nga ana tjetër, që të dy me një qëllim, d.m.th. për ta mbajtur Arbërinë të ndarë e për ta ngatërruar edhe më keq sesa është, porsi Kullën e Babilonit; e kështu, kur t'u vijë çasti i tyre, ta gëlltitin thela-thela, në mos edhe si një kafshatë.

Por është e nevojshme të shqyrtohen një nga një të tria nyjat, që u paraqiten arbëreshëve, që kështu ata të kuptojnë se cila është më e lehtë për t'u zgjidhur.

Mali i Zi është i pakë e i vogël dhe pa mundësi të rritet, pasi Austria ia mbylli të gjitha dyert, duke u shtrirë deri në Bosnjë e Hercegovinë. Do shtuar se Mali i Zi ndryshon nga Arbëria, për sa i takon origjinës, gjuhës, zakoneve e kujtimeve, aq sa s'kanë pasur kurrë bashkim midis tyre. Fqinjësia e tyre qysh prej shumë kohësh ka qenë fqinjësi luftërash e vjedhjesh dhe kufijtë e tyre janë kufij gjaku. Vetëm në kohën e Balshajve arbëreshët u mbështetën mbi Malin e Zi, por kjo kohë që si një shkrepim, që u shua në errësirë. Edhe sot Arbëria është gjithë e trazuar, sepse turku në Kuvendin e Berlinit i shiti Malit të Zi do katunde arbëreshe e [arbëreshët] do të vrasin e do të vriten që të mos ia japin. Pra, si do të jetë e mundur që ajo Arbëri, e cila zihet e bën zhurmë për dy katunde, të bashkohet pastaj me gjithë viset e katundet e saj e të futet në lidhje vëllazërie me Malin e Zi?

Priremi nani Maqedhonis.

T'arbreshët e maqedhonoriotët jan më se gjërinj ndër ta. Çë më par se Fëlipi i Përdikës, mbretia e Maqedhonis reshtej edhe mbi një pjes e Arbrit; e pra nën Fëlipin, arn mbi arn, kle shtuar gjith losnikut i tij. E ashtu qëndroi nën shkopin e Leshit të Madhit e, i vëdekur ki, nën mbretërëvet, çë ndajtin ndër ta të shqerrat e tij.

Ndë atë mon (si na thon shkruazit të moçëm) maqedhonoriotët flisin me një gëluh të pandëlgume elinëshit. E kur Leshi i Math ndër luftën prirej argjiraspidhëvet (se ishin gjith maqedhonoriot), sa mos mirrin vesh tjerët ushtor elin, i flisëj maqedhonorisht.

U llojas se ajo gëluh ngë do t'ish tjetër se arbresha, a gëlar t'arbreshës, pse t'arbreshët e maqedhonoriotët jan di dega (si edhe elinët) njëi druri, drurit pellasg, e pse embrët shumëshë horësh e katundësh të moçëme e Maqedhonis përkesënjën gëluhës tan.

Andaj isht ndë udhë se, gjërinj çë jan, të shtonëshin e të përziehëshin bashk ndë vllamje, pse, ashtu kumbisur, vëllau vëllaut, shoku shokut, dëftoshin dhëmbët qenëvet të huaj.

Por t'arbreshët e maqedhonoriotët kan të ndëlgonjën se, edhe shtuar, sa u bëfshin sa një kurm e një zëmër vet, po klofshin pakëz e të vogjëlez mballa rrehevet e gjitonis, se nka sinorët i vërrenjën me si e gol sgardhëlluar e i thithënjën edhe frimën.

Të u kujtofshin se mbretërit e Europës shohënjën pa kujdes (ndo mos me zëmërim) helmet e gjindëvet shkelur e gërrisur turqëshit e më tepër pse ndër qevarrit, çë muarën pjes pajtimëvet e Berlinit, u ndoth e ndodhet ajo Austrie, se, sa të kolloqisënj më shumë, ka di cep, ajo çë do reshtënj thonjët njera Salonik.

Të kthehemi tashti te Maqedonia.

Arbëreshët e maqedonasit janë më se gjiri midis tyre, Qysh përpara Filipit të Perdikës mbretëria e Maqedonisë shtrihej edhe mbi një pjesë të Arbërisë; e pastaj nën Filipin copë pas cope i qe shtuar sundimit të tij. E ashtu qëndroi nën skeptrin e Lekës së Madh e pas vdekjes së këtij nën mbretërit, që ndanë midis tyre pjesët e mbretërisë së tij.

Në atë kohë (si na thonë historianët e moçëm) maqedonasit flisnin një gjuhë të pakuptuar nga helenët. E, kur Leka i Madh në luftë u kthehej argiraspidëve (që ishin të gjithë maqedonas), që të mos e merrnin vesh ushtarët e tjerë, u fliste maqedonisht.

Unë mendoj se ajo gjuhë nuk do të ketë qenë tjetër veçse gjuha e arbëreshe, ose një gjuhë që i ngjante arbërishtes, sepse arbëreshët e maqedonasit janë si dy degë (si edhe helenët) të një druri, të trungut pellazg, dhe sepse emrat e shumë viseve e katundeve të moçme të Maqedonisë i përkasin gjuhës sonë.

Prandaj është e udhës që si gjiri që janë, të bashkohen e të lidhen së bashku në një vëllazëri dhe kështu, të mbështetur vëlla me vëlla, shok me shok, t'u tregojnë dhëmbët qenve të huaj.

Por arbëreshët dhe maqedonasit duhet të kuptojnë se, edhe duke u bashkuar e duke u bërë si një trup me një zemër të vetme, do të jenë gjithnjë të pakë e të vegjël përballë fqinjëve gjigantë, të cilët nga kufijtë i vërejnë me gojë e sy të zgurdulluar e u thithin edhe frymën.

Ata le të mendojnë se mbretëritë e Europës i shohin pa kujdes (në mos edhe me zemërim) helmet e kombeve të shkelur e të copëtuar nga turqit, më tepër sepse ndër qeveritë, që morën pjesë në traktatet e Berlinit, u ndodh e ndodhet ende ajo Austri,

T'arbreshët e maqedhonoriotët, të vetëm, së kan fuqin të mundënjën e të përzën turkun te shkretira, nka erdhi, e të ruhen te një her gjurmëshit e Austries. Të vërrefshin ata sa te moti in u godit këtu ndë Italin. Njera që gjindja italishte u ngrë e vetëme e pa një krie, sa të përzëj të huajn e qevarrit të keq, derdhi përrenj gjakut më të kulluam, por ra prap e për her së pat lefteri. Që kur pra italiotët me më mir këshill u pruarën e u truat in njëi mbreti t'urti e ai i mblodhi gjith nën flamurin tij, qevarrit të keq u përmisën, i huaji iku e mbretërit e Europës zun e i ponisën e i sivasën e nani zotronjën ndë shpin tire të lum e të nderëm.

Çëdo kle Këmba-Malit italiotëve, kloftë edhe t'arbreshëve e maqedhonoriotëve mbretëria e Elinëve. T'arbreshët, maqedhonoriotët e elinët jan njëi farje e njëi rrënje; e gëluha e tire, për së pari një, pra u nda ndër di përrenj; njëri u ntrash e u bë lum i math e i thieft e u sgjërue te jeta; tjetëri u mbet i vogël e i ngusht e i panjohur, afër kroit. Por të dia së kan sbierr kurr gëlasëmën të parë si bila njëi ëmje.

Çë nka moti i Omirit t'arbreshët, kluar ahiera Elin (embër që pra lan sa t'e mirrin grekërat), njihëshin si gjërinj me akenjët, pse van bashk tek amahi i Trojës, bashk luftuan e bashk mundën Asin të mbledhur atje. Pas shumë vjet prindi i istoris, Irodhoti, tek rrëfietur se Leshi, mbreti i maqedhonoriotëve, mbrëmanet përpara luftës e Platës kallëzoi Aristidhit këshillët e Medhëve, la edhe shkruar se ahiera kle njohur pameta se maqedhonoriotët ishin gjërinj elinëve e se kishin liq të mirrin vend në kuventën e Anfitionëve, ç'ish Pleqëria e Madhe e gjithë farëve pellasgotë. Irodhoti pra thot se ndë mon tij pellasgjët jisin afër Dodhonës (tek Arbri aposhtaz), vien-methën te djepa i besës të gjithve elinëve; e shton se Athin, përtej Akropolit, te pjesa kluar "Palla Polis" (Plaka-horë) i jisin të sprasëmit pellasgjë, se kishin një të fol e cila, për të gëlltitur më shumë, ka dy sqepa, ajo Austri, që do t'i shtrijë thonjtë deri në Selanik.

Arbëreshët e maqedonasit, vetëm, nuk kanë fuqi ta mundin e ta përzënë turkun në shkretirën nga erdhi, e të ruhen në të njëjtën kohë nga kthetrat e Austrisë. Ata le të vërejnë se ç'ngjau në kohën tonë në Itali. Derisa populli italian u ngrit i vetëm e pa një krye, për të përzënë të huajin dhe qeveritë e këqia, derdhi përrenj gjaku nga më të kulluarit, por për herë u mposht e s'e fitoi lirinë. Por, kur italianët, duke u menduar më mirë, u kthyen dhe ia besuan veten një mbreti të urtë e ai i mblodhi të gjithë nën flamurin e tij, qeveritë e këqia u përmbysën, i huaji iku e mbretëritë e Europës zunë t'i nderojnë e t'i marrin me të mirë e tashti zotërojnë në shtëpitë e tyre të lumtur e të nderuar.

Ç'qe Piemonti për italianët, të jetë për arbëreshët dhe maqedonasit mbretëria e helenëve. Arbëreshët, maqedonasit dhe helenët janë prej një fare e prej një rrënje. Gjuha e tyre, në fillim e njëjtë, më vonë u nda në dy përrenj; njëri u zmadhua e u bë një lumë i madh e i kthjellët e u zgjerua në botë, tjetri mbeti i vogël e i ngushtë e i panjohur afër burimit. Por që të dyja këto gjuhë s'e kanë humbur kurrë ngjasimin e parë si bija të një nëne.

Që nga koha e Homerit arbëreshët, të cilët atëherë quheshin helenë (emër që pastaj e lanë ta merrnin grekët), njiheshin si gjiri me akenjtë, sepse bashkë vanë në luftën e Trojës, bashkë luftuan e bashkë e mundën Azinë e mbledhur atje. Pas shumë vjetësh babai i historisë, Herodoti, duke treguar se Aleksandri, mbreti i maqedonasve, në mbrëmjen para luftës së Platesë i kallëzoi Aristidhit mendimet e medëve, e la edhe të shkruar se atëherë u kuptua përsëri se maqedonasit ishin gjiri me helenët dhe se kishin të drejtë të merrnin pjesë në Kuvendin e Anfitionëve, që ishte Pleqësia e Madhe e gjithë farëve

të pandëlguam elinëshit. E edhe nani pas aq mon, tek ai vend i Athinës, që sot si ahiera kluhet Plaka, rron e lulëzon një gjinde e arbresh gluhje, gjaku e zakonësh, për të dëftuar jetës se mbolia e jonëvet ngë ka pasur mundje, sa të thanj vllastarin të humbët e të rrënkët kucarit të par.

Gjith jeta di pra se Leshi i Math, me maqedhonoriotët e t'arbreshët përzier elinëvet, sfrajisi mbretërin e Persëvet e zotroi mbi gjith Asin.

Pasandaj, mirë a keq, t'arbreshët, maqedhonoriotët e elinët, njera sa të arrëhet te Pirri (Burri), mbetën bashk e mbajtën ndë dre edhe romanët e pra, mos kishin pasur një mbret të frikosëm e pa ndëlgim, Persein, thomse se zotëria e jetës së shpëtonej duarshit e gjindes pellasgjotës. Përshkonjëm romanët e motin-të-mesëm e arrenjëm te ditët e prindvet tan.

Ku u çeli e para flak e lefteris e elinëvet?

Janina kle vatra, tek mblidhëshin gjith burrat t'urt t'Arbrit, e Maqedhonis e Elladhës e atje ndër spudhit bëin këshill, sa të lërofshin atërin tire. E andaj u ngre Aliu i Tepelenit, burr i urt, i math, ndo se i pafanëm, që kallëzoi i pari kalbësirën, që ha mbretërin e turqëvet e dëftoi elinëvet si t'e mundëshin e si të lefterosëshin.

Trimat e Sulit ven edhe sot gol nka gol ndë gjith jetën e të di Bosdarët e Xavella e Kanari e Miauli e një mil tjera ishin t'arbresh e derdhën gjak e drit mbi gjith livadhet, mbi gjith suvalat e Elladhës.

Ndë pra u llojasët se e treta pjes e Elladhës isht, nka mot, e arbreshe, pse i jesënjën më shumë se pesqint mil t'arbreshë, klofshin të lën njërët e tjerët, mos përzihëshin e mos llorosëshin ndë një bes, ndë një mall, ndë një vllamje.

Mbledhur t'arbreshët, maqedhonoriotët e elinët nën njëi flamuri, bëfshin një përzit gjasht miliunësh njerëzësh e (pa arsitur andaj gluhën, zakonët e qevarrit katundare) ashtu

pellazge. Herodoti pastaj thotë se në kohën e tij pellazgët banonin afër Dodonës (në Arbërinë e poshtme), d.m.th. te djepi i fesë së gjithë helenëve; dhe shton se në Athinë përtej Akropolit, në pjesën e quajtur Palla Polis (qyteti i vjetër) banonin të sprasmit pellazgë, që kishin një të folur të pakuptueshëm nga helenët. Edhe tashti pas kaq kohësh në atë vend të Athinës, që sot si atëherë quhet Plaka, rron e lulëzon një gjindje e arbëreshe nga gjuha, gjaku e zakonet, për t'i treguar botës se shartesa e jonasve nuk ka pasur aq fuqi, sa të thajë vllastarin e vjetër dhe të fortë të trungut të parë.

Pastaj gjithë bota e di se Leka i Madh me maqedonasit dhe arbëreshët, të përzier me helenët, dërmtoi mbretërinë e persëve dhe zotëroi mbi gjithë Azinë.

Pastaj, mirë a keq, arbëreshët, maqedonasit dhe helenët deri në kohën e Pirros qëndruan bashkë e mbajtën në dre edhe romakët e, sikur të mos kishin pasur një mbret frikacak e budalla, Perseun, ndoshta sundimi i botës nuk do t'i kishte shpëtuar nga duart farës pellazge. Por le t'i lëmë pellazgët dhe kohën e mesme dhe të vijmë në ditët e prindërve tanë.

Ku u ndez flaka e parë e lirisë së helenëve?

Janina qe vatra, ku mblihdeshin gjithë burrat e urtë të Arbërisë, të Maqedonisë dhe të Elladës e atje, midis studimeve, bënin plane për të çliruar atdheun e tyre. Që andej u ngrit Aliu i Tepelenës, burrë i urtë e i madh, ndonëse i pafat, i cili tregoi i pari kalbësirën, që bren mbretërinë e turqve e u dëfteu helenëve si ta mundnin atë dhe si të çliroheshin.

Trimat e Sulit edhe sot përmenden gojë më gojë në të gjithë botën. Të dy Boçarët e Xhavella, Kanari e Miauli e një mijë të tjerë ishin arbëreshë, që derdhën gjak e dritë mbi të gjitha fushat e mbi të gjitha dallgët e Elladës.

Pastaj, po të mendohet se një e treta pjesë e Elladës është prej kohësh e arbëreshe, sepse atje banojnë më shumë se

kumbisur ndë sinorët tire, mënd vërrenjën mballa-mballa turkun e sa të huaj që t'i qasëshin.

T'u kujtofshin se ng'ishtë para largu ajo ditë, kurë i Sëmuremi i math raft e u bëft plëh; e lumët ata gjinde, që ndë atë ditë të ndodhëshin gatuame t'ulëshin ndë darkjet e sa të mirrëshin pjesën, që i përket!

Se (dua t'e përthom), mos arbreshët e elinët ndëlehëshin, njerët tjerët, mëkatëshit tire e mënofshin edhe ndar, si jan, tue nëmur e tue sulur ndër ta, arrëft ajo ditë lipi e vaji, pse rafshin ndër duar aqë rënda e të bushtëra, sa të sbiret për mon edhe embri t'Arbrit e t'Elladhës.

Nani ndo akcili më piet: Çëdo kan bashk këta ligjërat me kënkat e Balës? U përgjegjësja se si flamurat ndë luftën rrin për shënk i atëris, sa t'i mblidhen rreth-rreth ushtorët të shprishur, ashtu kënkët ndë mon jan drita, tek çelen zëmërat e t'urtëvet, shëнку i gjindes, flamuri i nderjes, dhiata e prindëvet.

pesëqind mijë arbëreshë, do të ishin të marrë të dy palët, po të mos bashkoheshin e të mos përqafoheshin në një besë, në një dashuri e në një vëllazëri.

Duke u mbledhur nën një flamur, arbëreshët, maqedonasit dhe helenët do të formonin një bashkim prej gjashtë milionë njerëzish dhe (pa braktisur për këtë gjuhën, zakonet dhe qeveritë vendëse), duke u mbështetur ashtu në kufijtë e tyre, mund t'i shikojnë drejt në sy turkun dhe sa të huaj të tjerë, që do t'u afroheshin.

Ata le të kujtojnë se nuk është aspak larg ajo ditë, kur “i sëmuri i madh” do të bjerë e do të bëhet pleh, e lum ata popuj, që atë ditë do të ndodhen të përgatitur të ulen në darkë dhe të marrin pjesën, që u përket.

Dua ta përsëris se, në qoftë se arbëreshët dhe helenët nuk do t'ia falin njëri-tjetrit mëkatet e tyre dhe do të qëndrojnë ende të ndarë, ashtu siç janë, duke u nëmur e duke u përleshur midis tyre, do t'u vijë një ditë zie e vaji, sepse do të bien në duar aq të rënda e mizore, sa të humbasë për gjithmonë edhe emri i Arbërisë dhe i Elladës.

Tashti, në rast se ndokush më pyet: Ç'kanë të përbashkët këto ligjëratat me këngët e Balës? Unë do t'i përgjigjesha: Ashtu si qëndrojnë flamurët në luftë si simbol i Atdheut, me qëllim që rreth tyre të mblidhen ushtarët e shpërndarë, ashtu edhe këngët gjatë kohës janë drita, ku ndizen zemrat e trimave, simboli i popullit, flamuri i nderit, dhjata e gjyshërve.

P R A P A T H Ë N Ë M E

Njera më nani dihej sa u godit ndë Arbrit, kurë Skanderbegu mënoi ndë këtë jet; dihej edhe se, pas çë ai u shua, t'arbreshët bën krie turqëvet dhjet dimbëdhjet vjet. Por si pra klen mundur, si e kurë e nka ikën gjith gjindja, ç'erdhën të rëkutëshin Siçilje e te mbretëria e Napolit, së njihej fare, pse shkruazit tan e të huajt lan një të mbrazët ndër vitërat 1468, kurë vëdiq Skanderbegu, e 1480, kurë zun e u stisën të parët katunde t'arbresh e Italis. Më tepër mbëshoj zëmëravet e t'arbreshëvet se Njanji, i biri i t'urtit Skanderbegut, dukej një mosgjë njeri, çë kish sosur gjellën e tij ndë limonti, i gëlir hirëshit mbretit i Napolit, sa të paguaj të birit ndihëmën, çë kish nka prindi.

Por këta të mbrazëta, çë klahëshin ndër kujtimat tan, nani kan klen mbluar nka kujdesa e të shkluamit Jeronim i Rradhënjëvet, i të palodhëshmit mbledhësi i kujtimavet e Arbri. Ai te "Fjamuri i Arbrit", vitit 1884, nr. 9, na ka leçitur një të shkruame të moçëme e zotit Agostin Toçit, cili rroi një dyqint vjet prapa te katundi i Shën Kozmit i Kalavries, cila e shkruame ruhej ndë shpin e zotit Flaminit Toçit, i farës e shkruazit.

Agostin Toçi afër vitit 1650 shkruati se Njanj Kastorioti, pas çë vëdiq i ati, ngë iku me të jëmën, Donikën e Arianithit, si than pas shum mot shkruazit litinj, por qëndroi ndë Arbrit, ndë vend i prindit e, tue luftuar trimërisht dimbëdhjet vjet, mbajti largu turqit e dëftoi jetës se zëmëra e madhe e Skanderbegut tundej ndë gji të birit.

PASTHËNIE

Deri sot dihej ç'ngjau në Arbëri, sa ishte gjallë Skënderbeu; dihej gjithashtu se, si vdiq ai, arbëreshët u bënë ballë turqve dhjetë a dymbëdhjetë vjet. Por si qenë mundur, si e kur e nga ikën gjithë gjindja, që erdhën e u strukën në Sicili dhe në mbretërinë e Napolit, për këto s'dihej gjë fare, sepse shkruesit tanë e të huaj kanë lënë një zbrazëti të madhe për kohën midis vitit 1468, kur vdiq Skënderbeu, dhe vitit 1480, kur zunë e u themeluan të parat katunde arbëreshe të Italisë. Arbëreshëve u rëndonte më tepër në zemër se Gjoni, i biri i Skënderbeut, u dukej si njeri pa vlerë, që e kishte sosur jetën duke ndenjur kot, i mbuluar me huret e mbretit të Napolit, i cili i shpërbleu kështu ndihmën, që kishte pasur nga prindi i tij (Skënderbeu).

Por këto zbrazëtira, që viheshin re në traditat tona, tashti janë mbushur me kujdesin e të shquarit Jeronim i Radënjëve, mbledhësit të palodhur të kujtimeve të Arbërisë. Ai te "Fiamuri i Arbrit" në vitin 1884, nr. 9, ka botuar një shkrim të moçëm të Agostin Toçit, që ka jetuar nja dyqind vjet më parë në katundin Sh. Kozmo Kalabro. Kjo e shkruar ruhet në shtëpi të zotit Flaminio Toçit, që është prej fisit të shkruesit.

Agostin Toçi rreth vitit 1650 shkroi se Gjon Kastrioti, si i vdiq i ati, nuk iku bashkë me t'ëmën, Donikën e Arianitit, siç thanë pas shumë kohe shkruesit italianë, por qëndroi në Arbëri, në vendin e t'et e, duke luftuar trimërisht dymbëdhjet vjet, i mbajti larg turqit dhe i dëftoi botës se zemra e madhe e Skënderbeut rrihte edhe në gjirin e birit të tij.

Tek i dimbëdhjeti vit pas vdekjen e Skanderbegut (se si thot Fallmerayer u sos ndë vit 1468), vjen-me-thën ndë vitin 1480, një ushtrë e madhe turqësh me Vizirin Jusuf Pashallar in u derth mbë Arbrin. Arianithi edhe ai kish pasur ndë varr të dhëndrin. U kishin sosur ndë amahet të rëndë e të gëlet buletët më ponisëm e më t'urt; e kopilëris e Njanjit lipsej fuqia, që jep zulma e moçëme, më e nevojshme ndë horë të lodhëme e të that gjaku e haromësh.

U godit se, kurë arrejti hera e keqe e Arbrit, himariotët patën (ngë dihet përse) zëmërim e u ndajtin nka shkodrianët. Tek ai mot Arbri ndahej nën di embre. Embri i Shkodrës mblidhej Arbrin asipra, njera te lumi Bojana; tjetëra pjes, a përposha lumit, vej nën embrin e Himarës. Arbri i siprëm, a shkodrianët, po u mbajtin ndë bes, por himariotët u njomën, u ndajtin nka shokët, u mblodhën ndër malët tire e mbajtin kuvent ndër ta e shkruatin Jusufit tue thën se, mos ai qasej horëvet e katundëvet tire, do t'mbahëshin ndë një an, pa me luftuar. Viziri, i gëzuar se pa Arbrin gërisur, taksi himariotëvet më shum se sa lipën e, shtrënguar bashk pajtimin e besën, u pruar me gjith ushtrën, sa të shkelëj të pakët që qëndruan me Njanjin Kastoriotin.

Ahiera ajo bulëri e ajo trimëri, që, për sa Arbri mënoi ndë përzitën shejte, ngë nëmbroi kurr armiqët, e lën nka vëllezërit, u humbëtua e llojasi se lefteria e atëris ish e perënduar. Por, si gjinde e urt e zëmërmadhe, së deshën të dëlpekoin kriet të huajt e bën këshill të niseshin, sa të ruajin nderjen e besën. Dërguan përpara me një kope ushtorësh grat e mirenciet. Pra gjith ushtra, po tue luftuar, se Jusufi me turqit i pasën, arrejti te rrëza e deitit e u mblodh Antivar.

Toçi thot se ndër buletët më të parëshit, që u ndodhën me Njanjin Kastoriotin, ishin Kol Markshini, Elia Malëzi e

Në vitin e dymbëdhjetë pas vdekjes së Skënderbeut (i cili, siç thotë Fallmerajeri, dha shpirt më 1468) një ushtri e madhe turke nën vezirin Jusuf Pasha u derdh mbi Arbërinë. Edhe Arianiti e kishte ndjekur pas në varr të dhëndrin. Në luftërat e ashpra dhe të gjata ishin zhdukur bujarët më të fuqishëm dhe më të urtë dhe djalit të ri, Gjonit, i mungonte fuqia, që jep zulma e moçme, e cila është më shumë e nevojshme në një vend të lodhur e të mbetur pa gjak e pa para.

Kur arriti çasti i keq i Arbërisë, ndodhi që himariotët (nuk dihet përse) u zemëruan dhe u ndanë nga shkodranët. Në atë kohë Arbëria ndahej nën këta dy emra. Emri i Shkodrës mbliidhte Arbërinë e sipërme deri te lumi Buna; pjesa tjetër poshtë lumit njihej me emrin e Himarës. Arbëria e sipërme a shkodranët qëndruan gjithnjë në besë, por himariotët u ftohën e u ndanë nga shokët (ndoshta pas vdekjes së princit të tyre, Arianit Komnenit). Ata u mblodhën ndër malet e tyre, ku bënë kuvend dhe i shkruan Jusufit, duke i thënë se, po të mos u qasej viseve e katundeve të tyre, ata do të qëndronin mënjane e nuk do të luftonin më. Veziri, i gëzuar që e pa Arbërinë të përcarë, u premtoi himariotëve më shumë nga sa ata kërkuan e, si lidhi me ta marrëveshjen dhe besën, u kthye me të gjithë ushtrinë, për të shtypur ata të pakë, që qëndruan me Gjon Kastriotin.

Atëherë ata bujarë e trima, të cilët, derisa Arbëria qëndroi e tërë në bashkimin e shenjtë, nuk e përfillën kurrë numrin e armiqve, tashti, të braktisur nga vëllezërit, u trishtuan dhe menduan se liria e atdheut kishte perënduar. Por si njerëz trima dhe me zemër të madhe ata nuk deshën të përkulnin kryet para të huajit dhe vendosën të largoheshin, që të ruanin nderin dhe besën. Dërguan përpara me një grup ushtarësh gratë edhe fëmijët. Pastaj e tërë ushtria, gjithnjë duke luftuar, se Jusufi me turqit i ndiqnin pas, arriti në breg të detit dhe u mblodh në Tivar.

Toçi thotë se ndër bujarët më të parë, që ndodheshin me Gjon Kastriotin, ishin Kol Markshini, Elia Malëzi e Marku i

Marku i Madhjes. Ki ish i zoti i pesdhjeç horësh te Madhja; të di të parët ishin buler të lert e Shkodrës. Ndë mesët ushtorëvet u përzien shumë gra, edhe ata armatosur, e luftoin burrërisht përkrahu shokëvet e vëllezërvet.

Afër Antivarit ngrihet një mal i lart e i gëlat e te këmba malit ledhët e kullët e Antivarit. Nka ana e këtij mali bë livadh Jusufi me turqit e tij e ashtu mblitën nka ana e dheut gjithë udhët e ndihmës. Edhe prej deitit u llojas se pat t'ish arsitur t'ikurit t'arbreshëvet nka galet e turkut, pse anit venetike, që u nisën, sa të qellin ndë Italin, përveç të qasëshin Antivarit, tek ata i prisin, van e shtun angurën te proiti njëi katundi i shklerëvet, i kluar ndë tire Pastroviç, i vën nën zotërin e Venetis.

Si u xu shërbesi Antivar, Njanji Kastorioti mblodhi kuventën e bulerëvet e trimavet e, ndëlguar se gjella e shëndetja e tire ndodhej prap mbi majën e kordhavet e ndë gjithë t'urtëvet, van gjithë ndë një këshill, të hapëshin udhën ndë mesët turqëvet tue çajtur rrethin, sa pra të mblidhëshin Pastroviç, tek i prisin galet.

Si e than, e bën. Ish hera e miesnatës. Qielli i vrërët e i errët, pa hën e pa illëz; shiu derdhej reshit e era frëshkulloj ndër dushqit e malit, mbi ledhet e mbi kullët e Antivarit. Ahiera gjithë ushtra e arbreshëvet duall nka gjithë diert e qetëme e e mbledhur, tuke ecur prej livadhin turqëvet. Përpara me dufeqët e me kordhat ndë dor vein gjithë trimat më t'ahëm e më të rrënkët; ndë mesët ecin grat, pleqët e mirenciet e për së prapa mbllin kopen gjithë burrat të mir, ndër kopilërin e pleqërin. Ushtra e turqëvet qetej e qëlluar ndë gjum të thell. Të parët trima, sa arrejtin, pa pupitur e ndë sbeit pren cop-cop ruizit e natës e hapën udhën shokëvet, që i pasin. Ashtu të ndihur nka zëmëra e tire, nka errësira e natës, nka gjumi e nka drea e armiqëvet, t'arbreshët çajtin e përshkuan livadhin, pa pasur dëm. E kur zu e u feks

Madhjes. Ky i fundit ishte zot i pesëdhjetë katundeve në Madhje¹; dy të parët ishin bujarë të lartë të Shkodrës. Midis ushtarëve ishin përzier shumë gra; edhe ato të armatosura luftonin trimërisht përkrah shokëve e vëllezërve.

Afër Tivarit ngrihet një mal i lartë e i gjatë e në rrëzë të malit ngrihen ledhet e kullat e Tivarit. Nga ana e këtij mali u vendos Jusufi me turqit e tij e kështu i mbyllën nga ana e tokës të gjitha udhët e ndihmës. Unë mendoj se edhe nga deti do t'u ishte mbyllur rruga e ikjes arbëreshëve prej anijeve të turkut, sepse anijet veneciane, që u nisën për t'i sjellë ata në Itali, në vend që t'i afroreshin Tivarit, tek ata i prisnin, vanë e hodhën spirancën në skelën e një qyteti të sllavëve, që në gjuhën e tyre quhej Pastroviç dhe që ishte nën sundimin e Venetikut.

Si u mësua kjo gjë në Tivar, Gjon Kastrioti mbledhi kuvendin e bujarëve e të trimave dhe, si e kuptuan se jeta dhe shpëtimi i tyre qëndronin prapë në majat e kordhave dhe në gjoksin e trimave, të gjithë qenë të një mendjeje që të hapnin udhën përmes turqve, duke çarë rrethimin, për t'u mbledhur në Pastroviç, tek i prisnin anijet.

Si thanë, ashtu bënë. Ishte mesi i natës. Qielli ishte i vrenjtur dhe i errët, pa hënë e pa yje; shiu derdhej nga retë dhe era fërshëllente ndër dushqet e malit, mbi ledhet e kullat e Tivarit. Atëherë e tërë ushtria e arbëreshëve doli nga të gjitha portat, në heshtje dhe e mbledhur, duke ecur drejt kampit të turqve... Përpara, me dyfeqet e me kordhat në dorë, shkonin gjithë trimat më të guximshëm e më të fortë; në mes ecnin gratë, pleqtë e fëmijët e nga prapa e mbyllnin grumbullin gjithë burrat e mirë, që s'ishin as aq të rinj, as aq pleq. Ushtria e turqve qetej e zhytur në një gjumë të thellë. Të parët trima, sa arritën pa u ndier e në befasi, prenë copë-copë ruajtësit e natës dhe u hapën

¹ e në Myzeqe (në versionin italisht).

sbardhëllimi i parë i apolës, ndodhëshin tas largu e jasht dres. Por, tek më pak i pritin, erdhën helmet, pse një lum, që kullon te fushat ndër Antivarin e Pastroviçin, i çajti udhën. Ki lum rogomiset nka malët e Perashit i Malit-Ziut, po pështruar me borë, pse ish moti i paraverës, ish i ntrashur borës losur e shiut i natës. Vërrejin prapa e llojasën për së largu sbardhëllimin e cabievet e buhoin të ngritur kuelëshit e turqëvet, e u pan sbierr, pse përpara kishin lumin, për së prapa vëdekjen e nka të di anët një hor armiqësh e të huajësh. Tek ajo drueti e keqe llojasën se këshilli i mir ish të shtihëshin te lumi, sa t'e përshkoin, mirë a keq, si dej hera e nevojshme.

Si desh Inëzot, shkuan lumin më të shumë, se një pjesë u mbitën. e andaj tuke ecur vrap e pa pushuar, arrejtin Pastroviç e atje, përzier me tjerët shok t'ardhur më par, u hipën mbi karavët e, tue vozitur, arrejtin Siçilie.

Njanj Kastorioti, më par se të rëmbein dheun, mblodhi këshillin e bulerëvet e gjithë u kusuvalën sa të vein Palerm, tek ahiera ndodhej mbreti Ferrandi i Aragonës e atje pruarën pëlhurët. Ki mbret mosgjë-njeri, i harruar se Skanderbegu e t'arbreshët e tij i kishin, me ndihëmën tire, ruatur mbretërin të sbierr te Amahi i Bulerëvet, sa u xu kush ishin e pse erdhën tek ai, i përzu me grahëm të madhe, i trëmbur turkut, e urdhëroi gjindes e tij e gjithë katundëvet, sa të mos i mblidhin e, në mos nisëshin për hirë, t'i përziin pa hirë e t'i mbitjin ndë deit me karavët tire.

Ashtu këjo trimëri, këta buler, këta t'arbresh, cilët, tue luftuar dizet vjet mballa fuqin e turqëvet, klen ledhi i krështenjëvet, lavuta e besës e shëndetja e Europs, nani, të shpëtuar aqë amahësh e suvalavet, kurë pritin se të pushofshin, u pan prapa shtën ndë mesët deitit, pa ditur ku të prirëshin e ku të vein. Por ata ishin zëmëra hekuri e s'u njomën; e, si zakona e tire, pruarën sivonën motit keq e sgëlidhën tërkuzat e karavëvet

udhën shokëve, që vinin pas. Kështu, të ndihur nga zemra e tyre, nga errësira e natës, nga gjumi e nga frika e armiqve, arbëreshët e çanë dhe e përshkuan kampin pa pësuar dëm. E, kur zuri të fekste zbardhëllimi i parë i lindjes, ata ndodheshin larg e jashtë rrezikut. Por atje ku më pak i pritnin, u erdhën helmet, sepse një lumë, që rrjedh nëpër fushat midis Tivarit dhe Pastroviçit, u preu udhën. Ky lumë rrokulliset nga malet e Pirastit të Malit të Zi, që janë gjithnjë të mbuluar me borë dhe, duke qenë stina e paraverës, ishte fryrë nga bora e tretur dhe nga shiu i natës. Vështuruan prapa dhe vunë re për së largu zbardhëllimin e shpatave dhe pluhurin e ngritur nga kuajt e turqve, dhe e panë veten të humbur, sepse përpara kishin lumin, prapa vdekjen e nga të dy anët një vend armiqsh e të huajsh. Në atë drueti të keqe menduan se vendimi më i mirë ishte të hidheshin në lumë dhe ta kalonin, mirë a keq, si e kërkonte nevoja e çastit.¹

Ashtu si desh Zoti, më të shumtët e kaluan lumin, por një pjesë u mbytën. Dhe që andej, duke ikur me vrap e pa pushuar, arritën në Pastroviç dhe atje, të bashkuar me shokët e ardhur që më parë, u hipën anijeve dhe, duke vozitur, arritën në Sicili.

Gjon Kastrioti, para se të zbrisnin në tokë, mblodhi këshillin e bujarëve dhe të gjithë shprehën mendimin që të venin në Palermo, ku atëherë ndodhej mbreti Ferrand i Aragonës e për atje i drejtuan velat. Ky mbret burracak, duke harruar që Skënderbeu dhe arbëreshët e tij me ndihmën e tyre i kishin shpëtuar mbretërinë e humbur në luftën e Baronëve, sa mësoi kush ishin dhe përse erdhën tek ai, i përzuri me grahamë të madhe nga frika e turkut dhe u dha urdhër popullit të tij dhe gjithë katundeve që të mos i pranonin dhe që, në rast se këta nuk do të largoheshin me hir, t'i përzinin me pahir e t'i mbytnin edhe në det bashkë me anijet e tyre.

¹ Një gojëdhënë popullore në Pallac Adrian thotë se arbëreshët kanë kaluar detin hipur mbi shakuj. Unë mendoj se kjo gojëdhënë e shtrembëruar bën aluzion për kapërcimin e këtij lumi, duke ditur se ushtritë e përparshme e përdornin shpesh një mjet të tillë për të kaluar lumenjtë (shënim italisht).

nka rëza e bushtër e, shtie pëlhurët, u ndreqën prej Salernin. Sa të vein pra andej Napol edhe Rrom.

Ngan dhe; lun prapaz grat, mirenciet e të sëmuret e, të shtrënguar ndë kopet tire, u qasën horës. Zoti, që rrij mbë vend' i mbretit, ish më i paqërdheshëm se mbreti i tij e, tuke u niuar, i arsiti të hiin brënda horës.

Ahiera t'arbreshët të kanosur pruarën karavët te proiti i Napolit e, si arrejtin, napolitanët van t'i përpinqin, i mblodhën me hajdhi e me nder të madhë, e për vend, sa t'i jisin, i dhan kullën kluar Castel-Nuovo, ku për së pari u prëjtin pas helmëvet duruar ndë dhë e ndë deit.

Njanji Kastorioti prana, lën atje gjith gjinden nën qevarrin e Mark-Shinit, u nis me do buler, ndër të cilët u ndodhën Gjerq Mirëshpia, Zakaria Gropa, Pal Manëzi, Elia Malëzi e Njanji i Darenjëvet me të tjer ushtor, sa të vein Rrom për të lusur Papën ndër trivosit tire. Këtu e shkruamja e Agostin Toçit përpiket me shkruazit t'arbresh e Siçilies, me Ketën, me Kol Bidherin, me Gavril Darën, me Krispin e me Njanj Sqiroin, pse këta shkruaz na kishin ngritur kujtimën se Gjerq Mirëshpia me bulerët shok e tij më përpara arrejtin Rrom e pra erdhën e stisën Pallac Adrianin e tjerët katunde t'arbreshëvet e Siçilies.

Priremi rrëfiemës e Toçit. Ai thot se Kastorioti, pra që u prëjti një dit e vetëme te katundi i Fondit, muar prap dhromin i Romës e atje vate e u shtu për këmb Papës e, tuke klar, muar e i tha: “U që rri përpara ndeje, jam një njeri, që dimbëdhjet vjet kam luftuar me turqit, si ndë mon shkuam kishin luftuar gjithi im e prindi im, Skanderbegu, e vëllezërit e tij, që vdiqën farmakosur për besën e Krishtit. Nani që na u los gjaku, petku e fuqia e që, rasbisur armiqëshit e krështenjëvet, vinjëm të kërkonjëm një fole ndër krështenj, Ferrandi i Aragonës na

Në këtë mënyrë, këta trima, këta bujarë, këta arbëreshë, të cilët, duke luftuar dyzet vjet kundër fuqisë së turqve, qenë mbrojtja e të krishterëve, mburoja e besës dhe shpëtimi i Europës, tashti që shpëtuan nga aq luftëra e nga tallazet e detit dhe pritnin që të pushonin, e panë veten përsëri të shtënë në mes të detit, pa ditur ku të ktheheshin e ku të venin. Por ata ishin me zemër prej hekuri e s'e dhanë veten dhe sipas zakonit të tyre i kthyen fytyrën motit të keq e i zgjidhën tërkuzat e anijeve nga bregu i bushtër e, duke shtjelluar velat, u drejtuan për në Salerno, për të shkuar që andej në Napoli e Romë.

Si zbritën në tokë, lanë prapa gratë, fëmijët e të sëmurët dhe të rreshtuar nëpër grupe, me flamurët të shpalosur erës, iu afruan qytetit. Bujari, që rrinte në këmbë të mbretit, ishte më i dobët se mbreti i tij dhe, duke mos i pranuar, i ndaloi të hynin në qytet.

Atëherë arbëreshët, të kanosur, i kthyen anijet drejt skelës së Napolit e, kur arritën atje, napolitanët u dolën përpara t'i takonin dhe i pritën me gëzim e me nderime të mëdha dhe u dhanë për të qëndruar kullën e quajtur Kastel-Nuovo, ku për herë të parë u prehën pas helmeve të duruara për tokë e për det.

Pastaj Gjon Kastrioti, si la atje gjithë gjindjen nën urdhrin e Mark-Shinit, u nis me do bujarë, ndër të cilët ishin Gjergj Mirëshpia, Zakaria Gropa, Pal Manëzi, Elia Malëzi dhe Gjoni i Darenjve dhe të tjerë ushtarë, për të vajtur në Romë, që t'i luteshin Papës lidhur me fatkeqësitë e tyre. Këtu e shkruara e Agostin Toçit përputhet me ato të arbëreshëve të Sicilisë - Keta, Kol Bideri, Gavril Dara (Plaku), Krispi e Njanj Skiroi, se këta shkrues na kishin ruajtur gojëdhënën se Gjergj Mirëshpia me bujarët, shokët e tij, më përpara shkuan në Romë e pastaj erdhën e themeluan Pallac Adrianin e katundet e tjera të arbëreshëve të Sicilisë.

përzu, pa pasur lipisi helmëvet tan, që ngë kemi roposi, të trazuar ndër amahet e suvalat e deitit tejadhen.”

Papa i dha fjalëza të mira e e sivasi të prirej Napol e i taksi ndihëm. Shkruati pra Ferrandit, mbretit i frëngëvet e perëndorit e ashtu, e pra që hitën ndë mest këta mbretëri, t’arbreshët edhe pa hir patën thelimën (jo të përbashkuar) të shprishëshin ndër malët e Kalavries e Siçilies. Ashtu Gjerq Mirëshpia me shokët e tij erdh e stisi Pallac Adrianin; Pal Manëzi, Munxifsin; Despota Çernoviç, Shënt Enqëllin i Musharit; Elia Malëzi, Kazalotin; pse Kuntisa kle stisur më përpara nka ushtorët t’arbresh, që kishin ardhur me Skanderbegun, kurë erdh për ndihëm Ferrandit.

Njanj Kastorioti me më të shumë të t’arbresh qëndruan te mbretëria e Napolit e më tepër Kalavrie, ku stisën katundet, që mënonjën njera te dita e sonëme. Por i mbetën po me kordhën ndë grusht, njera që pra te fusha e Bizinjanit u pajtuan me mbretin.

Tashti të kthehemi në tregimin e Toçit. Ai thotë se Kastrioti, si pushoi një ditë të vetme në Fondi, mori prapë udhën e Romës e atje shkoi e u përul në këmbë të Papës, të cilit i tha duke qarë:

“Unë që rri përpara teje, jam një njeri, që dymbëdhjetë vjet kam luftuar kundër turqve, ashtu si në kohën e shkuar kishin luftuar gjyshi im dhe prindi im, Skënderbeu, e vëllezërit e tij, që vdiqën të helmuar për besën e Krishtit. Tashti që na u sos gjaku, pasuria e fuqia dhe që, të përzënë nga armiqtë e të krishterëve, vijmë të kërkojmë një fole ndër të krishterë, Ferrandi i Aragonës na përzuri pa pikë dhembshurie për helmet tona, kur ne nuk kemi më formë njeriu, duke qenë të rrahur nga luftërat dhe nga dallgët e detit Jon.”

Papa i tha fjalë të mira dhe e bindi të kthehej në Napoli, duke i premtuar ndihmë. Dhe i shkroi Ferrandit, mbretit të frënqve e perandorit dhe kështu, si ndërmjetësuan këta mbretër, arbëreshët mezi mundën të zinin vend të shpërndarë nëpër malet e Kalabrisë e të Sicilisë. Në këtë mënyrë, Gjergj Mirëshpia me shokët e tij erdhën e themeluan Pallac Adrianin; Pal Manëzi, Munxifsin (Mezzoiuso); Despoti Çernoviç, Shën Engjëllin e Musharit; Elia Malëzi, Kazalotin, kurse Kumtisa që themeluar më përpara nga ushtarët arbëreshë, që kishin ardhur me Skënderbeun, kur ky i vajti në ndihmë Ferrandit.

Gjon Kastrioti me më të shumtët e arbëreshëve qëndruan në mbretërinë e Napolit e më tepër në Kalabri, ku themeluan katundet, që gjenden edhe sot. Por atje qëndruan me kordhë në dorë, derisa më në fund u pajtuan me mbretin te fusha e Bizinjanos.

Pjesa e parë

PJESA E PARË

I

BALA

Mori bil, bil e Lalës ¹ , Mori e bukurëz e mbriturëz, pse më siell ndë mon shkuam?	
Njo, miegulla e errët rogomiset mal-mal!	5
Diellit ler malit Gropës, tundet, qesh shpati i humbët. Po si ti i bardh, i thiehtë shqepi i qiellit reshtet me një rreth të pasosur, i rimët si ninëza jote.	10
Ziarmit i paraverës ² çelen gjith rehjezit e kamënoi hifitir vete e loset me ret, gëlar kënkës mëruame, çë siell era për së largu.	15

¹ Lala është një horë ndër malët e Mores, e van t'i jisin çëdo t'arbëresh ikur, kur Balçi i treti, përzën turqëshit, u mbloth te Mali-i-Zi. Pas çëdo vjet zoti i Lalës ish një Komnen; një kësish Komnen pat t'ish Kauri, prindi i Vashës e Lalës, të cilës flet këjo kënkë.

² Te paravera, te dita e Rëshait, është zakoni e arbreshëve të stolisënjën lulesh e kurorësh diert e parathirat e nusëvet; e pra vallet ven mbi rehjet e çelnjën ziarmin i paraverës.

PJESA E PARË

I

BALA

Mori bijë, bijë e Lalës,¹
moj e bukur, e trishtuar,
pse më siell ndër mend të shkuarën?
Ja, megjulla e errët
rrokulliset mal më mal! 5
Sa lind dielli malit të Gropës,
tundet, qesh i thelli shpat.
Porsi ti e bardhë, e kthjellët,
cipëza e qiellit shtrihet
me një rreth-o të pasosur, 10
e rimtë si ninëza jote.
Prej zjarrit të paraverës²
seç ndriçojnë gjithë kodrinat
edhe tymi ngjyrë hiri
me retë vete e përzihet, 15
ngjarë këngës së trishtuar,
që siell era për së largu.

¹ Lala është një vend në malet e Moresë, ku vajtën të banonin disa arbëreshë të ikur, kur Balsha i Tretë, i përzënë nga turqit, u mbledh në Mal të Zi. Pas disa vjetësh zot i Lalës ishte një Komnen; një nga këta Komnenë duhet të ishte Kauri, i ati i vashës së Lalës, për të cilën flet kjo këngë.

² Në pranverë, ditën e Rrushajeve, arbëreshët e kanë zakon të stolisin me lule e kurora dyert e dritaret e nuseve; e pastaj valltarët venë mbi kodrinat dhe ndezin zjarrin e pranverës.

Tas, kopilëzat pa brez ¹ marr nka njëra dor me dor, të thërresënjën ndër Vallet; ² pa kujdes këmba e djelmëvet bredhën rënd ndër kangjelet, se kan zëmërën tek ti.	20
Se ti, lule e holl e malëvet, se ti, e para e vashëris, ec atje ku te harea derdhet ari i motit par e dhrosis zëmërën ëndrës ëmblës e menatës!	25
Leja plakut, leja Balës lisat errëta, shtrushin lumit, çë, pataksur malit egër, punon himën me përrenjë, si kufia ime e shkret më punon e përvëlön me të moçëmet kujtima.	30 35
Dizet her krahu i dimbrit	

¹ Vashat t'arbresha së ngjeshënjën brez, as siellënjën kez, por pleksënjën këshetat me fluturaka fitirçelur. Brezi, keza e shqepi përkesënjën të martuamet.

² Valla përgjegjet fjalës lëtirë Chorus, Choreia, Do thon se të jet Kangjeli Pirriqi i të moçëmëvet.

Ja edhe vashëzat pa brez, ¹ zënë të gjitha dorë më dorë, të thërresin ty ndër valle; ² pa kujdes këmba e djemve hidhet rëndë ndër kangjele, se zemrën e kanë tek ti.	20
O ti, lulja e hollë e maleve, o ti, e para e vashërisë, ec atje ku në hare derdhet ari i moshës së re edhe zemrën e gëzo në të ëmblën ëndërr të menatës!	25
Lërja plakut, lërja Balës të errtët lisa, zhurmën e lumit, që, rrëmbyer malit të egër, honin çan bashkë me përrenjtë, si mendimi im i shkretë, që më bren e më përvëlon me të moçmet kujtime.	30
Dyzet herë krahu i dimrit	35

¹ Vashat arbëreshe nuk ngjeshin brez, as mbajnë kezë, por i mpleksin gërshetat me kordhele ngyrash të forta. Brezi, keza dhe shqepi u përkasin të martuarave.

² Vallja i përgjigjet fjalës latine *Chorus*, *Chorea*. Thuhet se është vallja Pirrike e të moçëmve.

ra mbi Honin e mbi Brinjën ¹ e i pështroi e i sbardhëlloi e aqë her bleruan arat tek argomazit e Fushës, çë kur mblodhi dheu i huaj të ikurit, pafanëmit; e çë ahiera gëzim më ngë shkepti kësaj nat, çë mbi trut m'u kumbis.	40
Kam te sit e fluturonjën vjet, trima e punë të shkuame, si kur era ndërron ret, e përveshur e xarrisur i përze me frimë e gji.	50
Moti shkon i pallojasur mbi të shkretin dëlmer, por mbi ballët e ushtorit bien si plumb këta-vo-dit, se me duar të ftohëta brënda varrit e shtinjën. E këta dit limontis farmakosëme jan, Vash, si vëdekja Balës;	55 60

¹ Honi, Brinja, Llazi, Muzëkat, Gropa, Përroi i Shtogut, Pilia e të tjera jan gjith embre, çë t'arbrëshët, t'ikur, qellëtin te horët, ku erdhën të jisin, e gjënden këtu e këtje, pse i kujtonjën Arbrin e katundet, nka u nisën. Ashtu, si shkruati Virxhili, bëri Eleni me trojanët e tij, t'ikur ndër Haonët (çamët të sonëmet), Libër III Aeneid.: "Procedo et parvam Troiam, simulataque magnis - Pergama et arentem Xanthi cognomine rivum - agnosco, Scaeaque amplector limina portae."

Llazi vjen më rar një vend ç'ish më përpara shpat e pra i prer. Dh. Kamarda. Pilia, gërrik e ngusht ndër mal. Muzëkat, vend buruar kronjesh. Honi, humbje ndër malët.

ra mbi Honin e mbi Brinjën ¹	
e i mbuloi e i zbardhëlloi	
e aq herë bleruan arat	40
e ugareve të fushës,	
qëkur mbloodhi dheu i huaj	
të ikurit, të pafatët;	
dhe gëzimi që atëherë	
më nuk shkrepri kësaj nate,	45
që në tru m'u ngulit.	
Para sysh më fluturojnë	
vite, trima e punë të shkuara,	
si kur era ndërron retë,	
i shpërndan e i zvarris	50
e i përzë me frymë e gji.	
Moti shkon pa u kuptuar	
për delmerthin e shkretë,	
por mbi ballin e ushtarit	
bien si plumba këto ditë,	55
sepse me duar të ftohta	
brenda mu në varr e shtijnë.	
Këto ditë qetësie	
të helmuara si vdekja	
janë për Balën, mori vashë;	60

¹ Honi, Brinja, Llazi, Muzëkat, Gropa, Përroi i Shtogut, Pilja etj. janë të tërë emra, që arbëreshët e mërguar i sollën në viset, ku erdhën të banonin, e gjenden këtu e këtje, sepse u kujtojnë Arbërinë e katundet, nga u mërguan. Siç shkruan Virgjili, ashtu bëri edhe Heleni me trojanët e tij të shpërngulur ndër haonët (çamët e sotëm) - Libri III i Aeneida-s.: “Duke ecur (gjithnjë) shikoj se më del përpara Troja e vogël dhe Pergami... e më del përpara përroi i thatë i quajtur Ksanth e me mall përqafoj pragun e portës Ske.”

Llazi do të thotë një vend, që më përpara ka qenë shpat e pastaj është prerë (Kamarda). Pilja, grykë ndër male; Muzëkat, vend i mbushur me kroje; Honi, greminë ndër male.

- pse ki krah, nani i njom,
shumë herë stëlloi stilin
ndër ushtorët e bëmat tan
shumë herë me vëldim
van ndër gëluh të bukuravet. 65
Nani ç'ecën timer shkretira
e qëndrova gjall e zi,
fora e rivet më lë
i harruar ndër angon.
- Po ti vet (si rrëmb qielli 70
leth e leth dimbrit bushtër
çon të mjerin dëlmer,
sbierr të humbja e Llazit
e e gëzon me oht e drit),
lipsiare keqes sime 75
me mua vjen ndër errësir.
- E njato, përpara sivet
kam bulerët, të rrënkëtimit,
të vrërët e të helmuar,
si m'u dukën për së largu 80
çukat malëvet harepsur,
kur nka deiti iu fala

pse ky krah, tashti i qullët, ushtën shumë herë e vërviti ndër ushtarë e bëmat tona shumë herë të bukurat vasha na i lëvduan e i kënduan.	65
Tash që eci në shkretirë edhe mbeta gjallë e zi, vrulli i rinisë më lë të harruar në një cep.	
Por veç ti (si reze qielli lehtë e lehtë dimrit të egër shkon e gjen të mjerin delmer zbjerrë te humnera e Llazit dhe e gëzon me afsh e dritë), dhembje ndjen për të keqen time, vjen me mua në errësirë.	70 75
Dhe ja, para sysh më dalin gjithë bujarët e fuqishëm, të helmuar e të vrenjtur, si m'u dukën për së largu çukat e maleve të dashur, kur nga deti iu përfala	80

për së sprasëmi e më ng'i pash. ¹	
Se ju, bil motit math,	
hapët nj'udhë llamparisëme	85
ndër thellat e vitëravet!	
Zulma juaj kle diell	
mbi jetën përmisëmen;	
e ajo eshtrat ju shkëlqen,	
posi dielli edhe perënduar,	90
se me zjarm e me shkëndile	
mblon suvalat trazuame.	
Por ushtorët së duan helme,	
së duan klar... Ndo ti e dafshe,	
embri jit këtu më çelën	95
një përrallëz plo lot.	

¹ Këta fjal na kujtonjën zakonën e t'arbreshëvet e Pallac Adrianit, se nka vit, ndë ver, hipin mbi Malin e Trëndafilevet e andaj, prierr Apolës, i falëshin Arbrit e Koronit i Mores, nka u nisën të ditët t'ikur, tue kënduar kënkën, që zij fill:

O e bukura Morè,
si të lura e më ngë të pe!
Atje kam zotin tat,
atje kam zonjën mëmë,
atje kam tim vëllezër,
atje kam motrat time!
O e b ukura Morè,
si të lura e më ngë të pe!

së fundit herë e më s'i pashë. ¹	
Ju, o bij të motit të madh,	
hapët një udhë të ndritur	85
në të vjetve thellësi.	
Zulma juaj ndriçoi si diell	
përmbi botën e përmbysur;	
ajo eshtrat jua shkëlqen,	
porsi dielli, edhe i perënduar,	90
mbulon valët e trazuara	
me zjarr edhe me shkëndija.	
Por ushtarët s'duan helme,	
s'duan qarë... Ose, po deshe,	
emri yt po më kujton	95
një rrëfenjës plot me lot.	

¹Këto fjalë na kujtojnë zakonin e arbëreshëve të Pallac Adrianit, që për çdo vit në verë ngjiten mbi malin e Trëndafilave dhe që andej, të kthyer nga lindja, i falen Arbërisë dhe Koronës së Moresë, prej nga u nisën të mërguarit e dytë, duke kënduar këngën, që fillonte kështu:

O e bukura Morë,
 Si të lashë e më s'të pashë!
 Atje kam unë zotin tatë,
 atje kam dhe zonjën mëmë,
 atje kam dhe tim vëllezër,
 atje kam dhe time motra.
 O e bukura Morë,
 si të lashë e më s'të pashë!

II

PËRRALLËZA

Derdhi nata gjith mjegullat
mbi të zezat fusha të luftës;
u smol era e shprishi urët
mbi gjumin e trimavet.
Kurmëret të bëshëme
ndeheshin ndë truall,
ëndrat vein ndë ushtëri.
Herë e herë këmb-rënda
shpoin hjen kopet e natës,
si të llavurit lerëm
shtrehen Gropës e Dres,
kurë u lips era e drita.
Këtje ku reshtën lisi i Mbretit
degët gëlet mbi çukën

PËRRALLËZA

10

i rahjit i Balçit, ¹	15
lart u çel zjarmi i math	
darkës e Bulerëvet	
e u përziati rreth e rreth	
gazi e harea e qelqëvet.	
Flaka e bardh, shprishur erës,	20
rrahëj ballët ushtorëvet	
rrethur Zotit i luftës,	
tue dridhur mbi kumburët	
si shkeptim mbi suvalat.	
Skanderbegu trashëgoj	25
me ata trimaz vëllezër,	
se ndë zëmërën i flis	
mundja e rritur atirëve	

¹ Rahji i Balçit - Ki rahj, tek pra Skanderbegu stisi një kullë, kluar nka Marin Barletii "Balesius", muar embrin i Balçit plakut- Balça i pari lulëzoi ndë vitërat afër 1360 e me të tri bilët, Strazimiri, Gjergji e Balça i riu, mblodhi gjith Arbrin nën zotërin e tij, si pra bëri pas njëqint vjet Skanderbegu. Balçi i pari e pra Gjergji, i biri, pas që përzun shklerët nka Zenda e sipërme, zotruan nka Mali-Ziu njera përtej Artës, e andaj u sgeruan edhe mbi Maqedhonin. Vëdekur Gjergji, i erdh mprapa Balçi i diti e ki ndë vit 1383 kle peleqisur bashk me ushtrën e tij te fushat e Beratit nka Amuradi diti, se i ra nkrah ndë sbeit me dizet mil turq (Marinus Barletius: De strage Scodrensi; Hahn, I, 225; Kamarda). Pra që vëdiq ndër vitin 1422, pa bil, edhe Balçi i treti, zotëria e Balçenjëvet ra ndë duart e Venetis e të shklerëvet. Por një kushëri i tij, Stefanoi i Balçenjëvet, për mbiembër kluar Çernojeviç, prierr Arbrit nka Pulja, ku më përpara kish ikur, erth e zotroi prap ndër Gjergjët e mbi Malin-Ziun; e fara e tij i mënoi njera ndër vitin 1522, kurë Stefanoi i katërti kle përzën nka Iskënderi, nip i tij i pabesëm, që e xheshi edhe zotëris e Malit-Ziut. Tek ai mot u lips edhe Arbrit tjetëra deg e Balçenjëvet, për mbiembër Despota, që kishin zotruar te Zenda e përposhëme; pse, rasbitur turqëshit, të sprasëmet dërrudhe kësaj farje e shkluame erdhën Siçilje, tek stisën katundin Shënt Enqeliti i Musharit, e i rronjën njera sot të nipërit e nipëravet (Keta, Kamarda, Luccari: Annali Ragusei etj.).

e kodrinës së Balshit-o, ¹	15
lart u ndez një zjarr i madh	
darkës së bujarëve	
dhe u përzie rreth e rreth	
gazi e hareja e gotave.	
Flaka e bardhë, shprishur erës,	20
rrihte ballët e ushtarëve,	
mbledhur rreth Zotit të luftës,	
duke u dridhur mbi kumburët,	
si shkrepitima mbi tallazet.	
Skënderbeu po gëzonte	25
me ata trima vëllezër,	
se në zemër seç i fliste	
fuqia e rritur syresh	

¹ Kodra e Balshit - Kjo kodër, ku më vonë Skënderbeu ndërtoi një kullë, që Marin Barleti e quan “Balesius”, e mori emrin nga plaku Balsha. Balsha i Parë sundoi rreth vitit 1360 e me tre të bijtë - Strazimirin, Gjergjin dhe Balshën e ri - e mbloodi të gjithë Arbërinë nën sundimin e tij, ashtu siç bëri pas njëqind vjetsh Skënderbeu. Balsha i Parë e pastaj i biri, Gjergji, si përzunë sllavët nga Zenda e sipërme, zotëruan që nga Mali i Zi deri përtej Artës dhe që andej u shtrinë edhe mbi Maqedoninë. Pas vdekjes së Gjergjit erdhi në fuqi Balsha i Dytë, i cili në vitin 1383 u shpartallua bashkë me ushtrinë e tij në fushat e Beratit nga Muradi i Dytë, që i ra në krah befas me dyzet mijë turq (Marinus Barletius, De strage Scodrensi; Hahn, I, 225, Kamarda). Si vdiq në vitin 1422 edhe Balsha i Tretë, pa lënë fëmijë, zotërimet e Balshajve ranë në duart e Venetikut e të sllavëve. Por një kushëri i tij, Stefani i Balshajve, i mbiquajtur Cernojeviç, duke u kthyer në Arbëri nga Pulja, ku kish ikur më përpara, erdhi e sundoi prapë ndër gegët dhe mbi Malin e Zi. Fara e tij qëndroi deri në vitin 1522, kur Stefani i Katërt u përzua nga Skënderi, nipi i tij i pabesë, i cili i rrëmbeu edhe sundimin e Malit të Zi. Në atë kohë në Arbëri u zhduk edhe dega tjetër e Balshajve e mbiquajtur Despotët, që kishin zotëruar në Zendën e poshtme, sepse, si u mundën nga turqit, të fundit, që mbetën prej kësaj fare të shquar, erdhën në Sicili, ku themeluan katuindin Shënt Engjeliti i Musharit e atje rrojnë edhe sot stërnipërit e tyre (Keta, Kamarda, Luccari, Annali Ragusei etj.).

mbi krahët ainit zeshk.	
Nd'an atij, prapa shkëmbit,	30
mbi lavutën kumbisej	
fuqia e moçëme e Darës. ¹	
Fara e tij, deg lisi,	
mbledhur gjegjëj porsunat	
e vitëravet që van.	35
Grunda e bardh, fritur erës,	
borë dukej xarrisur	
kreut xheshurit Gur-math.	
Këtje te hjea lisit helmit	
veçë gjithësh, ballfëshehur	40
u shtu i madhi i Golemëvet, ²	
me sit ngjitur ndë dhe.	
Llaftarisëj gjiri i leshët	
si kusia kur valon.	

¹ Gjoni i Darënjëvet - Ish i shoqi i Zonjës Shëjevë, së motrës e Voisavës, s'ëmës e Skanderbegut. Hora, tek zotëroj Dara, ish vën ndër sinorët e Kastorës e të Krojës. Edhe njera sot mbetet tek Arbri i mesëm një fëshat, që kluhet Dara, cili kujton edhe atje embrin prindëvet tan.

² Mozezi i Golemëvet, i biri i Tuzës, zotroi mbi Dibrën të përposhëmen. Bular i math, i shkluam, kle krahui i drejt i Skanderbegut, pse ish i ndëlgum e i aksëm ndë luft e ku punoj trut e Mbretit, atje dora e Mozezit drovolisëj. Andaj Skanderbegu e vu për an thronit e tij, e mbloi ari e nderje. Por pas vramjes e Beratit Mozezi, marr nka zilia e sivasur nka Mohamidhi i diti, arsitë Arbrin e besën e, gënjier Mbretin e tij, iku me shumë shok Kostandinopol, nka u pruar me një ushtër turqësh e pru amah horës e gjakut tij. Skanderbegu vate e e përpoq e ndë luft të keqe e të përgjakur e mundi e e rasbisi. Mozezi, ashtu i dhunuam, u mbloth pameta Kostandinopol; por atje, si u pa shkarzier turqëshit, pat turp mëkatjes e tij e erth e u shtu prap për këmb Kastoriotit, cili e ndëlesi e e vu prap te nderja e parë.

mbi krahët e së zezës shkabë. Pranë tij, prapa shkëmbit, mbi mburojën seç mbështetej e moçmja fuqi e Darës. ¹ Fara e tij, degë lisi, mbledhur dëgjonte mësimet e vjetve, që kishin shkuar. Grunda e bardhë, shprishur erës dukej si borë e shpërndarë majë Gurmadhit të zhveshur.	30
Por te hija e lisit të helmit, veç së gjithëh, ballëfshehur, rrinte i madhi i Golemëve ² me sytë ngulur përdhe. Gjiri leshatak i hidhej si kusia, kur valon.	35
	40

¹ Gjoni i Darenjve - Ish i shoqi i zonjës Shëjevë, së motrës së Voisavës, s'ëmës së Skënderbeut. Vendi, ku zotëroi Dara, shtrihej midis kufijve të Kastorës e të Krujës. Edhe sot gjendet në Arbërinë e mesme një fshat, që quhet Dara dhe që kujton edhe atje emrin e gjyshërve tanë.

(Marin Barleti thotë se Voisava, e ëma e Skënderbeut dhe e motra e saj, e shoqja e Darës, ishin të bijat e princit të mirditasve "filiae principis Tryballorum" - shënim italisht).

² Mojsiu i Golemëve, i biri i Tuzës, zotëroi mbi Dibrën e poshtme. Ky bujar i madh e i shquar qe krahu i djathtë i Skënderbeut, sepse ishte i zgjuar e guximtar në luftë e atë që gjykonte mendja e Mbretit, dora e Mojsiut e zbatonte. Prandaj Skënderbeu e mbajti pranë fronit dhe e mbuloi me ar e me nder. Por pas kërdisë së Beratit, Mojsiu, i pushtuar nga zilia dhe i gënjyer nga Muhameti i Dytë, tradhtoi Arbërinë dhe besën e, duke gënjyer mbretin e vet, iku me shumë shokë në Konstandinopojë, prej nga u kthye me një ushtri turke dhe luftoi kundër vendit dhe gjakut të vet. Skënderbeu vajti dhe i doli përpara e në një betejë të ashpër e të përgjakshme e mundi dhe e shpartalloi. Mojsiu, kështu i turpëruar, u kthye prapë në Konstantinopojë. Por atje, duke e parë veten të poshtëruar nga turqit, u turpërua për fajin e vet dhe erdhi e iu shtri ndër këmbë Kastriotit, i cili e ndjeu dhe i dha prapë nderin e parë.

E rrënis e cinorëvet hidhej farmëku i zëmërës, se ndë zëmërë kujtима ditës keqe e lënësis iu humbua si gur ndë deit.	45
Si ndë gjum kujtoj ëmbëlësin e vëldimavet, mek i falëshin katundet, kurë arrej “Drangori i Dibrës”, tuke e kluar i pari i luftës, nderja e ushtrës, malli i vashavet	50
edhe trimi i kënkavet... E nani të mavorier e pështron nata e shkret!	55
Mbreti i urt më llojasi vrerin t’egër i bularit, e gjukoi lipsiar si puhia e miesditës:	60
“Se ti, zot i Përroi-Shtogut, se ti, ushtor i moçëm i Llazit, ¹ i pari i Darënjëvet, krahu jit dukej zjarm, kur shpatin përsëllon; mballa ndeje armiqëzit klen miegull çë shkon.	65
Te ata dit shum ushtëri, shum lufta e trima u pan, se ki mot nëng’ i sheh... Ailimëno! Fora iu shua,	70

¹ Llazi - vjen me rar një vend mali, tek ish një shpat për s’afëri i prer - Dh. Kkamarda. Përroi i Shtogut, Milota e Honi, gjith vende ç’i zotroj shpia e Darënjëvet.

Nga të errëtat qepalla i pikonte helmi i zemrës, sepse në zemër kujtimi i ditës së marrëzisë mu si gur në det i ra.	45
Si në ëndërr po kujtonte lëvdatat tërë ëmbëlsi, që katundet i drejtonin, kur “Dragoi i Dibrës” mbrrinte, duke e quajtur “i pari i luftës, nderi i ushtrisë, malli i vashave edhe trimi i këngëve...”	50
E tashti të turpëruar e mbulon nata e shkretë!	55
Mbreti i urtë e kuptoi vrerin e hidhur të bujarit e me dhembshuri i foli, si puhia e mesditës:	60
“O ti, zot i Përroi-Shtogut, ushtar i vjetër i Llazit, ² i Darenjve i pari, krahu yt dukej si zjarr, që shpatin e përcëllon; ballë teje gjithë armiqtë qenë si mjegull, që kalon.	65
Në ato mote shumë ushtri, shumë luftëra e trima u panë, që kjo kohë nuk i sheh... Por ah! Vrulli i tyre u shua,	70

² Llazi do të thotë një vend mal, ku ish një shpat i prerë së afërmi (Kamarda). Përroi i Shtogut, Milota e Honi janë të gjitha vise, që i zotëronte shtëpia e Darenjve.

mundi qeni e i ran për dhe flamur, kordha e trimëri.	75
Nat e helm të pështroft, dit vëdekje, dit dhunie! Gjith të shtuniet ardhëshin, ¹ e shtunia e Shalës ngë arthët kurr!	
Të përzëft edhe moti, ditë e zesë, e pisëruame!	80
Por çë kle?...Një zë kumboi mbi këta mal e u duku gjëm, kurë, reshit shpëtuar, rëzon er e dredhuri.	85
E të urtit m'u ngren, lajtin dhunën me gjak, zulma e mirë prap u çel. ² Thuaj, i dishëm, kopilëvet se ftesa e të mirëvet	90
spavet bëmashit të nderëme, posi gur i paçëmuar. Të lert ishin e të lert jan, prierr nd'udhën dritës tire, e andaj ngjiten mbi prindët,	95
po sa bora e Sharit tën mbi rehjëzit të përposhëme.”	

¹ Gjith të shtuniet ardhëshin - e shtunia e Shalës ngë arthët kurr - jan di vjershe, çë njera sot ven edhe tek na gol nka gol. Ata kujtonjën se kle një dit e shtunie, kur Njanji Kastotioti, prindi i Skanderbegut, afër horës e Shalës kle mundur turqëshit e, sa të lëroj vehten, i dha penk Amuradit të katrët bilët e tij, Repozin, Stanizin, Kostandinin e Gjergjin të vogëlthin, cili pra kle i madhi Kastoriot.

² Skanderbegu këtu kujton ata të parat dit, kurë, pas çë shpëtoi turqëvet, mek mënoi dhën për penk, u pruar e erdhi e rrëzoi Arbrin.

fitoi qeni e përdhe ranë flamur, kordha e trimëri.	75
Nata e helmi të mbuloftë, ditë vdekjeje, ditë dhune!	
Gjithë të shtunat ardhshin, e shtuna e Shalës mos ardhhtë kurrë! ¹	
Edhe moti të përzëntë, ditë e zezë, e pisëruar!	80
Por çka qe?... Një zë kumboi mbi këto male si gjënim,	
që, duke shpëtuar resh, erë ngre e dredhuri.	85
E të urtët na u ngritën, turpin me gjak na e lanë, zulma e mirë prapë u ngrit. ²	
Thuaju të rinjve, o i ditshtëm, se faji i të mirëve	90
lahet me bëma të ndershme, porsi guri i paçmuar.	
Të lartë ishin edhe janë, kthyer në udhën e dritës së tyre dhe prandaj mbi gjyshërit ngrihen	95
posi bora e Sharrit tonë mbi të ulëtat kodrina.”	

¹ Gjithë të shtunat ardhshin, e shtuna e Shalës mos ardhhtë kurrë! - janë dy vargje, që ndihen edhe sot gojë më gojë ndër ne. Ato të kujtojnë se qe një ditë e shtunë, kur Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, i dha peng Muratit të katër bijtë e vet: Repozin, Stanizin, Kostandinin dhe Gjergjin e vogël, i cili pastaj u bë i madhi Skënderbe.

² Skënderbeu këtu kujton ato ditët e para, kur, pasi iku nga turqit, tek të cilët qëndroi si peng, u kthye dhe erdhi për të ngritur në këmbë Arbërinë

Mbreti u qet; ai rëmaksëm
humbi nd'errët; lën shpnesës,
ndë vëdekjen i ra këshilli. 100
.....
(Këtu lipset një pjes.).

Mbreti heshti; ai, turbulluar,
në t'errët humbi; lënë shprese
mendja te vdekja i shkoi.

100

.....
(Këtu mungon një pjesë).

III

KËNKA E HËNËZËS

Me notin e puhizës	
erth një zëth asaj nat,	
i helmuar, pa ndëlguar,	
si shërtimi i vashës e re-vo,	
kurë i frin malli i par	5
gjirin njom e ajo s’e di.	
Se ti klofsh bekuar,	
zot i kënkavet e hjeshtëm,	
vllastar i lart i Petës! ¹	
Zërin tënt s’e ka njeri...	10
Sa do Niku, hidhen lot,	
sa t’e daft, çelet fora.	
Pa pupitur, magjepsur	
vam tek kënkëza na pru.	
Ai ulej mbi gurin,	15
mbi gurin e përroit.	
E një rrëmb hënëtarë,	
e feksur ndë ret,	
i pështillëj grundën blerëme	
me kurorëzën e qiellit.	20
Dukej ëndrëza e mirë,	
kurë bredhën mbi lulet	
e rrjeth mbi suvalat	

¹ Peta - embër njëi farje e horje ndë malët e Dibrës të siprëmes, tek zotroj Nik Peta, i shkluar ndër gjith “Kënkat e Pleqëris” bashk me Pal Golemin. Njera sot mbetet embri i tij ndër katundet tan.

III

KËNGA E HËNËZËS

Me notinë e puhizës	
erdhi një zëth asaj nate,	
i helmuar, i pakuptuar,	
si psherëtimja e vashës së re,	
kur i fryn malli i parë	5
gjinë e njomë e ajo s'ë di.	
I bekuar qofsh ti,	
zot i këngëve të bukura,	
i larti vllastar i Petës! ¹	
Zërin tënd s'ë ka njeri...	10
Kur do Niku, derdhen lot,	
kur të dojë, ndizet vrulli.	
Pa u ndier, të magjepsur,	
vamë ku na shpuri kënga.	
Ulur ish ai mbi një gur,	15
përmbi gurin e përroit.	
Dhe një rreze hënëtare,	
që përshkonte përmes resh,	
i pështillte të blerëmen grundë	
me kurorëzën e qiellit.	20
Dukej ëndërrza e mirë,	
kur lule më lule bredh	
e shket lehtë mbi tallazet	

¹ Peta - emër i një fisi e vendi ndër malet e Dibrës së sipërme, ku zotëronte Nik Peta, i shquar ndër gjithë "Këngët e Pleqërisë" bashkë me Pal Golemin. Emri i tij ka mbetur deri sot në katundet tona.

¹ Gjindja e re gjiijasajtëna ka pasur bes se dielli e hëna duhen. Elinët than se t'ishin motër e vëlla; gjetëk u ka thënë se jan i shoqi me të shoqen. Niku i Petës llojasej si të sprasëmit.

dhe me erën tok këndon;
pastaj shkon e fluturon
porsi një yllth i këputur.
Kënga e tij shkonte larg,
larg-o tek e bukura,
e trishtueshme, për të qarë:

“Ec, hënëz-o, vrapo
në të pafundmet kaltërsi!
Këtu s’është liqeri i argjerndtë
dhe as deti si pasqyrë,
ku ti shihesh e zbukurohesh,
kur i dashuri i ndezur¹
të qafon te shtrati i thellë.
Këtu sheh shkëmbenj e lisa,
koha shkon e ai të pret!
Udha jote është e gjatë;
ec, vrapo, o bijë e bardhë!
Pse qëndron? Ç’droje ke?
Mos vallë mjegullat e zeza
të ndërliksen nëpër këmbë
e ti trembesh mos, e shuar
frymës së krahëve të ftohtë,
qëndron nata si një e ve?
Zemra jote është, dro, si imja,
dritë e hijshme e pa hare,
që brymën e syve e derdh
e krrusur në ndonjë hije?
Edhe në ato shtëpi të ndritshme
arritka kjo zi e shkretë?

Por ti qesh... Hënëz-o, priru, gjegjëm, mbre, nka qerrja e jote!	
Kurë të raft siuthi i lum	55
mbi kronjëzit e marmurit e t'arrëft mera e lulëvet, mos më ik, zonja e natës, e m'i derth dritën but!	
Pafshë atje mballa ndeje	60
bilën forëmen e Kaurit, ¹ ciqen Lalës kësh-shprishur, gjirin bardh si suvala, e nka helmi losur sit.	
Arsen gazin edhe diellin;	65
po sa natën ndë shpat me ti klahet e gjukon. E si soset drita e jote atje largu, ndë deit,	
të përpjek me shërtimat	70
e në shtratëthin të mbëllin. Ditën strehet e fillëme për më kullëzit të shkret, pa jongar e pa flojer.	
Me menatën karcenjën	75
qenët e saj hundnëgritur, vesh-shtuara... Por qetet Gropa e Dhëlpërës; te gjea më ngë shihet e bukura tue pasur kacamitet.	80

¹ Çë nka mot i Skanderbegut do fjal turqisht zun e u përzien me gëlulhën tën e çë ahiera t'arbreshët zun e kluan elinët *kaur*. Lala, si tham, ish një burg ndër malët e Mores e Kauri i Lalës një Komnen.

Por ti qesh... Hënëzë, priru, më dëgjo nga qerrja jote! Kur i lumi sy të të bjerë përmbi krojet e mermertë dhe të të mbrrijë era e luleve, mo' u largo, o zonjë e natës, po m'ia derdh të butën dritë! Atje para do të shohësh bijën krenare të Kaurit ¹ , kumrinë e Lalës gërshetshprishur, gjirin bardhë si tallazi dhe me sy të vrarë helmit. I largohet gazit, diellit, natën vetëm lart në shpat qan me ty e bisedon. E si soset drita jote atje tej-o larg në det, të përcjell me psherëtimat e pastaj të mbyll në shtrat. Ditën vetëm filli sillet nëpër kullat mbetur shkretë, pa jongar edhe pa fyell. Që menatë zënë e kërcejnë gentë e saj hundëfryrë dhe veshngritur... Porse hesht Gropa e Dhëlpres, se në gjah s'shihet më e bukura duke ndjekur pas kaprojtë.	55 60 65 70 75 80
--	--

¹ Që nga koha e Skënderbeut zunë e u përzien në gjuhën tonë do fjalë turke e që atëherë arbërehët zunë e i quanin helenët *kaurë*. Lala, si thamë, ishte një kështjellë në malet e Moresë dhe Kauri i Lalës ishte një Komnen.

Pelatorët ven e bredhënjën
ndër vëronjat e perivolit,
lulet veshken pa kujdes.
Trut e saj streksen largu,
se mosnjeri gjuator 85
i sivasën si-vo-thin.
Jasht spellëshit e motit
reshti kriet dita e taksur,
pra ndë mbrazëtin u zhduk.
Erës e luftave pështie, 90
hera e pritur po mënon!
Ec, hënëz-o, vrapto,
t'e llorosh me rrëmbazit,
mos natëza të u sosët.”
Ai u qet e Dara i tha 95
një të thën të përdishëm:
“Era njomën kallëzit,
tue sivasur korrezit,
e ti, i birëthi i Lisanës,
gëzon natën me kënkë. 100
Të zien zëmëra e buron
si porr uji i thielluam.
Ti me kordh ndë ushtëri,
ti te kënkëkat je i shkluar!
Por përgjegju, djal i Petës, 105
malli jit ng'ë ndë plëh?
Hjet e vashës të huajë
së jan farmëk, çë vret?
U përmisën Kaurët,¹
ran me steret e prindëvet, 110

¹ Ka shumë kohë që arbëreshët dhe helenët kanë grindje midis tyre. Ka ardur koha që t'u jepet fund këtyre grindjeve midis vëllezërish.

e i qëlloi gjumi i glat në një nat, që ng'u sos. Gjaku i tire u trubullua si përrua largu kroit, si re e zez pa shkeptim.	115
Ajo kon u bi me lulet, u ka rritur hajdhivet, ç'i buronjën të qelburit...	
Fara e jote si të shkonj, si të shkonj e të shkëlqenj ndë. atë gjak i trazuam?	120
Shqepi i nderjes pështie grat tan e nderja i rron; së duan fushazit me lule, as puhjizën të holl,	125
por gëzohen ndë dimbrit, drea e shpatit i pëlqen edhe deiti se gjëmon; jan për ta darsëme luftat, andaj sdreqen me trimaz.	130
Dushk e Petës, këtu priru, e nka rrënja dheut tënd mblith bubuqe e trëndafille; se jo gjetëk ënda e mirë...	
Pse të zu zeksi i huaj? Tek-ai që vrëhjet jeta, harro kezën... Merr sit, njo, sbardhëllimi i cabievet!"	135
Iu përgjegj buzëz ëmblë Niku e i tha: "Her e her vajta nd'ushtrë e her e her shkela këmbët e t'ikurëvet; dita e djersur e nderjes	140

dhe i mbuloi një gjumë i gjatë në një natë pa mbarim. Gjaku i tyre u turbullua si përroi larg nga kroj, si re e zesë pa shkretimë.	115
Ajo vashë biu mes lulesh dhe me dhelka është rritur, që të qelburit i bëjnë. Fara jote si të shkojë, si të shkojë e të shkëlqejë	120
në atë gjak të trazuar? Cipa e nderit i pështjell gratë tona me nder rritur; s'duan fushëzat me lule, s'duan as flladin e hollë,	125
por veç dimrit i gëzohen, droja e shpatit u pëlqen edhe deti, që gjëmon; për ato janë dasëm luftërat, prandaj syresh lindin trima.	130
Dushku i Petës, këtu priru e nga rrënja e dheut tënd mblidh bubuqe e trëndafila; gjetkë s'gjen ëndë të mirë. Pse të zuri zekthi i huaj?	135
Ndërsa bota errësohet, harro kezën... Ja, të vret sytë zbardhëllimi i shpatave!” Iu gjegj Niku buzëqeshur	
e i tha: “Shpesh në luftë vajtur kam e shumë herë thembrat të ikurve u kam shkelur; dita gjithë djersë e nderit	140

po shkëlqeu mbi stilin tim; vet vëldimashit u ruata.	145
Te ki gji bie një zë, një zë i math; u vetëm e ndienj. Por ndë vramje gjith mon vaft zëmëra? E ndo e citur prëhet kordha, do jen ftes noerit të thielluame?	150
U, t'e thom, dua një vash, dua një vash të mirë, të nderëme, se isht flak e ngë më shuan; mbre, ndëlgo si më çel:	155

përherë më shkëlqeu mbi ushtë, por lëvdimeve u jam ruajtur;	145
te ky gji kumbon një zë, një zë i fortë, veç unë e ndiej. Veç në vrasje gjithmonë zemra do më shkojë? Edhe, kur ngirë prehet kordha, faj do quhen	150
të këthielltat mendime? Po ta them: Dua një vashë, dua një vashë të mirë, të ndershme, që është flakë e nuk më shuan; ja, dëgjo si më ka ndezur:	155

IV

VASHA E LALËS

Mblodhi krahët e pushoi	
Mbi të mundurit aini; ¹	
vierr te ledhi rriin kordhat,	
era tundëj lavutet.	
U djalishk edhe pa kluar	5
gjegjëja trimat e vëldimet,	
i mbërritur ndan vatrës.	
Një menatëz, ndër të tjera,	
vura udhën ndër këmb,	
për të çuar a zulm a varr.	10
Mbi të gjashtën pash diellin,	
se i falej nka deiti	
malëvet e Lalës,	
tue i nkuqur pirget.	
Udha kllitej për piellët,	15
për ndë brinja e rogomina.	
E u veja tue shkelur	
fletët veshkëta tëtimit.	
E rrëzuar kacamitja,	
ngrij kriet mbi thirrëzat;	20

¹ Një ain i zeshk ish qëndisur te flamuri i Skanderbeut e të farës e Kastoriotëvet. Aini arbrisht kluhet edhe **shqipter-i**, pse **shqip** `isht rrënja e embravet kësaj farje zogash, se kemi edhe **sqift**, **qift**, **sqipun** e tjera. Mbi këta kumbime u llojas se njera ndë mon e Skanderbeut hora e gjindja mbajtin embrin të moçëm e u kluan **Arbri**, **t'arbresh**. Embret **shqip**, **shqipja**, **shqiptar** u vun ndë zakon pas shumë vjet që ai kish vdekur. Andaj më duket se, si flamuri i Kastoriotit me **shqipterin** e tij mblodhi gjith Arbrin, ashtu Arbri zu e u klua **Shqipja** e t'arbreshët **shqiptar**.

IV

VASHA E LALËS

Mblodhi krahët e pushoi	
mbi të mundurit shqiponja; ¹	
varur ledhit rrinin kordhat	
dhe mburojat era i tundte.	
Unë djalëth ende i panjohur,	5
i mërzhitur ndanë vatrës,	
dëgjoja. trimat e lëvdatat.	
Një menatë, ndër të tjera,	
vura udhën për nën këmbë,	
për të gjetur zulmë a varr.	10
Ditën e gjashtë pashë diellin,	
që nga deti po u falej	
maleve të Lalës-o,	
duke u skuqur përgjet-o.	
Udha futej nëpër gryka,	15
nëpër brinja, nëpër gërxhe.	
Dhe po shkoja duke shkelur	
gjethet e fishkura së ftohti.	
Një kapruall i sapozgjuar	
ngrinte kryet mbi fierishte	20

¹ Një shqiponjë e zezë ishte qëndisur në flamurin e Skënderbeut e të Kastriotëve. **Aini** arbërisht quhet edhe **shqipter-i**, pse **shqip** është rrënja e emrave të kësaj fare zogjsh; se kemi edhe **sqift**, **qift**, **sqipun** etj. Duke u mbështetur mbi këto, unë mendoj se deri në kohën e Skënderbeut vendi dhe populli ynë mbajtën emrin e moçëm e u quajtën Arbëri, arbëreshë. Emrat **shqip**, **shqipja**, **shqiptar** u vunë në përdorim shumë vjet pasi ai kish vdekur. Prandaj, më duket se, pasi flamuri i Kastriotit me shqiponjën e tij mblodhi gjithë Arbërinë, Arbëria zuri të quhet **Shqipëri** dhe arbëreshët **shqiptarë**.

pra karcej shkëmbe-shkëmbe,
tek-ai për së prapa
më cënoi një trëngëllim,
trëngëllim i hekurit,
e iu prora, ndo e vërvitja, 25
ndo t'e pritja... Ati u duk
bishti i karkalit i Arbrit,
e të njoha, Pal Golemi,¹
Golemi i vogëlithi,
golfritur, gjithalkom. 30
Trimi vij edhe për nder,
e i përpjekur me mua,
vam bashk më gavnar.
Pra çë arrejtim mbi çukat,
u hap udha për ndë liset, 35
tek vuleqezit buroin
ata lulez të huaj.
Këtje pam ulur bubuqen,
bubuqezën e Lalës,
me të gjith vashat e saj. 40
Si na pa, u qas e u nkuq,
tue thën: "Pse armatosur,
armatosur te Lulja?
Sbardhëllimi këtire kordhave
po më mirë mballa armikut 45
se ndër vashazit shkëlqeft...
Këtu së gjeni hajdhi;
jemi vetëmëz pa burrat,

¹ Shpia e Golemëvet isht një deg e farës së fuqishme e Muzaqëvet, çë klen të parashit bular afruar thronit i Arbrit. Mënon nd'Arbrit embri kësaj farje e shkluame, se edhe sot një pjes e Arbrit kluhet Muzaqema.

dhe kërcente shkëmb më shkëmb.
Atëherë që nga prapa
më ngacmoi një tringëllimë,
tringëllimë hekuri.
Unë u ktheva t'i vërvitesha, 25
o ta pritja... Aty u duk
bishti i karkalit të Arbrit,
dhe të njoha, o Pal Golemi,¹
Golemi i vogëlthi,
gojëfytur, gjoks çeliku. 30
Edhe ky trim vinte për nder.
E me mua si u poq,
shkuam tok më me guxim.
Si arritëm përmbi çukat,
u hap udha nëpër lisat, 35
atje tek përrenjtë ujisnin
ato lulezë të huaja.
Atje ulur pamë bubuqen,
bubuqen e Lalës-o
me vashat e saj të gjitha. 40
Si na pa, u qas e u skuq
e na tha: Pse të armatosur
vini ju te Luleja?
Zbardhëllimi i atyre kordhave
do shkëlqente ballë armikut 45
më mirë se midis vajzash...
Këtu nuk gjeni hajdhi,
vetëm jemi ne, pse burrat

¹ Shtëpia e Golemëve ishte një degë e fisit të fuqishëm të Muzakëve, që ishin ndër të parët bujarë afër fronit të Arbërisë. Ka mbetur ende në Arbëri emri i këtij fisi të shquar, se edhe sot një pjesë e Arbërisë quhet Myzeqe.

se na van tek bushtëri qen ¹ na shkel eshtrat e prindëvet...	50
Por këjo tries s'ë shtruar për të huajt e mënorët? Eani, hini; mirë na vjen kush na vjen te këta shpi.”	
Iu përgjegja: “As ndër lulet, as ndër vashat, bukur zonjë, kordha e Arbrit sbardhëllon; gjetëk edhe do shkëlqenj...	55
As këtu jemi për të ngrën. Sa të lehet menata,	60
kallëzuar lavomashit, do na njohënjën Laljot, do na njohënj qenëria.”	
U err nata, sit e mi u qulluan mbi atë vash,	65
gjiri im u bë suval e trazuame ndë rrëz. Mbi të nesërmen na çoi drita e parë ndë ushtërin; e pabesëmit na reshtën	70
mballa diellit lavutet, njëqint bishte e pashallar. ² Iu vërvitëm si di tër; do i shkelëm, do ikën;	
lart u ngre zulma e jon; di të huajt ndër vallet,	75

¹ Gjith mon të krështenjët kan pasur zakonen të pastruame të kluanjën qen turqit; e turqit i përgjegjen tue shpierr atirve atë të bukur embër.

² Njëqint bishte - Dihet se bishtërat e kuelëvet jan flamurat e turqëvet e se nka kope ka ndë krietë një bisht kali.

vanë tek qeni mizor ¹ na shkel eshtrat e prindërve...	50
Po kjo tryezë s'është shtruar për të huajt e për miqtë? Ejani, hyni; mirë se vjen kush na vjen-o në shtëpi!"	
Iu përgjegja: "As ndër lulet, as ndër vashat, zonjë e bukur, nuk zbardhëllon kordha e Arbrit; edhe gjetkë do shkëlqejë...	55
Këtu s'jemi as për të ngrënë. Sapo dita të agojë,	60
nga vetë plagët në përleshje do të na njohin laljtöt, do na njohë qenëria."	
U err nata. Sytë e mi seç u ngulën mbi atë vashë,	65
gjiri im u ngrit si valë e trazuar bregut të detit. Të nesërmen drita e parë ne na gjeti në ushtri;	
të pabesët na i shtrinë përballë diellit mburojat, njëqind bishta e pashallarë. ²	70
Iu vërvitëm si dy dema, do i shkelëm, do na ikën, zulma jonë u ngrit lart;	75
ne dy të huajt nëpër vallet,	

¹ Të krishterët gjithmonë kanë pasur zakonet e pastër t'i quajnë turqit **qen** e turqit u përgjigjeshin duke ua kthyer atyre atë të bukur emër.

² Njëqind bishta - Dihet se bishtat e kuajve janë flamurët e turqve dhe se çdo grup ka në ballë një bisht kali.

	ndër kangjelet klem shkluar. E u ndieta shërtimat, e llojasa dishërimat mbi volite e brënda sivet.	80
Edhe u pruar mallit tim	vasha e Lalës e më qeshi, si illëthi i verës gëzon qiell e re me dritën bardh...	
	M'u hap zëmra e gjaku u ngroh.	85
Guna e natës pështroi	shpit, darket e Kaurit; ran burit me flojerët, gazet, qelqet u përzien.	
	Kish për krahu zoti i vrërët sit të rimëta së bilës; mbi volizit si shtalp feksej zëmërëza e but me një hje e një hare, se gjith kurmin më mbloi.	90 95
Ndo se qeshëj Kauri,	ish re plo-shkeptim, se vret gjinden pa gjëm. I shpëtoi këshilli i keq, posi thik shpëtuar millit;	100
	e krie-tries u ul Drea. Por u ngreva e mora e i thash: “Hapt miegullat embri jit, i tramaksëm mbi fushat, e mbi bretëqit e lucavet lart si qifti fluturoft!	105
	Tij të rriten dele e lop, zot i shpatëvet të zez...	
	Ndo mos ardhët një mot,	

	ndër kangjelet u lëvduam.	
	Unë i ndjeva psherëtimat	
	dhe dëshirat ia kuptova	
	përmbi faqet dhe ndër sytë.	80
Iu përgjigj dashurisë sime		
	vasha e Lalës, më buzëqeshi,	
	si gëzon ylli i verës	
	qiell e re me dritën e bardhë...	
	M'u hap zemra e m'u ngoh gjaku.	85
Guna e natës i mbuloi		
	shtëpitë e darkën e Kaurit;	
	ranë boritë edhe fyejt,	
	gazi e gotat u përzien.	
	Zoti i vrenjtur kishte pranë	90
	sytë e kaltërt të së bijës;	
	e mbi faqezat si shtalpë	
	fekste zemra e saj e butë	
	me një hije dhe hare,	
	që krejt kurmin ma pushtoi.	95
Por Kauri, ndonëse qeshte,		
	ishte si re plot shkrepimë,	
	që vret njerëzit pa gjëmë.	
	I shpëtoi mendimi i keq,	
	si një thikë shkëputur millit;	100
	në krye të tryezës u ul Droja.	
	Unë u ngrita dhe i thashë:	
	“Emri yt mjegullat haptë,	
	i tmerrshëm mbi fushat qoftë,	
	dhe mbi bretkocat e lucave	105
	lart si qifti fluturoftë!	
	Ty të rriten dele e lopë,	
	zot i shpateve të zes...	
	Oh, mos ardh të kurrë një kohë.	

e përpinj kullet e Lalës, vistar, pirge, embër e far, posi helqën përroi vrilet rrëzës e ratikat! Kurë t'u sbardhët ata ball,	110
as një birëth volimoll, ardhur të të përtërinj, të sivasët ndër glunj; raft këputur stili it pa një dor ç'e rrëmbëft.	115
As flamuri ndë luft, as varri të dëftoft! Pse një lis ngë t'u bi? Nën hjen e degës tënde vet bubuqëza u le,	120
të rinj trima për pem... Ajo ç'elet e fillëme si hëlnarëthi ndë spell; e thielon e përgëzon, si vëldimashit ushtorin ç'ë ndër flamurat vëdes...	125
Mbre! Mos dafshë të rëfikset e të loset si një illëth pa një vizëz ndë qiell! Ti prosekse vuleqet kordhës sime e gjaku i Petës ë si ari i kulluar..."	130
De pëlsis Pali i fritur e më thirri: "Çë ë, Peta, ajo kordhëz e vëldimat mballa meje, i mjeri djal? Frije gjetëk gjakun tënd, jo tek u, tek u, se i pari	135
	140

që të përpijë kullat e Lalës, thesar, pîrgje, farë e emër, ashtu si tërheq përroi xunkthe e barishte rrëzës. Kur të të zbardhet ai ballë, asnjë birth-o faqemollë, ardhur të të përtërijë, s'do të të ledhatojë mbi gjunj; e këputur do të bjerë ushta, pa një dorë që ta rrëmbejë.	110 115
As flamuri yt në luftë, as varri s'do të të njihet! Përse nuk të biu një lis? Në hijen e degës sate veç bubuqeza të lindi, të rrisë trima e jo pemë...	120 125
Ajo digjet e vetmuar si kandili në një shpellë; e kthjellon e përgëzon si lëvdatat ushtarin, që midis flamurëve vdes. Por të thahet mos e lër e të zhduket si një yll pa një vijëzë në qiell!...	130 135
Ti brazdat e kordhës sime m'i pe edhe gjaku i Petës është si ari i kulluar..."	
Pali i nxehur desh pëlciti e më thirri: "Ç'është, Peta, ajo kordhëz dhe lëvdimet para meje, i mjeri djalë? Gjetkë mburre gjakun tënd, jo tek unë, tek unë që i pari	140

atë thikëz të ngjodha!	
Prindët time van mdër mbret;;	
e ti, zotërthi di zallesh,	145
së kërruse ndë hivur?	
Të marrët Erga!... Konëza e Lalës	
me gjith lulet më përket;	
ndo e dafshë, këjo kordhë	
mall e krie do të qethënj!”	150
Nëng u sos çë u karceva,	
Holqa kordhën... Kauri	
na qortoi me grahëm e madhe	
e na mbajti: “Da, ndë truall	
fora e kordhat, të verbuamë!	155
Ndo mos raft ndër hare	
bumbullima, e gjaku i shprishur	
të më lanj e tries e dark...	
Madhe ë rolja e shpnesa e lart!	
E ju duani kaciqen,	160
dritën fillëmen e plakut,	
çë perëndi e mbretëri	
s’e proseksën pa dre?	
Se ju, t’urt e far e shkluame,	
do më jipëni sgëledhësin	165
kësaj nat plo-këshilli...	
Maide! U i sprasëmi i gjindes tan,	
sa t’e shohsha të përgjelbur	
ndër di kronjéz të ri	
e me lulez tuf-tuf!	170
Nani gjumi ju pushoft!	
Nesër prana ka dëftohet	
kuj përkeft nderja e Lalës.”	
Ndër të folët u shëndua,	
sit iu mbitën ndë gjak;	175

atë thikëzë ta ngjesha!	
Të parët e mi venin me mbretër;	
e ti, zot i dy zallishteve,	145
a nuk strukesh në një shpellë?	
Ta marrë djalli!... Konëza e Lalës	
me gjithë lulet më përket;	
po e deshe, ty kjo kordhë	
mall e krye do të t'i qethë!"	150
Pa mbaruar, unë kërceva,	
hoqa kordhën... Por Kauri	
na qortoi me të madhe grahamë	
e na mbajti: "Hajt, në truall	
vrull e kordha, të verbuar!	155
Ndryshe, mes gëzimit bie	
bubullima e gjaku i derdhur	
do më lajë tryezë e darkë...	
Të mëdha përpyekja e shpresa	
janë! Por ju më doni kedhin,	160
dritën e vetme të plakut,	
që mbretër e perandorë	
s'e vështuruan dot pa droje?	
O ju, trima e farë e shquar,	
më lini që të zgjedh njërin	165
kësaj nate këshillplotë.	
Unë i sprasmi i farës sonë	
atë e pafsha të përgjelbur	
mes dy krojezish të rinj	
e me lule tufa-tufa!	170
Tashti gjumi ju shpëlodhtë!	
Nesër, pra, do duket kujt	
do t'i përkasë nderi i Lalës."	
Ndërsa fliste, ai u shëmtua,	
sytë iu mbytën krejt në gjak;	175

harea u sos e drita u shua.
“Çë do kloft?... Ndër mjalt
pse ish farmëku përzier?
Pse idhënimi, pse kta vrer?
Por çë streks?... Së kam turp? 180
Ardhët Pisa, u dua pushonj!”
E u kullova si tek u,
me një ëndrëz të bardh,
si më e solli zulma e malli.
Ish, thomse, miesnat 185
e nka cinorat të rënda
sa një drit më cënoi,
si një illëth ndër re.
Kripshprishur ndë xerk
e pështie shqepit holl, 190
si ajo miegullëz mumbushe
e trazuame mbi borë,
llamparisëme e e hjeshëme,
si Mirëza e hënës,¹
çë ve rëmbazit kuror, 195
njo, e bukura m’u duk.
I ndërloksur, mbi gëlunj
u e vërreja e ajo bëri:
“Eja, ngreu, bir gjumi,
i arçer, i pandëlgim! 200
Po s’e sheh atë kufom,
çë resht llorët nka ret
e ndë mbrazëtis ulëron
e të lipën Kaurit?
Athun kordhën rrëmben, 205

¹ Mirëzat janë vashaz hinuame, cilat streksen natën me hënën e bredhënjën mbi rrëmbat e mbi ujërat e kallëzonjën fanmirën.

gazi u sos e drita u shua. “Ç’do të jetë?... Pse me mjaltët ishte farmaku përzier? Ç’qe ai hidhërim e vrer? Por ç’mendoj?... Nuk kam turp?	180
Ardhtë pisa, do pushoj!” Më zuri gjumi si në shtëpi me një ëndërrëz të bardhë, që ma solli zulma e malli. Ishte mbase mesi i natës,	185
kur ndër qerpikët e rëndë seç më qëllloi një dritë. Si një yllth për midis resh, flokët shpleksur përmbi zverk, me një shqep të hollë mbështjellë,	190
si ajo mjegulla e butë, që vërtitet përmbi borë, plot ndriçim e hijeshi, porsi Mirëza e hënës, ² që vë rrezet për kurorë,	195
ja, kështu m’u duk e bukura! I magjepsur, në gjunj ngritur, e vëreja; ajo më foli: “Eja, ngrihu, o bir gjumi, guximtar por i pamend!	200
A s’e sheh atë kufomë, që i shtrin krahët nga retë e ulërin në zbrazëti, e prej Kaurit të kërkon? Kordhën më kot e rrëmben,	205

² Mirëzat janë vasha hyjnore, të cilat bredhin natën me hënë e kërcejnë mbi rrezet e mbi ujërat dhe lajmërojnë fatin e mirë.

se këta ushtor hamodraq me do shkluhëza pa par ¹ jan luftarëz ndë fësheht, e të vrafshin pa nder, kurë zotit zëmëruar	210
ndë të kuq u nxihët zea... Shoku jit kle lëruar... ² Eja! Qetu!... Lipisis ftesa e jote m'u shërua."	
Shkoi e parëza; nka derë me një fjalëz iu hap, se ruizit e natës e proseksën e u këthien, posi ligat frikosëme, ³ gjegjur kënkën ç'i nëm.	215
Vam e illëzit m'u sbluan, m'erth era ndër krip, e si miqëve iu fala.	220
Volinkuqur si nuse, largo hëna perëndoj e ndë ninëzën e vashës me një rëmbëz shkëlqej; fjala i mbitej ndë gërrik, e përpitur ndë gji.	225

¹ Shkluhëza pa par - Thomse de t'ishin dufequet, pse ndë atë mon zun e u zakonisën ndër amahjet. Amuradh' i diti, kurë erth nën Krojën, i pru të parat llumbardha e pra pas do vjet edhe nën Krojën Gjergj Leshi vrau Ballabanin (Badherin) me dufekun.

² Vasha e Lalës llojasi se, mos ish shpëtuar edhe Pal Golemi, Niku së dej t'ikëj, tue lën shokun ndër armiqët.

³ Ligat a Vëllëzat jan do plaka pisëruame e të shënduame, që ecënjen natën mbi varret e kolloqisënjën mishët e vëdekurëvet, e kallëzonjën njerëzvet helme e vëdekje.

	se këta ushtarë makutë me do shkluhëza të padukshme ¹ të luftojnë në të fshehtë. Dhe pa nder do të të vrasin, kur zotit të zemëruar në të kuq t'i ndizet shpirti... Shoku yt liruar është... ² Eja, hesht!... Nga dhembshuria fajin tënd s'ta vura re.”	210
Shkoi përpara dhe çdo derë	me një fjalëzë i hapej, se të gjithë rojet e natës e vështuruan dhe u kthyen porsi shtrigat frikacake, ³ kur ndiejnë këngën, që i nëm. Dolëm, yjtë m'u zbuluan, flokët era m'i përshkoi, unë si miq i përshëndeta.	215
Faqekuqe si një nuse	hënëza larg po perëndonte e në ninëzën e vashës me një rreze seç shkëlqente; fjala i mbytej në grykë, e përpirë brenda në gjë.	220
		225

¹ Shkluhza të padukshme - Mbase do të ishin dyfeqet, se në atë kohë zunë të përdoreshin nëpër luftëra. Murati II, kur erdhi nën Krujë, solli të parat llumbardha e pastaj pas disa vjetësh, gjithnjë nën Krujën, Gjergj Leshi e vrau Ballabanin (Badherin) me pushkë.

² Vasha e Lalës mendonte se, po të mos ish shpëtuar edhe Pal Golemi, Niku nuk do të ishte, duke e lënë shokun midis armiqsh.

³ Shtrigat (ligat) a Vëllëzat janë do plaka shtriga e të shëmtuara, që bredhin natën mbi varret e kapërdijnë mishtë e të vdekurve dhe u paralajmërojnë njerëzve helme e vdekje.

Po sa shkuli një shërtim, një shërtim e një rëkim:	230
“Edhe ti, ruaza e natës, edhe ti te hera e shkret më le e fillëme nd’atihi?	
E perënduame drita e jote, erret qielli e nxihet jeta, si arren lipi pas hares.	235
Por ti u priershe mbi sheshet e ajo flak lipsiare sbardhëlloft edhe këta lot.	240
Udhëtarëzi i pashishëm, si erth, vete pa të prierr, pa llojasur tek shkon, se çë u shua, se çë u lavos, se çë gjak nd’ata plëh,	245
çë ka shkelur me këmb!... Ec, i huaj, pa dre, për sa nata të pështron, ec e rrofshë shum e i lum, i vëlduar ndë jet,	250
i shkëlqier ndë gjak... Ndo të ardhët një dit e helmuame ndë mon, se këtë herë mos harrofshë, edhe Marës kujtofshë!	255
Ndo i harepsur ndë shpi e me shoqezën ndë gji, tue par këtë hëlnar këtte te deiti, si shkrëmb, do të thuash ndë vetëhen:	260
- Ashtu hënëza perëndoi e te Lulja nata u mblli,	

Hoqi veç një psherëtimë	230
një psherëtimë e një rënkim:	
“Edhe ti, o rruaza e natës,	
në këtë orë të shkretë	
më lë vetëm në mjerim?	
Perënduar drita jote,	235
erret qielli, nxihet bota,	
si vjen zia pas haresë.	
Por ti kthehesh prapë ndër sheshet	
edhe drita jote e dhembshur	
këta lotë do t’i ndrisë prapë.	240
Udhëtari i pandjeshëm,	
si erdhi, ikën e më s’kthehet,	
pa menduar se ku shkon,	
se ç’u shua, ç’u plagos	
dhe ç’gjak kish në ata pleh,	245
që me këmbë e ka shkelur!	
Ec pa droje, o i huaj,	
për sa nata të mbulon,	
shko dhe rrofsh shumë e i lumtur,	
i lëvduar qofsh në botë,	250
i shkëlqyer qofsh në gjak...!	
Në të ardh të ndonjëherë	
ndonjë ditë e helmuar,	
këtë orë mos e harrofsh	
edhe Marën e kujtofsh!	255
A kur i gëzuar në shtëpi	
dhe me shoqezën në gji,	
duke parë këtë kandil	
poshtë te deti më të shuar,	
për të thënë me vete ke:	260
- Ashtu hëna perëndoi	
dhe te Lulja nata u sos,	

	kurë një vash më lëroi; ish e vietur, e përllipëme, m'u fal mbitur me lot; nani thomse m'u kalb si një pemëz me krimb! - Ashtu thuashë tue klar kriezezën, që u poq si një ur nën hi..."	265
Tha e u sdroth; u iu përgjegja:	"Ndo me zëmëren të thier, mirr vesh, e bardha vash! Se sa moti më duroft, ti orat po më klofshë; dielli jetën pastron e ti gjellën gëzon, se për lip u të dua, se të dua për hare. Ndo te hera e druetis, ndo u lëngoft dora e fora, te drosia e dritës tënde më buroft frima e gjella! Tij do rritet nderja ime, nderja ime e nderja e jote, mbi vëdekjen e mbi mon! Mbre! Kujto: mos e sdredhur zëmëra e jote fluturoft afër shtretëvet të bushtër ndër perëndesh e mbretëresh. Por e butëz m'u mbafshë besës sime të paftesëmes. Por të shkoft i treti vit, i magjepsur dritës sime, prindi i errët na bekoft.	270 275 280 285 290 295

kur një vashë më shpëtoi...	
Ishte e vetme, e trishtuar,	
e m'u fal mbytur në lot;	265
tashti mbase është kalbur	
si një pemëzë me krimba! -	
Kështu do thuash duke qarë	
kryezezën, që u dogj	
si një urë ndënë hi..."	270
Tha e u zdrodh; unë iu përgjigja:	
"Ndonëse me zemër të thyer,	
më dëgjo, e bardha vashë!	
Për sa mote të jem gjallë,	
ti gjithmonë do më jesh uratë;	275
dielli botën zbukuron	
e ti jetën më gëzon,	
se të dua për në zi,	
se të dua për hare.	
Dhe kur dora dhe fuqia	280
të më paken në kohë droje,	
nga gëzimi i dritës sate	
frymë e jetë do më burojë!	
Ti do e rritish nderin tim,	
nderin tim e nderin tënd,	285
përmbi vdekjen dhe mbi kohën!	
Por mba mend: Mos e ndryshuar	
zemra jote fluturon	
afër shtretërve të bushtër	
ndër perandoresha e mbretëresha.	290
Ti besnike t'i qëndrosh	
besës sime të panjollë.	
Pa shkuar i treti vit,	
i magjepsur dritës sime,	
prindi i errët do na bekojë.	295

Mos u priersha tretit vit, tretit të taksurith, vash, bota më pat ngrën!”	
Si më gjegji, u ngëlat e u ntrash, ndejeti dorën e nata e mblloth.	300
Keq i shqerr ndër di helme, zulma mundi e vrap u prora tek i ndritëmi Jankua, ¹ krahhekuri, i tramaksur.	
Embri i tij ish gjëm, gjëmi i malëvet mbi qenët.	305
Ai më njohu e i pëlqeu sbardhëllimi i kësaj kordh, kurë në Nish e Tullovaz e te fushat e Vazait	310
qethja krer si ordonkaf.	
Nani zërit atëris riodha, erdha e këtu luftonj.	
E, sa u pruarët shtiell erës flamuri i Arbrit mbi rehjet	315
e te veshët më arrëft hëngëllimi i kuelvet huaje, ti, krie luftash i moçëm, po këtu stisur do më gjesh;	
se, t’e thom, flaka e ime lart u çel e lart u ngre, të dhunuarshit pa njohur.	320
Pra kurë kënkëza e thielluame	

¹ Jankua - Njanj Mathtia Unniadhi, prenku i Transilvanisë ndër Ungarët te moti i Skanderbeut, kle bular i math, cili po luftoi me turqit e po i mundi. Andaj turqit për dren e kluatin Janko, se ndë të folët tire vjen me thën “drea i zërit i malëvet”. Luftat, tek mundi më tepër Unniadhi, klen luftuar prej Nishës, prej Tullovazit e prej Vazait.

Po s'u ktheva të tretin vit, të tretin, të taksurin, dheu, vashë, do më ketë ngrënë!"	
Si më dëgjoi, u gjallërua, nde u dorën e nata e mblodhi.	300
Keq i zhytur ndër dy helme, zulma më munda, shpejt u prora tek ish Jankua i ndritur, ¹ krahëhekur dhe i tmerrshëm.	305
Gjëmim ishte emri i tij, gjëmim malesh përmbi qentë. Ai më njohu dhe i pëlqeu zbardhëllimi i kësaj kordhe, kur në Nish e Tullovaz dhe te fushat e Vazait	310
qethja krerë si gjembaçë.	
Tash prej zërit të atdheut renda, erdha e këtu luftoj. Sa shpalosur erës mbi kodrat flamuri i Arbrit të valojë	315
dhe sa në vesh të më mbrrijë hingëllima e kuajve të huaj, ti, o prijës i moçëm luftërash, këtu të vendosur do më gjesh; se, ta them, kjo flaka ime	320
lart u ndez e lart u ngrit, e panjohur nga të paturpët. Por, kur këngëza e kthjellët	

¹ Jankua - Gjon Mathia Korvino, i mbiquajtur Huniadi, princ i Transilvanisë ndër hungarezët në kohë të Skënderbeut; qe bujar i madh, që luftoi gjithnjë kundër turqve e kurdoherë i munda. Prandaj turqit nga frika e quajtën Janko, që në gjuhën e tyre do të thotë "Tmerri i zërit të maleve". Luftërat, që fitoi më tepër Huniadi, u zhvillun afër Nishit, Tullovazit dhe Vazait (Wlassagh).

na gëzofit sheshe e mal, e i prërët ushtori u rrëzofit punëvet shkuame, u u priersha tek më pret...”	325
“Athun pret, për gjallët tim, (thirri Pali e shquar natën), ushtor vallesh e kangjelesh, i vëldor, rrahader! Këtu as fjalëza e ëmbëlë, as grundëza lëmuar, këtu vet kordha të vëleft, mos u vrafshë kësaj dor, luftarik durrudhiar!”	330 335
Helqur kordhat, karcier e të sulurit klen një; u bën hekurat shkëlbossa e çeliku u bë shkëndile; e, tas, vëdekja ndër vëllezër mbi të di majet rëkoj...	340
Njo, çë kle? Kush i papsi, dejtur vreri e çelur gjaku? Pse ata vetulla egërsuar ndë cik ulen për dhun?	345
Mbreti u duk, i vërrejti e pa fol, ku desh, i pru. Ata vein si qen rrahur, përzën shkopit dëlmerit, helqur bishtërat për dhe! Tjerët van këtu e këtëje. Nata u qet e shuati urët. (Lipset një pjes)	350

sheshe e male do gëzojë
dhe ushtari, duke u prehur, 325
punët e shkuara do kujtojë,
unë do kthehem tek më pret...”

“Më kot pret, për jetën time,
(thirri Pali e natën grisi)
ushtar vallesh e kangjelesh, 330
mburracak e rrahader!
Këtu s’vlen as fjalëza e ëmbël,
as dhe grunda e lëmuar,
vetëm kordha të vlen këtu,
të mos vritesh nga kjo dorë, 335
o ushtar ballukedredhur!”

Hoqën kordhat e kërcyen
dhe u përleshën menjëherë;
hekurat u bënë copë
dhe çeliku u bë shkëndija; 340
dhe, ja, vdekja ndër vëllezër
mbi dy maja po rënkonte...

Por çë ngjau? Kush i prapsi,
dehur vrerit, ndezur gjakut?
Pse ato vetulla të egërsuara
shpejt u ulën si për dhunë?
Mbreti u duk, i vërejt
e, pa folë, ku desh, i çoi.
Ata ecnin si qen të rrahur,
përzënë shkopit të delmerit,
bishtat hequr përdhe xvarrë!
Tjerët vanë këtu e këtje,
nata u qet dhe i shoi urët.

.....
(Këtu mungon një pjesë)

Pjesa e dytë

E DITA PJES

I

PLAKU

Holqi miegulla ndë vrap,
gërisur erës, stolin;
zëri i spellëvet rëkoj
largu shpatëshit e Borës.¹
Atë mbrëmje pa nj'ill, 5
si desh Mbreti, tue rëzuar
veja ruizit e natës,
fillëm, i qetur, hapagëlat.
Ata u ndien e rehje-rehje
zoga e zeshk frëshkulloi.² 10
Andaj, papsur, u prora
te Val-kalët të shkret,³
tek shkëmbe rogomisur
gatoin udhën armiçëvet,
ndo të qasëshin ndë sbeit. 15
Këtje mbi majën u kumbisa;
nën këmbëvet përroi

¹ Bora - mal i Arbrit, ashtu i kluar pse po i pështruar borje.

² Ish zakon e të moçëmvet t'arbresh ndër amahjet të bënëshin shënk ndër ta tue frëshkulluar me një frëshkullim të gëlar frëshkullimit do zogash natje, sa armiçët s'e ndëlgonëshin. Edhe ndër amahjet e elefteris e elinëvet suljat bëin ashtu, si rrëfieti Pouqueville.

³ Valkalët - Marin Barleti kluan këtë vend nani Valkalje, nani Valkales; por, si shom, Bala e kluan Valkalt a Valkalit. Këjo grop ish fër malit i Mokreut a Mokries, se Barleti e kluan mbë të di viershe; e atje u bë lufta, të cilës këndoi Bala ndë këtë kënk.

PJESA E DYTË

I

PLAKU

E grisur erës, me nxit
hoqi mjegulla stolinë;
zëri i shpellave rënkonte
larg shpateve të Borës.¹
Atë mbrëmje pa një yll, 5
si desh Mbreti, unë veja
vetëm, heshtur, hapagjatas,
duke zgjuar rojet e natës.
Ata ndjenë e kodër më kodër
zoga e zeshkët fishkëlleu.² 10
I qetë që andej u ktheva
në Valkalin e shkretë,³
ku shkëmbenj të rrokullisur
armiqve udhën u hapnin,
po të qaseshin befasisht. 15
Atje mbi majë u mbështeta;
ndënë këmbëtë përroi

¹ **Bora**, mal i Arbërisë i quajtur kështu, sepse gjithmonë i mbuluar me borë.

² Arbëreshët e moçëm e kishin zakon në luftëra që t'i jepnin shenjë njëri-tjetrit duke fishkëllyer si zogjtë e natës, që armiqtë të mos kuptonin. Edhe në luftërat e lirisë së grekëve suljotët bënin kështu, siç tregon Pouqueville-i

³ **Valkali** - Marin Barleti e quan këtë vend herë Valkalja e herë Valkales; por, siç e shohim, Bala e quan Valkalt a Valkalit (d.m.th luginë e kalit - në shënimin italisht). Kjo luginë ishte afër malit të Mokreut a Mokrës, se Barleti e quan në të dy mënyrat; e atje u bë lufta, që këndoi Bala në këtë këngë.

më pataksej ndë hjon, e mbi kriet ndërliksur kishja re me dredhuri.	20
Do her Vëllëza më shkundi ¹ krahët qelbur ndë ball e afër dritës e shkeptimës si një kërr m'u dëftua.	
Mbain darësëme atë nat e u, thomse, i skondapsa darkët bushtërat e haren.	25
E u kanosën e rreth-rreth me sit çelur si ur më vërrein e më shain.	30
U de mirrja llorët aj e i sula; për së prapa ata u vuallën e më verbuan me një miegull varrom, sa më shtiin ndë rogomin.	35
U i shpëtova e të nëmurat van e u sdrodhën si boshte.	
Prana qielli u thiellua, po sa ulët rëkoj era e vidhëvet e përroi.	40
Mendët e mia ndë errësir ishin sbierr, si rrëmb hënie, kur, avullit mumbitur, vete e shuhet ndë hje.	
U ngalesëssha ndë vetëhen, se më shkoin dit e mot pa i llojasur ndë jet,	45

¹ Vëllëzat a Ligat, thon se të jen do gra pisëruame, plaka e të shënduame, çë ven tue ecur natën mbi varret, kurë miegulla e errësira pështronjën jetën.

më përplasej mu në hon, e mbi kryet ndërlikur kisha re me shakullinë.	20
Disa herë më shkundi Vëllëza ¹ krahët e qelbur mbi ballë dhe në dritë të shkrepimës si një kërr m'u dëftua.	
Bënin dasëm atë natë e unë mbase ua prisha darkën e bushtër dhe harenë. M'u kanosën, rreth e rreth, me sy të ndezur si urë më vërenin e më shanin.	25 30
Doja të kafshoja llërët e u vërsula; që nga prapa ato vollën, më verbuan me një mjegull erëqelbur, të më hidhnin në greminë.	35
U shpëtova e të nëmurat vanë e u zhdrodhën porsi boshte.	
Pastaj qielli u kthjellua, porse ulët po rënkonte era e vidheve e përroi.	40
Mendte e mia në errësirë ishin zbjerë si rreze hëne, kur nga avulli e njomur vete e në hije shuhet.	
Unë veten e qortoja, që më shkonin ditë e mote pa u vënë re në botë	45

¹ Vëllëzat a Ligat thonë se do të jenë do gra të ferrit, plaka e të shëmtuara, që bredhin natën mbi varret, kur botën e mbulojnë mjegulla dhe errësira.,

pa i proseksur ndë luft. Kënka e vashavet harron djalin lën ndë limonti; vallëza priret e e qeshon...	50
Puna e natës i përket, sa të zihet me hjet, i panjohur, pa nder! Ashtu streksja ndë vetëhen, sa një krisë më rëzoi...	55
- Do jet era nd'ata dushk, a lerëmëthi që breth? Por këtu qaset... as ujku, që i citur rëkutet, as dreni trëmbësar, se i skondapsur karcen...	60
Mos nd'errët këtu kllitëshin preivestarët e armiqëvet, që po ditën kan dre? Jo kurr, kurr, për stilin tim, raft nd'errët Arbri in, se edhe i gërrisur e i shtipur do mblonj jetën me drit! Ashtu natën klëshedhrrat,	65 70

dhe në luftë pa u shquar. Kënga e vashave e harron djaln e mbetur duarkryq, vallja kthehet dhe e qesh...	50
Puna e natës veç i mbetet, që të zihet me hijet, i panjohur dhe pa nder! Kështu me vete mendoja, kur një krismë më përmendi...	55
- Do jetë era në ato dushqe, apo xhindi endacak? Por këtu s'qaset... as ujku, që i nginjur diku struket, as dhe dreri frikacak, që kërcen i shqetësuar...	60
Mos në t'errët janë futur pararojat e armiëve, që ditën po kanë frikë? Jo, jo kurrë, për ushtën time, në terr Arbri s'do të bjerë, se edhe copëtuar e shhtypur me dritë botën do ta mbushë!	65
Ashtu natënë kulshedrat,	70

prierr stihjis e Himarës, ¹ i vërviten tue shtën shi me breshër e me gjëm, se ajo ngrihet e i stëllon me shkeptim e bumbullim;	75
e ndo e sosur e krafosur frima i lipset e fuqia, me sit keq sgardhëlluar plasën malin me këmb, derdhën zjarmin si lum e, e çelur e e shkëndier, bie përpitur ndë pis. -	80
Zura stilin e u sdripa dhromit shtrëmbër ndë grop e te krejëza kërrusët mbeta, prita e mora vesh; mora vesh e një t'ecur ndieta, e pash një si hje ndrishe, e dreme, e trëbuame, sa edhe udhëza ng'e nxej.	85 90
Kish kriet te ret, kish lumin ndër këmb e gjith piellët verboi	

¹ Stihjia e Himarës, *Khimara* e elinëvet. Isht një horë e madhe e Arbrit. Atje, ndër tjer, ndodhet një mal po pështruar borje, që nka çukat derdhën zjarm tuke gjëmuar abrëndaz ilëvet të humbëta. Andaj Omiri streksi (thomse mbi të rrëfiemen e horiatëvet) se Himara ish një stihji me kriet e lefës, me gjirin e dhis e me bishtin e gjalpërit, që derdhëj po zjarm nka gola. Zjarmi i malit, shpatërat tek ahiera rroin lefat, barishtet ku kullotin dhut e fushat tek fërkonëshin gjalpërinjt, dhan lemjen përrallës e Omirit. Si llojaset, edhe ndë mon i Balës njerëzit, thamasur zjarmit, kamënoit e gjëmëshit e malit, kishin bes se një stihji e këlshedhurat e lubit kishin folen te humbjet e malit.

kthyer stihisë së Himarës, ¹ i vërviten duke i shtënë shi me breshër e me gjëmë; e ajo ngrihet e i qëllon me shkrepimë e bubullimë;	75
e, kur lodhur e plagosur i vjen metë fryma e fuqia, me sytë keq të zgurdulluar e pëlçet me këmbë malin, e derdh zjarrin porsì lumë	80
dhe, e ndezur plot shkëndija, e përpirë bie në ferr.	
Kapa ushtën edhe zbrita udhës së shtrembër deri në gropë dhe te krekëza e krrusur	85
ndala, prita e mbajta vesh; vura vesh dhe një të ecur ndjeva e pashë një si hije të frikshme edhe të madhe, sa edhe udhëza s'e nxinte.	90
Kishte kryet deri te retë, kishte lumin për nën këmbë, e gjithë grykat i errësoi	

¹ Përbindëshi i Himarës, **Khimara** e helenëve. Është një krahinë e madhe e Arbërisë. Atje, ndër të tjera, ndodhet një mal gjithnjë i mbuluar me borë dhe nga çukat vjell zjarr, duke gjëmuar përbrenda anëve të thella. Nga kjo Homeri mendoi (ndoshta nga tregimet e vendësve) se Himara ishte një përbindësh me kokë luani, me gji dhie e me bisht gjarpri, që villte gjithnjë zjarr nga goja. Zjarri i malit, shpatet ku atëherë jetonin luanët, livadhet ku kullotnin dhitë dhe fushat ku zvarriteshin gjarpërinjtë, bënë të lindi përralla e Homerit. Siç shihet, edhe në kohën e Balës njerëzit e habitur nga zjarri, tymi dhe gjëhimet e malit, besonin se në thellësitë e malit kishin foletë një përbindësh, kulshedrat dhe lubitë.

zez si miegull mbi shkëmb. U s'u tremba, u nakatosa; gjaku gjith m'u trazua e ndë ndrell nata m'u rënd...	95
Mundur dhunies, karceva e dreq udhës stëllova. Guri i rrahur kërsiti, shtu shkëndile e qielli u feks, e ndë truall i fërkuar, njo, m'u trua një plakarush:	100
“Se ti, i bushtër ushtor i natës, çë patakse i paproseksur mbi të fillëmin udhëtar, mba, mba kordhën e ndële këtë të moçëm ropi! Moti i rënd më dëlpëkoi llor, mushq edhe kurriz, m'u hap varri ndë vetëhe e më vrafshë pa nder...	105
As si armik do më kesh, se këtu kllitet ndë tru fjala e humbët e mbretëris, se do her e kral e mbret ¹ qasen mjerit Harun, si edhe lefa e shpatëvet time pasën dhëlpërën ndëlguame.	110
Nat e thellë moti i shkuam, po sa i humbet pleqëria;	115
	120

¹ Kral, mbret - Eliniqisht *kralës, kralaina* - mbretëresha; nka rrënja *khreō* = mbretëronj. Ki plak, Haruni, de t'ish një dervish, atireve çë dërgoin Skanderbeut miqët e tij, çë shum kish lën ndër turqit, sa t'i kallëzoin çëdo bëhej për të keqen e tij.

si mjegull e zesë mbi shkëmb. Unë s'u tremba, u turbullova, gjaku gjithë m'u trazua, edhe nata m'u rëndua...	95
Mundur turpit, unë kërceva dhe drejt nga udha qëlllova. Guri i rrahur kërciti, nxori xixa e qielli u feks, kur për truall i zvarrisur, seç m'u trua një plakarush:	100
“O ushtar i egër i natës, që vërvitesh i paparë mbi udhëtarin e vetmuar, mbaje kordhën edhe fale këtë robin tënd të motshëm! Moti i rëndë më përkuli llërë, shpatulla e kurriz, m'u hap varri në veten time, ti pa nder do të më vrisje...	105
As si armik të mos më kesh, se këtu në tru është mbyllur fjala e thellë e mbretërisë, se do herë kral e mbret ¹ i qasen Harunit të mjerë, si luani i shpateve të mi pas i shkon dinakes dhelpër.	110
Natë e thellë është koha e shkuar, ku përshkon veç pleqëria;	115
	120

¹ Kral, mbret - greqisht *kralës*, *kralaina* (mbetëreshë), nga rrënja *khreō* = mbretëroj. Ky plak, Haruni, do të ketë qenë ndonjë dervish nga ata që i dërgonin Skënderbeut miqtë e tij, se shumë syresh kishte lënë ndër turqit, që t'i kallëzonin ç'bëhej kundër tij.

plaku i vetëm do her helq andaj një drit e holl e mbi ret të pallojasëme e së nesërme e shprier.	125
E atje largu, atje posht triqimi e keqe u ndie; ikin frushkullit nka drea e, e sgëlidhur bumbullimës, rrioth era gjër' e gëlat.	130
Por qellëm tek Mbreti; errësira edhe ka vesh e më mirë fjala truhet tek i mbllituri shpërvier se livadhit gënjëtar.”	135
Tha e i aksëm u ngre si njeri, ç ë di do siell, e dreq udhën dëftoi. Pjes i njomur druetis, pjes i losur lipisis,	140
pjes thamasur asaj fjal, mballa Mbretit u ndodha. Ndë shpërvier i lart e i gjër rij e mbledhur bulëria, tek matej opolipsi,	145
punët, drea, druetia e luftës. Ish Gropa e Strezi i vrërët ¹	

¹ Zakaria Gropa kle një nka më t'urtit buler e shok i nderëm i Skanderbeut. Tue luftuar i vetëm me të vetëm, vrau më t'urtin e ushtorëvet e Amuradit. Gropa, pra që vëdiq Mbreti, me tjerët erdhi e stisi katundin i Pallac Adrianit e la embrin e tij malit i Gropës, që ngrihet nka ana e apolës e katundit.

Strezi, i biri i Gjellës, së motrës e Skanderbeut, kluar Goiku-Strezi. Kish një vëlla, që ia thoin Gjergji.

vetëm plaku nganjëherë nxjerr andej një fije drite, që mbi retë e pakuptueshme të së nesërme e kthen.	125
Atje larg, atje poshtë një e keqe zhurmë u ndie; ikën bishatë nga tmerri e, çliruar bubullimës, fryti era gjerë e gjatë.	130
Por mua shpjemë te Mbreti; ka veshë edhe errësira e më mirë fjala truhet në një shatorre të mbyllur se në livadhin tinëzar.”	135
Kështu foli e shpejt u ngrit si një njeri, që di ç’siell e drejt udhën më dëftoi. Ca i zbutur nga dyshimi, ca i prekur dhembshurie,	140
ca i habitur nga ato fjalë, para Mbretit seç u ndodha. Rrinte mbledhur bujaria në një tendë të lartë, të gjerë, ku po matej mençuria,	145
punët, rreziku e droja e luftës. Ishte Gropa e Strezi i vrenjtur ¹	

¹ **Zakaria Gropa** ishte një ndër bujarët më të urtë e shok i nderuar i Skënderbeut. Duke luftuar një për një, ai vrau më trimin e ushtarëve të Muradit. Gropa, si vdiq Mbreti, bashkë me të mërguar të tjerë, erdhi e themeloi katundin e Pallac Adrianit e i la emrin e vet malit të Gropës, që ngrihet nga ana lindore e katundit.

Strezi, i biri i Gjellës, së motrës së Skënderbeut, quhej Goiku Strezi. Kishte një vëlla, që e quanin Gjergj.

e me ta bulari i Sulit,
 Spata i keq njohur kënkës¹
 prej vashës mbretëresh,
 se ia vodhën për dhun
 e ai dhunën lau me gjak.
 Manëzi kordhës kumbisej,²
 burrë bëmash, jo fjalësh.

150

¹ Spata - Ki ish Sgur Spata, i nipi i atij Njanj Spata, i cili, pas Cucës Loshës, zotroi mbi tosqit e Ipirit, Akarnanies e Etolies afër vitit 1374. Përrallëza rrëfien se Sgur Spata, i nisur nga Suli, vate sa të kërkoj zulm e nder te mbretëria e Karlit të dritit, që ia thoin Tokut, prenktut i Qefallonies, Zantit e të Shënt Mavrës. Atje njohu e kle njohur nka Pulëzena, e bila e mbretit, e u deshën, pse ajo ish e bukurë e e ndëlgume e ai trim e i urt e i aksëm, sa mosnjeri i buletëvet e Karlit mundëj t'i rrij përpara më këmb e nkaluar. Shkoi i pari vit e Spata, tek-ai që Karli bënej këshill me buletë e mbretëris, u vu ndë mesët e i tha: "Zoti mbreti, me thelim, u të lip për grua satë bil; ndo u ndodhët njeri më i mir se u, u e pres ndë livadhin nd'an derës e apolës tri dit e tri nat, më këmb e nkaluar." E vate. Priti tri dit e tri nat e mosnjeri bular u duk. Tek e katërta nat Sguri vodhi vashën mbretëresh, e vu mbi galen e e solli ndë nisizën e liqerit e Janies e atje u bën darësëm të mbëdha, tek u mblodhën gjith buletë e Arbrit.

Shkuar një muaj ndër hare e hajdhi, Sguri pat të vej ndë ushtrët e, si e xun buletë frënk e Tokut, vatur bashk me një kope luftarësh, gënjien gjindjen e Spatës, e muarën pa hir vashën e e prun me ta mbi galen e ikën.

Sguri u pruar nka ushtret atë menat e, pra që ngë gjet më ndë shpi nusën, pa thën gjë mosnjeriu, hipi mbi galen e tij, e pasi frëngët e i arrejti afër Zantit e atje përpara sivet e ushtrës e Tokut, që pështroj rrëzën, therti buletë frënk, që i kishin vjedhur nusën, e u pruar ndë shpi me vashën e i nderëm, tek u kish nisur me dhun.

Pra që Arbri u sos, Spatërat me tjerët buletë ikën nd'Italin e Pal Xhovi e tjera shkruaz flasën nkalorit Spata si një kope bular i math e i urt. Thuhet edhe se shpia e prenktut Spada i Romës u le nka ki nkalor Spata (Dh. Kamarda, Hahn, Annali Ragusei)

² Manëzi, nj'etërë bular i shkluar, që edhe ndë livadh i mbllitur vrau një turk, të mirëshit.

e me ta bujari i Sulit,
 Shpata trim i njohur këngës¹
 së asaj vashës mbetëreshë, 150
 që për dhunë ia rëmbyen
 e ai dhunën e lau me gjak.
 Mbi kordhë Manëzi mbështetej,²
 burrë punësh e jo fjalësh.

¹ **Shpata.** Ky ishte Zgur Shpata, i nipi i Gjon Shpatës, i cili pas Pjetër Loshës zotëroi mbi toskët e Epirit, Akarnanisë dhe Etolisë rreth vitit 1374. Një gojëdhënë thotë se Zgur Shpata, i nisur nga Suli, vajti të kërkonte zulmë e nder në mbretëri të Karlit II, të quajtur Tokut; ky ishte princ i Qefalonisë, Zantes e Shën Maurës. Atje u njoh me Poliksenën, të bijën e mbretit. Ata u dashuruan, se ajo ishte e bukur dhe e mençme e ai djalë trim dhe i guximshëm, aq sa asnjë nga bujarët e Karlit nuk mund t'i dilte përpara, më këmbë ose kaluar. Kaloj kështu viti i parë dhe Shpata, ndërsa Karli bënte këshillë me bujarët e mbretërisë, hyri në mes e i tha: “O mbret, me lejen tënde, unë të kërkoj për grua tët bijë; po të ketë ndonjë njeri më të mirë se unë, e pres në fushë pranë portës së lindjes tri ditë e tri net, më këmbë ose kaluar.” E kështu vajti. Priti tri ditë e tri net, por s'u duk asnjë bujar. Natën e katërt Zguri e rrëmbeu vashën mbetëreshë, e hipi në një lundër dhe e solli në nisinë e vogël të liqenit të Janinës e atje bëri dasëm të madhe, ku u mblodhën gjithë bujarët e Arbërisë

Si shkoi një muaj me hare e dëfrime, Zgurit iu desh të vinte në ushtri e, si e mësuan këtë bujarët frëngj të Tokut, duke vajtur bashkë me një grup luftëtarësh, gënjyen njerëzit e Shpatës, e morën me pahir vashën, e hipën në një lundër dhe ikën.

Zguri u kthye nga ushtria atë menatë, e, pasi s'e gjeti më nusen në shtëpi, pa i thënë gjë kujt, hipi mbi lundrën e vet e i ndoqi frëngjtë dhe i arriti afër Zantes e atje përpara syve të ushtrisë së Tokut, që ruante bregun e detit, theri bujarët frëngj, që i kishin rrëmbyer nusen, dhe u kthye me nder në shtëpi bashkë me vashën, ndërsa ishte nisur me turp.

Si ra Arbëria, Shpatajt me bujarët e tjerë ikën në Itali e Pal Xhiovi dhe shkruet të tjerë të kohës flasin për kalorësin Shpata si për një bujar të madh e trim. Thuhet edhe se shtëpia e princave Spada të Romës rrjedh nga ky kalorës Shpata (Kamarda, Hahn, Annali Ragusei).

² **Manëzi,** një tjetër bujar i shquar, që, edhe i mbyllur në kampin e armiqve, vrau një turk nga më të mirët.

Mbi likurën një ariu	155
rij Leshi grundziu	
me Muzaqin për krah	
e me trimin e Enqëlinës. ¹	
Kuqi, Berrëzi e Perlati, ²	
zoti i math i Zendës e madhe, ³	160
gjukoin shtuara me ta.	
Arianithi mir-këshilli ⁴	
afër Mbretit mbi thron	
fjal të dishëme vij ndë mest,	
drit' e fanëme nd'errësir.	165

¹ Leshi, Alezi (Gjergji) pas pak mot te punat thënë nka Bala vrau Badherin (Ballabanin).

Gjin Muzaqi ish i shoqi i Vllajkës, të motrës e Skanderbeut.

Trimi i Enqëlinës ish Muzaqi, i biri i të motrës e Skanderbeut, i dashur shumë nka i ungjeli prej urtësin e tij.

² Gjergj Kuqi, Nik Berrëzi, Njanj Perlati, Krispi edhe tá bulet të lert e të shkluame ndë luft e ndë këshill.

³ Zoti i Zendës - ish Stefanoi i Balçit, për mbiembër Çernojeviç a Çernoviç. Ki ish i kushëriu i Balçit tretit, e degës së Balçenjëvet - despota që zotroin mbi Zendën të përposhëmen e mbi Malin-Ziun. Këjo shpi mbeti ndë Arbrit njera ndë vit 1532 e pra, përzën edhe ajo turqëshit, të sprasëmet koqe erdhën ndë Siçilien e stisën katundin e Shënt Engjëllit i Musharit, tek mënon njera më nani fara e saj.

⁴ Arianithi - Topia Golemi, kluar, si thot Barleti, edhe Komneni, Kommati, Komniati (Arianithes, Cominatus). Kle thën Topia i math e zotroi mbi horët, që reshten nka Vojuza njera te deiti i Artës. Arianithi u ndoth penk te turqit më par se të bilët e Njanji Kastoriotit; por i shpëtoi di vjet përpara se Skanderbeu, e smoli Ipirin, Kurvelen, Kaninën, Tepelenin, Nivicën e Himarën.

Amurathi i dërgoi një pashallar, Aliun, me një ushtrë të madhe, por ki Ali, ç'ish i biri i Vranëzit, si arrejti ndër malët, kle peleqisur nka Arianithi, sa për tridhjet vjet turqëvet ngë i dha më zëmëra t'i qaseshin. Arianithi martoi të bilën e tij, Donikën, me Skanderbeun (Luccari, pag 91).

Mbi lëkurën e një ariu rrinte Leshi grundëziu me Muzakun pranë tij e me trimin e Angjelinës. ¹ Kuqi, Berrëzi e Perlati, ² zoti i madh i Zendës së Madhe ³ me ta në këmbë gjykonin. Dhe Arianit këshillmiri ⁴ afër Mbretit përmbi fron fjalë të urta kuvendonte, dritë e mbarë në errësirë.	155 160 165
--	---

¹ **Leshi Alezi** (Gjergji) pak kohë pas ngjarjeve të përshkruara nga Bala vrau Badherin a Ballabanin (afër Krujës).

Gjin Muzaku ishte i shoqi i Vllaikës, së motrës së Skënderbeut.

Trimi i Angjelinës ishte Muzaku, i biri i së motrës së Skënderbeut, Angjelinës, të cilin i ungji e deshte shumë për urtësinë e tij.

² **Gjergj Kuqi, Nik Berrëzi, Gjon Perlati, Krispi** ishin edhe ata bujarë të lartë e të shquar në luftë e në këshillë.

³ **Zoti i Zendës** ishte Stefani i Balshit, i mbiquajtur Çernojeviç a Çernoviç. Ky ishte kushëriri i Balshit të Tretë, nga dera e Balshajve, sundimtarë, që zotëronin mbi Zendën e poshtme e mbi Malin e Zi. Kjo familje qëndroi në Arbëri deri në vitin 1522 e pastaj, si u përzu edhe ajo nga turqit, të fundit që mbetën prej saj, erdhën në Sicili, ku themeluan katundin e Shën Engjëllit të Musharit, ku rron ende fara e saj.

⁴ **Arianit Topia Golemi** i quajtur, si thotë Barleti, edhe Komneni, Komnati, Komniati (Arianithes Cominatus). Qe mbiquajtur Topia i Madh e mbizotëroi mbi viset, që shtriheshin nga Vjosa deri te deti i Artës. Arianiti u dha peng ndër turqit më parë se të bijtë e Gjon Kastriotit, por shpëtoi dy vjet para Skënderbeut dhe ngriti Epirin, Kurveleshin, Kaninën, Tepelenën, Nivicën e Himarën.

Muradi dërgoi kundër tij një pasha, Alinë, me një ushtri të madhe, por ky Ali, që ishte i biri i Vranëzit, si arriti ndër malet, qe shpartalluar nga Arianiti, sa që për tridhjetë vjet turqve nuk u bëri zemra të qaseshin andej. Kjo luftë e Arianitit me turqit u bë në vjetët 1434-1438. Më vonë Arianiti martoi të bijën, Donikën, me Skënderbeun (Luccari, faqe 91).

Atje Hamëza i miegulluami¹
 hahet vrerit; ndë e vërrefshe,
 gëlar shkëmbit bumbullisur.
 Ler ndë shpnes e mbretëris,
 u verbua ndë shpnes të verbër 170
 e nd'udh shtrëmbër u shpruar.
 Por arrejti dita e keqe,
 me të huajin e piksi,
 nderjes, zulmës e xheshi.
 Mbre, kush isht ai zot i math, 175
 ball i lart, se gjith mushqëshit
 çohet siprë bulëris,
 maje guri mbi ata rehje?
 Nën të kuqin losnik
 i shkëndien kumbura e arët... 180
 Isht i urti Vrana-Kont,²

¹ Hamza ish i biri i Stanizit Kastoriotit, të vëllait i Skanderbeut. Stanizi kle kluar turqëshit Karaguzi. Hamëza te dita e Moravës iku me t'ungjelin e me triqint t'arbresh, që ishin me ta, e kle i pari që i dha ndihëm për lefterin e atërisë.

Luftoi trimërisht gjith luftat e Arbrit. Por, pas që u martua i ungjëli e pas që iu le një bir, e sbuar shpnesën e mbretëris, i erth zili, u kanos e iku ndër turqit e u truati Mohamethit të ditit e i taksi se t'i jip ndër duar Skanderbeun të gjall a të vdekur. Mohamethi, i gëzuar se edhe te shpia e Katriotëve u gjend një kopiz, dha Hamëzës një ushtër e e dërgoi të shkatërroj horët e katundet e Arbrit, tuke i taksur mbretërin e t'ungjëlit. Por, sa Hamëza hiti ndër sinorët e Arbrit, ushtra e tij kle prer cop-cop e ai, marr gjall, vate e sosi filaqi Napol, tek e dërgoi i ungjëli, se iu duk e pandëlesëme ftesa e të nipit, më se ajo e Mozezit, se ng'e shtrëngojo gjaku.

94 Vranai - Barleti e kluan Vranacontes, tjer Urana. Ish një bular i math e Skanderbegu, pse prëhej mbi besën e tij, i truati Krojën, kur kle e rrethur nka Davleti me diqint mil turq. Fara e Vranenjëve mënon njera sot Pallac Adrian, por kan ndërruar të parën lepush V ndë G e ngë kluhen më Vranai, Vranesha, por Granai, Granesha.

Atje Hamza i mjegulluar¹
 hahet vrerit; po ta vëreje,
 i ngjante shkëmbit të bumbullisur.
 Lindur me shpresë të mbretërisë,
 në shpresë të verbër u verbua 170
 e u hodh në udhë të shtrembër.
 Por arriti dita e keqe,
 që e pleksi me të huajin,
 dhe lavdi e nder ia hoqi.
 Por kush është ai zot i madh, 175
 ballëlartë, që me shpatulla
 ngrihet sipër bujarisë
 si majë shkëmbi mbi kodra?
 Nën leshnikun e tij të kuq
 i shkëlqen kumbura e artë... 180
 Është i urti Vranakont,²

¹ **Hamza** ishte i biri i Staniz Kastriotit, të vëllait të Skënderbeut. Stanizi qe quajtur nga turqit Karaguzi. (Jeto i dhe vdiq midis turqve bashkë me vëllezërit e tjerë, përveç Gjergjit). Hamza në ditën e Moravës iku bashkë me të ungjin e me treqind arbëreshë, që ishin me ta, dhe qe i pari që i dha ndihmë Skënderbeut për lirinë e atdheut.

Ai luftoi trimërisht në të gjitha luftërat e Arbërisë. Por, si u martua i ungji dhe pasi këtij i lindi një djalë, duke e humbur shpresën e trashëgimit të mbretërisë, e zuri zilia, u kanos dhe iku ndër turqit dhe iu trua Muhamet II, të cilit i premtoi se do t'i sillte në dorë Skënderbeun të gjallë a të vdekur. Muhamedi, i gëzuar që edhe në shtëpinë e Kastriotëve u gjend një tradhtar, i dha Hamzës një ushtri dhe e dërgoi të shkatërronte viset dhe katundet e Arbërisë, duke i premtuar mbretërinë e të ungjit. Porsa Hamza hyri në kufijtë e Arbërisë, ushtria e tij u bë copë-copë, ndërsa ai, si u kap i gjallë, vajti dhe e sosi jetën në burg në Napoli, ku e dërgoi i ungji, sepse faji i të nipit iu duk më shumë i pafalshëm se ai i Moisiut, me të cilin nuk kishte lidhje gjaku.

² **Vranai** - Barleti e quan Vranakontes, disa të tjerë Urana. Ishte një bujar i madh e Skënderbeu, pasi kishte besim tek ai, i besoi Krujën, kur kjo qe rrethuar nga sulltani me dyqind mijë turq. Fisi i Vrananjëve gjendet edhe sot në Pallac Adrian, por e kanë ndryshuar gërmën e parë V në G e nuk quhen më Vranai, Vranesha, por Granai, Granesha.

Vranai zëmëre e krah lisi. Sa gjukon, njëqint farë çelënjën kënkën e luftës, njëqint flamur shtuell era,	185
njëmil kordha lën millin. Lëmoj qimen langorit Mirë-shpia pa kujdes, ¹ se te sit i gjelbëroin rahjet Janies e tij.	190
Rin, liqerëthi të ndehet shesh i rrimët, i thielluam, e suvalëza e rrahur, çë të shprishet ndër këmb, s'isht e bardh sa gjiri it,	195
çë shtin linjën qëndisur, gëlar miegullës të holl ndër di rehjez me bor. Gjirit fritur shërtimashit, Rin, shpëtonjën rëkimet;	200
era i merr e i siell zotit, zotit tënd, çë i ndëlgon, e sit njomur me lot fësheh me dor e athun i fësheh! Por çë thom e çë kujtonj?	205
Trimat e Arbrit njera një bëin këshill asaj nat. çë ndër ta i huaji u kllit. Për së pari me thamasm rreth vërrejti ata të lert	210

¹ Gjergj Mirëshpia ish i zoti i Janies a Janinës, Pas çë vëdiq Skanderbeu e pas çë ra Kroja, Mirëshpia iku me tjerët e kle vën për krie e bulerëvet, çë stisën Pallac Adrianin ndë vit 1482.

Vranai zemër e krah lisi. Sa hap gojën, njëqind fise ia nisin këngës së luftës, njëqind flamuj shpalos era,	185
njëmijë kordha dalin millit. Ç'po i lëmonte leshtë langoit Mirëshpia pa kujdes, ¹ se në sytë i gjelbëronin kodrat e Janinës së tij.	190
Rinë, liqeri të shtrihet shesh i kaltërt e i kthjellët; edhe valëza e rrahur, që të shprishet nëpër këmbë, s'është e bardhë sa gjiri yt,	195
që ngre linjën e qëndisur, që i ngjan së hollës mjegull ndër dy kodrina me borë. Gjirit, frytur psherëtimash, të shpëtojnë, Rinë, rënkimet;	200
era i merr dhe ia sjell zotit, zotit tënd, që i kupton; e sytë e njomur me lot më kot na i fsheh me dorë! Por Ç'po them e ç'po kujtoj?	205
Trimat e Arbrit të gjithë këshill bënin asaj nate, kur ndër ta i huaji u fut. Në fillim ai me habi rreth vërejtë ata burra	210

¹ **Gjergj Mirëshpia** ishte zot i Janies a Janinës. Si vdiq Skënderbeu e pasi ra Kruja, Mirëshpia iku bashkë me të tjerët e qe vënë në krye të bujarëve, që themeluan Pallac Adrianin më 1482.

e i magjepsur uli sit.
 Pra, duar nkriqëz ndë gji,
 për këmb Mbretit u përmiss.
 “Mbret i trimavet, i tha,
 tek ti shkon, i shkon drea, 215
 tek ti prire, jan buhua
 gjith kopet e armikut tënd.
 Kush si ti?... Një thirm e llavur
 bumbullisi shejtes Horë
 e rrioth ndë shkretir 220
 bashk me erën, që ngrin
 mal rërje mbi mal
 udhëtarit përsëlluar.
 Këtje i fillëm ndë hivur
 më gjet thirma e më skondapsi, 225
 rëzuar gjumit të humbët,
 tue thirr: “Sgjou, ngreu,
 sill ndë jet zjarmin tim!
 Fara e nëmur e Osmanit
 gënjeu besën, ç’i dhash 230
 majës malit i Rustanit,¹
 se me gjakun kulluar
 përzien gjakun trazuar...
 Kloft i shkelur për mon!
 Gëluha e jote u bëft kordh! - 235
 M’u bën kripët si driza
 e, i çelur fjalës rënd,

¹ Rrëfienjën turqit se, tek-ai që Erthogruli, i ati i Osmanit, flij mbi malin i Rustanit, i Armenies, iu duk nd’ëndër një plak, i cili i dha një cabie e i kallëzoi se ish melur se fara e tij zotroft mbi gjith jetën, mos bëft përzit me të krështenjët. Pra u rëzua e së pa më plakun; por iu ndoth ndë grusht cabia me di maja, e cila pra shkoi dor nka dor te të nipërat e tij njera te dita e sonëme.

e i magjepsur uli sytë.
Pastaj, duart kryq në gji,
u përgjunj ndër këmbë të Mbretit.
“Mbret i trimave”, i tha,
“tek shkon ti, atje shkon tmerri, 215
ku ti vete, bëhen pluhur
hordhitë e armikut tënd.
Ka si ti?... Një thirrme e tmerrshme
bubulloi qytetit të shenjtë¹
e u përhap nëpër shkretirë 220
tok me erën, që i ngre prapa
mal mbi male plot me rërë
udhëtarit të përvëluar.
Atje në guvë vetëm filli
më gjet thirrma e më turbulloi 225
e prej gjumit të thellë më zgjoi
duke thirrur: “Zgjohu, ngrihu,
sill në botë zjarrin tim!
Fara e nëmur e Osmanit
e theu besën, që i dhashë 230
majë malit të Rustanit,
pse me gjakun e kulluar
përzien gjakun e trazuar...
Qoftë e shkelur për gjithmonë!
Gjuha jote u bëftë kordhë!” 235
Flokët m’u ngritën si driza
e, i ndezur fjalës së rëndë,

¹ Turqit rrëfejnë se, ndërsa Erthogruli, i ati i Osmanit, flinte mbi malin e Rustanit të Armenisë, iu shfaq në ëndërr një plak, i cili i dha një shpatë e i kallëzoi se ishte shkruar që fara e tij do të zotëronte mbi gjithë botën, po të mos përzihej me të krishterët. Kur u zgjua, s’e pa më plakun; por në grusht kishte një shpatë me dy maja, e cila pastaj u shkoi dorë më dorë nipërve të tij deri në ditët e sotme.

ngjodha shalët, u mbatha,
udhës helmit u nisa.
Shum klajta, shum durova, 240
njera që një dit e zez
mbi Mokreun më gjet...”¹
- E ç’i gjete? (Mbreti i tha
buz mbë gaz, plot shkarzim).
Fol pak e fol dreq! 245
Pe margurin rëmor?

¹ Mokreu a Mokrea, mal i Dibrës (Barleti).

mirë u ngjesha e u mbatha,
pra u nisa udhës së helmit.
Shumë qava, shumë durova, 240
derisa një ditë e zezë
mbi Mokreun seç më gjet...”¹
“E po, ç’gjete? - i tha Mbreti
buzagaz, plot shkarëzim -
Folna pak e folna drejt! 245
A e pe tradhtarin e poshtër?

¹ **Mokeu** a **Mokria**, mal i Dibrës (Barleti).

Ku kullot Ballabani,¹

¹ Ballabani - Embri i tij, i pari, ish Badhera (Bidera?) e pra turqit ia than Ballaban. U le i arbresh, ndë hor e Petës, nën Kastriotin, prindësh të vabëqësh e rëmorësh. Çë vogëlith kle marr ropi. Luftoi pra nën kralin i shklerëvet, Wlad, kluar ndër turqit drakull, vjen me thën **djalli**, pse, sa turq i bijin ndër duar, aqë vrit me bushtëri të keqe.

Badhera, si la shkruar Marini Barleti me të tjera shkruaz, ish i aksëm ndë luftat, i ndëlgumë e i padre. Ikur edhe Wladit, u pruar ndër turqit e u mblua ndër janiçarët. Vrap u bë me nder e, kur Mohamedhi i diti muar Kostantinopolin, Badhera kle i pari çë hipi e ndëndi flamurin mbi ledhin. Pasandaj kle i haidhjari i Mohametit, i cili pra, sa llojasi se më t'urtit pashallar rrasbitëshin e pelëqisëshin Skanderbeut, i dërgoi Badherin, sa të ndodhëshin arbreshi mballa arbreshit.

Për së pari Badhera bëri këshill sa të gënjej Skanderbeun e i shkruati me opolips e i dërgoi me nder të madhe një vistar ari e t'ërgjëndi e të veshurash e stolish krisomeni. Por Kastrioti ndëlgoi kodhelen e arsiti vistarët; e pruar mprapa Badherit një shat, një pëlor e një drapër, shënk se ai u le qush e rëmor. U llojas se këtë herë Skanderbeu sfali, pse, thomse, Mohamedhi dej të bëj miqëri zëmërje; por ofiqia, çë ai bëri Badherit, çajti ndër të zënë pajtimet

Ballabani ahiera hiti ndë Arbrin e qelli për së pari ushtrën te një vend, çë ia thoin Val-kria (Barletius) afër malit i Mokreut a Mokries; prana ndë Valkalin (Valcalia, Valcales - Barletius). Skanderbegu, se njih sa ish i arçër e i aksëm Badheri, truati bulerëvet të i ruheshin ndër luftat e të mbahëshin të mbledhur te fushat të sbluame, pa u qasur piellvet e vaut i Valkalit. Por ai u foli ndë të zbrazët, pse dhjet trima harruan këshillin të mirë e, parë Badherin se zu e u sbith prej vaun i Valkalit, iu mprapën më të çelur; e ai më e më sbithej. Badheri pra, kur i pa të arretur tek e dej, ndë mend e vrap u mbajti e i pruar ballët, tek-ai çë shkluhëzat fëshehur ndër dushqit e drizat iu viershuan nka të di ilat e mblitën të dhjetët ndë mesët. Por ata së buarën zëmërën e, tue luftuar, çajtin rrethin, sa u ndodhën, edhe pa ditur, ndër livadhin e shpërvierët e turqëvet. Ati gjith ushtra u mblot e i ra asipra e tet trimat, të grisur e lavosur, klen zën të gjall e ngarkuar hekurash.

Tet trimat klen: 1) Mozez Golemi i Dibrës; 2) Gjirëza Vlladheni, kushëriu i Skanderbeut; 3) Goiku Muzaku i Engjëlinës, së motrës e Skanderbeut; 4) Gjin Muzaqi; 5) Njanj Perllati; 6) Nik Berrëzi; 7) Gjergj Kuqi; 8) Gjin Manëzi. Por Nik Peta e Pal Golemi së deshën të jipëshin ndër duart e turqëvet e luftuan trimërisht, njera çë iu sos gjaku e frima.

Skanderbeu pat një helm të keq për të vdekurit; por e ndiet më të rënd për të gjallët, pse Mohamedhi arsiti haromën, ç'i dërgoi sa t'i lëroj, e bë të vdiqën të teta të riepër gjall. Këjo luft e Valkalit isht nenjëja e kënkës e Balës.

Ku kullot Ballabani,¹

¹ **Ballabani** - Emri i tij i parë ishte Badher (Bidhera ?) e pastaj turqit e quajtën Ballaban. Lindi në Arbëri, në krahinën e Petës, nën Gjon Kastriotin, nga prindër të vobektë e të ulët. Qysh i vogël qe marrë rob, pastaj luftoi nën kralin e sllavëve, Vllad, i cili nga turqit quhej Drakul., d.m.th. djall, sepse, sa turq i binin në dorë, i vriste me egërsi të madhe.

Badheri, siç shkruan Marin Barleti dhe të tjerë shkrues, ishte guximtar në luftë, i zgjuar dhe i patrembur. Si iku edhe nga Vlladi, u kthye te turqit dhe u shkrua ndër jeniçerët. U bë shpejt i famshëm dhe, kur Muhamedi II mori Konstandinopolin, Badheri qe i pari që hipi dhe ngriti flamurin mbi ledhin e qytetit. Që nga ajo kohë u bë njeri i dashur i Muhamedit, i cili pastaj, kur pa se pashallarët më trima thyheshin dhe shpartalloheshin nga Skënderbeu, dërgoi kundër këtij Badherin, që të vinte përballë arbëreshin me arbëreshin.

Në fillim Badheri mendoi që ta gënjente Skënderbeun dhe i shkroi me respekt e i dërgoi me nderime të mëdha një thesar ari, argjendi e veshjesh e stolish të çmuara. Por Kastrioti e kuptoi grackën dhe nuk i pranoi thesarët dhe i dërgoi Badherit një shat, një pluar dhe një drapër, për t'i dhënë të kuptonte se ai lindi nga një derë e ulët. Unë mendoj se këtë herë Skënderbeu gaboi, sepse ndoshta Muhamedi donte të lidhte një miqësi të sinqertë, por fyerja, që ai i bëri Badherit, e prishi që në fillim pajtimin.

Ballabani atëherë hyri në Arbëri dhe e shpuri ushtrinë së pari në një vend, që e quanin Valkria (Barleti) afër malit të Mokreut a Mokries; pastaj në Valkal (Valkalia, Valcales - Barleti). Skënderbeu, i cili e dinte sa i guximshëm dhe trim ishte Badheri, i këshilloi bujarët që të ruheshin ndër luftërat dhe të qëndronin të mbledhur nëpër fushat e zbuluara, pa iu qasur ngushticave të vaut të Valkalit. Por ai foli në të zbrazët, sepse dhjetë trima, duke e harruar këshillën e mirë, si panë që Badheri zuri të zmbropsej drejt vaut të Valkalit, e ndoqën më me guxim, ndërsa ai zbythej gjithnjë e më shumë. Badheri pastaj, kur e pa që arritën atje tek donte ai, u ndal menjëherë dhe u ktheu ballët, ndërsa shigjetarët, të fshehur nëpër dushqet e drizat, iu vërsulën nga të dy anët dhe i mbyllën të dhjetë në mes. Por ata s'i la zemra dhe, duke luftuar, e çanë rrethimin dhe mbërritën, pa e kuptuar, në fushën dhe tendat e turqve. Aty e tërë ushtria u mblodh dhe u ra përsipër e tetë nga trimat, të copëtuar e të plagosur, qenë zënë të gjallë dhe vënë në hekura.

Tetë trimat ishin: 1) Mojsi Golemi i Dibrës, 2) Gjirëza Vlladeni, kushëri i Skënderbeut, 3) Goiku Muzaka, i biri i Angjelinës, së motrës së Skënderbeut, 4) Gjijn Muzaka, 5) Gjijn Perlati, 6) Nik Berrëzi, 7) Gjergj Kuqi, 8) Gjijn Manëzi. Por Nik Peta e Pal Golemi s'deshën të jepeshin në duart e turqve e luftuan trimërisht, derisa iu sos gjaku e fryma

Skënderbeu u helmua tepër për të vdekurit, por e ndjeu më shumë helmin për të gjallët, sepse Muhamedi nuk e pranoi çmimin, që ai i dërgoi për t'i liruar ata dhe i bëri të tetë të vdisnin të rjepur të gjallë. Kjo luftë e Valkalit përbën nyjën e Këngës së Sprasme të Balës.

kryekusari ndër kusarë? Sa janë gjithë? Ç'qëllim kanë?	
Ruaju rrenës, të mos kujtoj se po vjen të më gënjesh!	250
Duke u dridhur si purteka, pak pa folur si qëndroi, plaku i zverdhur iu përgjigj: “Përtej maleve një fushë	255
ngushtë shtrihet e lumi e ndan, anët e thella i lidh ura; afër urësë një kodër ndër murriza e gjineshtra, kulpra, ferra e kulumbri	260
fsheh tre mijë shkluhëza. Prapa kodrës në një shesh janë livadhet gjithë mbuluar, kuajt janë si milingona; çdo murgjar ka një kalorës.	265
Kështu i veshur, unë pa droje tërë ushrinë, sa desha, e pashë. Çdo grup rri tashti në pritje; vera e fshatrave të djegur deh ushtarë e pashallarë;	270
kurvëria tendë më tendë në nder të ndershmit dhunon; gra të njoma, jo ushtarë, pashë më shumë jongarë se shpata. Shpata e shenjtë e Erthogrulit	275
ngjishet keq e keq shkëlqen; edhe kur nxihet në gjak, ky është gjak të tredhurish, ose sklleverish të trembur, që kanë zemëruar të zotin.	280

Mbi dromidhet e Mosulit, shtën i prapët m'u dëftua: një kamastrëz e errët i ndërliksej ndë qaf; fustanela e mundafshët	285
holl e njom i bij mbi gëlu si një vashje për martes. Sado nxënet ndë shpërvier, isht sa gruaja dëshëroft; shqepe gëlet e kez e brez	290
me cilonaz qëndisur; mos një cabie, mos një stil! Po e vështroin si ndër si urdhratëzat qirqezat, ndo se kënkëza e sivasët,	295
ndo i pëlqeft kangjeli, ndo drosi ndë vapët keqe pemët shtridhur me bor..." Këtu prap Mbreti m'e qërtoi: - Fol pak e fol dreq!	300
Par të nisshej, thua çë pe? - "Par të nisëshja, nënd dit, një menatëz nkalkoi e dimil nkalor me të!..." - Fol! Ku vate e tek u pruar? -	305
"Njeri i mbilltur si varri, sado bën, s'e kallëzon. Por mbrëmanit përpara erth e shkruamja e Davletit; e me ëndërën e natës,	310
sado u fësheh, m'u kallëzua. Ndë mesët malëvet e Mores Ë i bëgat Kauri i Lalës,	

Mbi qilimat e Mosulit shtrirë praptas m'u dëftua; një zinxhirth-o i artë i ndërliksej mu në qafë; fustanella e mëndafshtë	285
dhe e hollë mbi gju i binte, si një vashe për martesë. Në shatorre kish çdo gjë, që një grua do të donte: vello të gjata, keza e breza	290
edhe fusta të qëndisura. Asnjë shpatë, asnjë ushtë! Në sy gjithnjë e vështtronin shërbëtorkatë çerkeze, nëse kënga e kënaqte,	295
a në vallja i pëlqente, a freskim në vapë kërkonte pemë të shtrydhura me borë..." Këtu prapë e qortoi Mbreti: - Folna pak e folna drejt!	300
Thuaj ç'pe, para se të niseshe! - "Nëntë ditë, para se të nisesha, në mëngjes ia hipi kalit e me të dymijë kalorës..."	
- Fol, ku vajti e nga shkoi? - "Njeri i mbyllur është si varri, se ç'bën, nuk e kallëzon, porse një natëz më parë erdhi e shkruara e Dovletit	305
edhe me ëndrrën e natës ç'ishte fshehur, m'u dëftua. Midis maleve të Moresë Është i begatë Kauri i Lalës,	310

Ballabani vate e i tha:	
- Lësho dhrin, dhrin të bardh,	315
çë m'u bi te kopështi it,	
paç pra kriet edhe petkun. -	
- Kur u pruart? Ndë ushtëri	
do siell vashën? Përgjegju! -	
Lart ledheshit e Beratit	320
u ndie thirma e Sebalikut,	
se erth Vllaku i zotit math;	
shpit e rugët pastronën,	
hidhen lule me kuror..."	
Plaku u qet e pat thelim.	325
Mbreti prier Pal Golemit,	
"T'e paç truar, i tha;	
mos t'ikët, mos gjukoft,	
mos prosekset njeri!	
Ec, t'e ruash me nder!"	330
Pali dual edhe pa hir,	
pse ndë zëmërën e shpoi	
embri i Lalës e Kaurit,	
tek-ai çë Niku i Petës,	
lën prakun, tek rrij,	335
ndë mesët trimavet u shtu:	
"Mua, mua, zot i lart,	
mua përket ai qen margur,	
se livadhevet e Petës	
kle pirgjim e nëm e dëm;	340
ëm thelim, sa t'e shkel,	
sa shpërlanj sihjenin,	
çë mbë Arbrit u bi..."	
"Sihjenia - tue qeshur Mbreti.	
Sihjenia, mbi qenërin!	345
Arbri i thellët si dielli	

Ballabani shkoi e i tha:	
- Lësho dhrinë, dhrinë e bardhë,	315
që mbiu në kopshtin tënd;	
paç pra kryet edhe pronën! -	
- Kur do kthehet? Në ushtri	
do ta sjellë vashën? Përgjigju! -	
“Lart nga ledhet e Beratit	320
u ndie thirrma e Seb-Aliut,	
se erdh bajlozi i zotit të madh,	
shtëpitë e rrugët pastrohen,	
hidhen lule dhe kurora...”	
Plaku heshti e u përcoll.	325
Mbreti, kthyer Pal Golemit:	
“Të qoftë truar ty” - i tha -	
“Mos të të iki, mos të flasë,	
mos të shohë asnjeri!	
Shko edhe me nder ta ruash!”	330
Pali doli edhe pa hir,	
pse në zemër seç e shpoi	
emri i Lalës dhe i Kaurit,	
ndërsa Niku, trimi i Petës,	
e la pragun, tek po rrinte,	335
e mes trimave u fut:	
“Mu, mua, zot i lartë,	
më përket ai qen pa besë,	
se ndër livadhet e Petës	
qe ndyrësi e nëm e dëm;	340
më ep, pra, leje që ta shkel,	
për të shplarë qelbësirën,	
që na mbiu në Arbëri...”	
- Qelbësira - qeshi Mbreti -	
Qelbësira, mbi qenërinë!	345
Arbëria e kthjellët si dielli	

qelbësin përzë!
 Se ti, i urt, bir i urti,
 fol; ai vet, ai qen margur
 zjarmin zëmërës të çeli? 350
 Mosgjë tjetër e përvëlon?
 Por u bëft si do ti!
 Mblith trimat, ec, mund
 edhe vashën lëro!
 Pra kujtofsh këta porsima: 355
 Pas t'i kesh skakumisur,
 ruaju, trim, urtëris sate,
 mos, i ngrohët ndë gjak
 e i verbër ndë luft,
 rafsh i sbeit ndë trap! 360
 Pase armikun edhe there,
 njera tek reshtet fusha,
 por, arëjtur ndë rahj,
 tek hapet vau i drem,
 hilqu aprapa e thirr shokët, 365
 se atje i miri ë gëlar ligut
 e athun sbiret urtësia -
 Niku taksi një të taksur,
 çë u sfluks ndë fanë keq.

qelbësirën e përzë!
Por ty, trim e bir i trimit,
fol, veç ai qen pa besë
ta ndezi zjarrin e zemrës? 350
Tjetër gjë s'e përvëlon?
Por u bëftë si do ti!
Mblidhi trimat, shko, fito
edhe vashën e liro!
Këto porosi kujto: 355
Ata thyer si t'i kesh,
ruaju, trim, guximit tënd,
se mos me gjakun të nxehur
e në luftë i verbuar
bie papritmas në trap! 360
Ndiqe armikun e there
deri atje ku shtrihet fusha;
por, sa të arrish te kodra,
ku i rrezikshëm hapet vau,
kthehu prapa e thirr shokët, 365
se atje i miri i ngjan të ligut
dhe kot i shkon trimëria. -
Niku bëri një premtim,
që në fatin e keq u zhduk.

Pjesa e tretë

E TRETA PJES

I

HUMBJA E KUSARIT

Leth-leth, qetu-qetu, çë edhe së feksej dita, për ndë piell e për ndë shpate, për ndë shqite e rogomina, rith Niku me shoqëzit.	5
Udhëtarit, ç'i përpoq shkret, i fillëm ndë nat, dukëshin hje të mallëkuame, gjellës e varrëshit përzën.	10
E bë kriq e tue shërtuar, truati gruan e bilëzit. Si apolës pra sbardhëlloi plono re vetulla e ditës, ata u sdripën nka çukat, tue karcier shkëmbe-shkëmbe,	15
e te Humbja e Kusarit, ku më e egër e gërrier mbi përroin ngushton udhën prapa driza, prapa lise, pa pupitur u rëkutën.	20
Ashtu ulq sosur uri, po çë delesh ndien merë, hundshtuara, me kodhele ven, mbahen, marrën vesh; pra me barkun fërkuar, si e grik sgardhëlluar,	25

PJESA E TRETË

I

LUGINA E KUSARIT

Lehtë e lehtë, qetë e qetë ndërsa dita s'kishte feksur, nëpër gryka e nëpër shpate, nëpër gërxhe dhe gremina, bridhte Niku tok me shokët.	5
Udhëtarit, që i takoi natën i shkretë e i vetëm, hije të mallkuara i dukeshin, jetës dhe varresh përzënë; bëri kryq dhe psherëtiu,	10
gruan dhe fëmijët u troi. E si lindjes zbardhëlloi vetulla e ditës plot me re, ata zbritën poshtë nga çukat, shkëmb më shkëmb duke kërcyer;	15
e te Lugina e Kusarit, ku më e egër, më e gërryer ngushton udhën mbi përruan, prapa drizash, prapa lisash, pa pipëtirë u strukën.	20
Ashtu ujqit e uritur, kur prej delesh ndiejnë erë, hundëngritur, tutje tëhu venë, ndalen e mbajnë vesh; pra me bark duke u zvarritur,	25
sy e grykë zgurdulluar,	

presin qengjëzit të sbeit.
 Niku i vetëm mbi një shkëmb,
 si një qift cepçeliku,
 rri pa tundur, pa frimë. 30
 E menata, çë i frin
 prapa shirit e ftohët,
 tue i shprishur mbi mushqit
 tuf-tuf grundën t'arët,
 edhe dielli, ç'i derdhën 35
 rrëmb e rrëmb e i bën kuror,
 së e ngrohën, s'e rëzon.
 Po sa gjiri i llaftarisën
 po sa ballët i ndërronet,
 si kur qielli ndërron re; 40
 her e her shkëlqen e qesh,
 her e her i vrënet siu;
 mbetet këmba e do karcenj,
 mbahet dora e bie mbi kordh.
 - Mbre! Do jet miegulla e lumit 45
 ajo e smolur mbi fushën,
 dre e dëm i korrëzëvet?
 A era e malit rrëmben rreth
 buhoin udhës e lëmishtet?
 - Jo, se lumëthi shkëlqen, 50
 era e malit m'u paps,
 edhe fletëz së tundet. -
 - Mbre! Çë kloft ai sbardhëllim,
 çë merr sit andaj posht?
 Jan shkreptimazit e vapës 55
 a liqerit pasiqira?
 - Jo, jan shapëkaz çeliku
 edhe karkal të arëta
 e lavutez të ergjenta

presin shqerrat në befasi.
Niku i vetëm mbi një shkëmb,
si një qift-o sqepçelik,
rri i patundur e pa frymë. 30
E mëngjesi, që i fryn
që nga pas qafës i ftohtë,
përmbi supe i shpërndan
tufë-tufë të artën grundë;
edhe dielli, që i derdh 35
rre- mbi rreze e i bën kurorë,
as e ngroh, as e përmend.
Vetëm gjiri seç i fryhet,
vetëm ballët i ndërrohet,
si kur qielli ndërron retë; 40
herë-herë shkëlqen e qesh,
herë-herë i vrëhet syri;
s'luan këmba e do të hidhet,
dorën mban, por i bie mbi kordhë.
- Bre! Do jetë mjegulla e lumit 45
ajo që lëviz mbi fushë,
tmerr e dëm i korrësve?
Apo rrëmben era e malit
pluhur udhës e lëmishte?
- Jo, se lumi po shkëlqen, 50
era e malit u qetua
dhe nuk tundet asnjë gjethe...
- Vallë, ç' do jetë ai zbardhëllim
andej poshtë, që të merr sytë?
Mos janë shkreptimat e vapës, 55
a e liqerit është pasqyra?
- Jo, janë shapkazë çeliku
edhe karkale të arta
e mburoja të argjendta

me kumbure të florinjta; janë trima, janë ushtarë, e kanë guximin në ballë.	60
Kapardiset mbi murgjarin Ballabani e duket div; i shpëton tmerri nga sytë, i ngjyen shpatën gjaku i skllavit, edhe vdekja i rri në dorë.	65
Si mohoi Arbërinë tek i errëti Drakul, nga të parët qe Badheri, i lëvduar në luftë e i pëlqyer në këshilla.	70
Pra, si Vlladit i pandehur qe dhunuar e burgosur, çau hekurat, që e lidhnin, iku e vajti tek qentë, ndërroi vend e shokë e besë.	75
Krahëforti e zemërguri ishte i zgjuar në të folur, pra ndër qentë u nderua. Qeni mbret e pa, e pëlqeu, lart e ngriti ndër bujarë.	80
Tash që erdhi në Valkal, zoti i madh i shkroi e i tha: “Shko tek mjegulla e Lalës mbulon yllthin e bardhë, yllthin e bardhë, që do jetë dritë e gaz në sarajet tona.” ¹	85

¹ Në atë kohë sulltanët e kishin zakon të merrnin gra ndër bijat e mbretërve e të princëve të krishterë të mundur; edhe e ëma e Muhamedit II ishte një e krishterë.

E Kaurit të m'i thuash:	
- Mbreti i mbretërvet të thot:	90
Lësho dhrin, dhrin të bardh,	
çë m'u bi te kopështi it,	
paç pra kriet edhe petkun! -	
U përgjunj Badheri e u nis	
e Kaurit i pru fjalën.	95
Qeni i dheut iu truati	
e të bilëzën i dha.	
Vajza klajti, rrahu gjirin,	
shkuli kripët, u përrip.	
Pra si e urt çë ajo m'ish,	100
kliti helmin ndë zëmër,	
vet se u truati zoguthit,	
zoguthit i malit. ¹	

¹ Zoguthi i malit, thomse, kle ndonjë malësor i besëm e i shpejt, i dërguar nka vasha Nikut, sa t'i kallëzoj dren të saj e t'i lipën ndihëm.

E Kaurit të m'i thuash:	
- Mbreti i mbretërve të thotë:	90
- Lësho dhrinë, dhrinë e bardhë, që më mbiu te kopshti yt, paç, pra, kryet edhe pronën! - U përgjunj Badheri, u nis e Kaurit i çoi fjalën.	95
Qeni i dheut iu trua e të bijëzën ia dha. Vajza qau, gjirin rrahu, shkuli flokët, u trishtua. Por si e urtë që më ishte, helmin e mbylli në zemër dhe veç zogut seç iu trua, zoguthit të malit-o. ¹	100

¹ Zogu i malit ishte ndoshta ndonjë malësor i besuar dhe i shpejtë, që i dërgoi vasha Nikut, për t'i treguar rrezikun e saj e për t'i kërkuar ndihmë.

II

KËNGA E ZOGUT

Zogë, o zogë kryezezë, si ti e vetme jam dhe unë; te shkretira ti vajton, këtu qaj unë natë e ditë. Ti gjithjë shoqin kërkon,	5
unë të dashurin e bora; jemi bashkë në mjerim, qofshim bashkë në liri! Por unë e mjera e penguar nuk kam krahë, s'mund të shpëtoj,	10
ti me krahëthit e erës rreh dhe malet edhe fushat, sa të kesh qejf e dëshirë. Ah! Po gjete shoqin tënd e gëzimin e zemrës sate,	15
shko edhe tek trimi im, tek ai trimi im i bukur, t'i rrëfesh helmet e mia, mallin tim-o të pasosur; e t'i thuash: - Nga ora e zezë,	20
që u zhduke në errësirë dhe pushoi dalngadalë zhurma e lehtë e këmbës sate, ra mbi kopshtin e Lules nëma e keqe e u bë shkretirë;	25
mbaroi gazi në rënkim, vrulli i vashës në lëngim. Nata e ndjeu duke folur,	

tue u truar hënëzës, hënëzës martrizës	30
mallit, besës dhe të rremes; nd'atë her të paharruam, çë të lëroi vëdekjes, edhe hëna lipsiare	
pështroi helmit vo-ballët me napëzën e miegullës e gjith brinjat u shurdhuan vait e lemëzës të saj.	35
Dita e pa kripshprisshur, pa kujdes, pa hajdhi, edhe prindit shkarzier, edhe vashazit qeshuar;	40
por ajo së të harroi, po ajo me bes të thell priti, priti parin vit, priti ditin edhe tretin, tretin të taksurëthin;	45
pra çë shkoi i treti vit, edhe priti e nëng u loth. Mori i ëmbli trimi im, thomse re ndë vëdekurit	50
te livadhi i pakujtuam, e farmëkosur botës mua të fillëmen harrove? Por vëdekur ngë je,	55
zëmëra ime thot, e di, se, vëdekur ndë klofshe, nani ardhëshe tek u me ëndërezën e natës, të më sglidhje besën.	60
Po një natëz u pash,	

hënëzës duke iu truar, hënëzës-o dëshmitares së mallit, besës dhe së rremes; në atë orë të paharruar, që nga vdekja të shpëtoi, edhe hëna e dhembshur-o ballin helmit e mbuloi me napëzën e mjegullës e gjithë brinjat u shurdhuan vajit e lemnës së saj.	30
Dita kripshprishur e pa, pa kujdes e pa hajdhi, dhe nga prindi e shkarëzyer, dhe nga vashat e përqeshur; por ajo nuk të harroi, por ajo me besë të thellë priti, priti të parin vit, priti të dytin dhe të tretin, të tretin vit të taksurin; pra, si shkoi i treti vit, priti prapë e nuk u lodh. - More i ëmbli trimi im, mos ke rënë ndër të vdekur te livadhi i pakujtuar dhe, prej dheut i helmuar, mua të shkretën më harrove? Por i vdekur ti nuk je, zemra ime thotë dhe e di, se, i vdekur po të ishe, do vije tek unë tashti me ëndrrën e natës-o, mua të më zgjidhje besën. Por një natëz unë pashë,	35 40 45 50 55 60

pash Dreqëzën nkaluar
 mbi një rrëmbëz hënëtare
 e me dorëzën të bardh
 më dëftoi dheun tënt, 65
 dheun tënt të lumëthin;
 e ndë mesët dritës e saj
 sbloi një pame parrëfieme,
 sbloi një ditë flamurare,
 e ndër flamurat e nderjes 70
 u t'u fala, trim i trimavet!
 Ndë je i gjall, pse së prire
 te ki gji çë llaftarisën,
 te këjo zëmër të thieme?
 Pse ngë vjen e më lëshon? 75
 Njo, se prindi edhe më shiti
 si një qenqez kasapit;
 njo, se qeni më vërviti
 e më helqën pa hir,
 ku as mall, as nder, as bes. 80
 Se ti, zog ime e fanëme,
 do t'i shtosh e t'i kujtosh
 këtë të sprasëme të truame
 e të mos m'e harrofsh!
 - Mara e rrethur armiqëvet 85
 vjen e shkon ndër vendet tënde
 afër ndeje e ti s'e di!
 Por, sa era e malëvet tënde
 i sivasët volizit
 e sa shpnesa e ndihmës sate 90
 i ngjallët zëmërezën,
 po do vinj edhe do rronj.
 Pra nd'era e malëvet tënde,
 pra nd'e lëft ndihma e jote,

pashë Dreqëzën kaluar
mbi një rreze hënëtare
e me dorëzën e bardhë
dheun tënd seç më dëftoi, 65
dheun tënd të lumurin;
e përmes dritës së saj
zbuloi një pamje të parrëfyer,
zbuloi një ditë flamurtare
e mes flamujve të nderit 70
unë t' u fala, o trim i trimave!
Në je gjallë, përse s'kthehesh
te ky gji, që llahatariset,
te kjo zemërzë e thyer?
Pse nuk vjen të më shpëtosh? 75
Ja, se prindi edhe më shiti
si një shqerrkë te kasapi;
ja, se qeni më vërviti
e pa hir po më tërheq
ku s'ka mall, as nder, as besë. 80
O ti, zoga ime e mirë,
do t' i shtosh e t' i kujtosh
dhe këto të fundit fjalë,
por shiko mos t' i harrosh:
- Mara, armiqsh e rrethuar, 85
po shkon ndër viset e tua,
afër teje e ti s' e di.
Derisa era e maleve të tua
asaj faqet t' ia lëmojë,
dhe sa shpresa e ndihmës sate 90
asaj zemërzën t' ia ngjallë,
po, do vijë edhe do rrojë.
Por në e lëntë ndihma jote
edhe era e maleve të tua,

sa të dish se nderja e Marës po me diellin perëndon, se atë mall, që i pari e ngau, moti e vëdekja s'e ndërron; vetëm kurmin xarrisur	95
do ket meje i shkreti qen, pse këjo thikëz e fëshehur, këjo thik, që kam ndë gji, do më ruanj nder e bes, do më jap lefteri!"	100
Ajo foli e zoga e gjeq, shkundi krahët e këndoi gaza-vajti një kënkë e gjith malin kumboi; pra muar erën ndë dreq e mbi ret më perëndoi.	105
Tek u nisurit pra vasha, as u pruar, sa vërrej vendet t'ëmbëla e vashëris; vet mbi varrin e s'ëmës klajti e u rrah sa jo më.	110
Si një delez ndër ujqit, e rëkutur mbi shal, pështëlluar me shqep, eci ditën, eci natën, përshkoi malëzit me bor, shkeli fiushazit me lule, njera ç'erdhën një menat tek livadhi, më që vein, më ngushtonej; nka nj'an brinja e lart, pa udhë, e egër, e nka tjetëra rëkoj lumi i trash, i thell, i zi.	115
	120
	125

nderi i Marës ti ta dish tok me diellin perëndon; se atë mall, që së pari e ngau, koha e vdekja s'ë ndërron; vetëm kurmin e zvarrisur do ketë meje i shkreti qen,	95 100
pse kjo thikëzë e fshehur, thikëza, që kam në gji, do më ruajë nder e besë, do më japë edhe liri!"	
Ajo foli, zoga e ndëgjoi shkundi krahët e këndoi një këngëz me gazavaj, sa i tërë mali kumboi; pastaj mori drejt nga era e mbi retë perëndoi.	105 110
Ndërkaq, vasha në të nisur as s'u kthye të vërente të ëmblat vende të vashërisë; veç mbi varrin e s'ëmës qau, qau e veten fort e rrahu.	 115
Si një delez midis ujqish, gjithë e strukur përmbi shalë, e mbështjellë me një shqep, ditë e natë udhëtoi, përshkoi male plot me borë, shkeli fusha plot me lule, derisa erdhën një mëngjes te livadhi, që, sa shkonin, më ngushtojë; nga një anë brinja e lartë, pa udhë, e egër, dhe nga tjetra anë rënkonte lumi i gjerë, i thellë, i zi.	 120 125

Si pa vendin Badheri,	
rreth vërrejti, u miegullua,	
mbajti kalin, muar vesh	130
e mbi cabien shtu sit...	
Por një fletëz së tundej,	
edhe frimë së pupitëj,	
së proseksej një lerëm;	
po sa vetëm mullinjëza,	135
mullinjëza e përroit,	
fëshehur gardhëshit këndoj,	
zë i fillëm i shkretirës,	
mbi të piksurën qetmi.	
Pra çë u qasën shoqëzit,	140
të shtrënguar gavnar,	
u thIELlua, u gëzua,	
e, qëndrisur murxharin,	
eci prap udhës dreme	
me kopilezën nd'anë.	145
Kishin vatur një stigmi,	
një stigmi a di stigmi	
njera tek angona e humbët,	
ku ndër shkëmbet udha u sbuar...	
Njo, pa pritur murxhari	150
hundsgjëruar, veshshtuara,	
tue u dridhur, zu e u sbith.	
I thamasur kalori,	
tue nëmur, ra mbi shpor;	
por murxhari trëmbësar	155
më e më sbithej e së shkoj...	
Tek-ai zogëza e malit	
nka gjith shkëmbet këndoi	
e gjith piellët kumboi...	
Vajza e gjeq, iu përvesh	160

Si e pa Badheri vendin,	
vërejt i rrotull e u vrenjt,	
mbajti kalin, vuri vesh	130
e mbi shpatën sytë i shtiu.	
Nuk po tundej asnjë gjethe,	
asnjë frymë s'pipëtinte	
dhe asnjë i gjallë nuk dukej;	
vetëm se mullënjëza,	135
mullënjëza e përroit,	
fshehur gjerdheve këndonte,	
zë i fillëm i shkretirës	
në të thellën qetësi.	
Pasi shokët iu afruan	140
të shtrënguar e krenarë,	
u kthjellua, u gëzua;	
e murgjarin duke ngarë,	
vazhdoi prapë udhës së druajtur,	
me vashëzën gjithnjë pranë.	145
Një çast si kishte kaluar,	
një çast apo nja dy çaste,	
deri te këndi i thellë, ku udha	
ndër shkëmbenj shkon e humbet,	
fare papritur murgjari	150
hundëfrytur, veshëngritur,	
duke u dridhur, zu e u zbyth.	
E kalorësi i habitur,	
duke nëmur, u ra shporeve;	
por murgjari, që u temb,	155
gjithnjë zbythej, para s'shkonte.	
Në atë çast zoga e malit	
nga gjithë shkëmbenjtë këndoi	
e çdo grykë seç kumboi...	
Dëgjoi vajza dhe i rrahu	160

- zëmëra, gjith u haharis,
e nka shalëza u pataks,
tue shtën një rëkim,
një rëkim e një ulërim.
- Ulërimin të saj 165
një ulërim bushtër e gëlat
gjith shkëmbëshit përgjegji
e nka shkëmb u bë një ushtor.
- Mballa-mballaz Badherit 170
mbi një kucar kumbisur,
siçelur, ballvrërët,
re e zez plo-shkeptim,
gjith një'Erg Niku u duk
e me zërin bumbullimës:
- "Pse m'u verdhe, qen' i dheut? 175
Gjellën tënde edhe shoqëvet
e kam mbledhur ndë dor.
Sa u vërrenj, sa pupit,
edhe dheu ju përpitën...
Por u nderjen kërkonj, 180
së dua gjakun qenëris.
Dha! Shtie cabien e lavutën,
lëm vajzën e pra ik!..."
- Si e gjeq, tuf-tuf
rrjepi mjekërën Badheri 185
e i llavur u zu ahj;
pra gjëmoi: "Eani këtu,
këtu eani, vëllezër,
therni gruan e ndërroni
gjell për gjell e gjak për gjak!" 190
- Njëzet trima, sa i nxej
vendi i ngusht, iu vërshuan...
Vajza e urt, se i llojasi,

- zemra, gjithë u gëzua
e nga shalëza u hodh,
duke nxjerrë një rënkim,
një rënkim e një ulërimë.
- Ulërimës, që dha vasha, 165
një ulërimë e tmerrshme, e gjatë
iu përgjigj nga gjithë shkëmbenjtë;
nga çdo shkëmb një ushtar doli.
- Ballë për ballë me Badherin 170
i mbështetur në një cung,
sytë ndezur, ballët vrenjtur,
re e zezë plot shkrepimë,
si një div Niku u duk!
E me zërin bubullimë:
“Pse m’u zverdhe, qen i dheut? 175
Jetën tënde dhe të shokëve
e kam të mbledhur në dorë;
sa të jap unë një shenjë,
dheu gjithë ju përpin...
Por unë nderin kërkoj, 180
s’dua gjakun e qenërisë.
Hajt! Hidh shpatën e mburojën,
më lër vajzën, pastaj ik!...”
- Si e dëgjoji, tufë-tufë
e shkuli mjekrën Badheri, 185
si i çmendur hante veten,
pra gjëmoi: “Këtu ejani,
këtu eni, o vëllezër,
therni gruan e ndërroni
jetë për jetë e gjak për gjak!” 190
- Njëzet trima, aq sa nxinte
vendi i ngushtë, iu vërsulën...
Vajza e urtë, që e kuptoi,

shpejt e e le si pelatorez mbi një shkëmb më karceu	195
e andaj, thikën helqur, thikëzën e gjirit, e kanosëme iu pruar; hund-hapët, sishkëptim, buzfritur, voličelur,	200
me këshetat fluturuar, me cilonën marr erës e me thikëzën ndë grusht, dukej Dreqeza e natës, kur sqota e dredhuri	205
shtie mbi hjet të mallëkuame.	
Qenët e pan e qëndruan, marr sit bukuris, ngritur cabiet, pa-tundur, posi hroaza të ngurëme.	210
Pra çë u mbetën e u mbetën, tue vërrejtur magjepsur, një më i bushtër a më gavnar ndehti krahun mb'atë...	
Ati zogëza këndoi	215
me një kënk keq shqerr, sa gjith malët taraksi e një kris e rënd u ndie; e te krisa të zet qentë ran prapët ndë truall,	220
njëzet akulësh krafosur.	
Mbi të parët, çë ran, dizet trima muarën vend; por të gjith edhe u fërkuan, tue zën gurët ahj	225
te një luc gjaku i zi.	

shpejt e e lehtë si sorkadhe mbi një shkëmb më kërceu dhe që andej, thikën hequr, thikëzën e gjirit-o, e kanosur iu kthye. Hundëhapur, syshkreptimë, buzëfrytur, faqendezur, me gërshetat të shpërndara, me fustanin tundur erës dukej Dreqëza e natës, kur stuhi e shakullinë shtie mbi hijet e mallkuara.	195
Qentë e panë dhe qëndruan, të verbuar bukurisë, shpatat ngritur, pa lëvizur, porsi shatorre të ngurta. Si qëndruan pak kështu, duke vërejtur të magjepsur, një më i egër, më i guximshëm ndeu krahun mbi atë...	200
Aty zogëza këndoi aq trishtueshëm një këngë, sa i drodhi gjithë malet, e një krismë e rëndë u ndie; prej krismës të njëzet qentë ranë praptas përmbi truall, njëzet shigjetash përshkuar.	205
Dhe të parëve, që ranë, dyzet trima u zunë vendin, por të gjithë u rrokullisën, gurëtë duke kafshuar, në një lucë gjaku të zi.	210

- Pra çë tjerët më mprapa
pan shoqët peleqisur
e vdekjen krahzeza,
se mbi kriet fluturoj, 230
njom-ftohët si taraka
u cilisën e u kthien.
- Buz mbë gaz, tue qeshuar,
ia dëftoi Niku Badherit:
“Kryezi, po vërë 235
burrat tënde si livisen,
vet vashës përzën
edhe gozhdës çë shkëlqen!
Dha! Shtie cabien e lavutën
e me ta priru, ik!” 240
- Ai e gjeq e s’u përgjeq,
por ndë sbeit e stëlloi
dreq me cabien mbi kriet.
Niku e rreshti me lavutën,
çë kumboi si kumbor, 245
e tri copa cabia u ça.
Si e pa dorën të xheshur,
prap me buzën mbë gaz
e çëmoi: “I paqërdesëm!
U s’e dua gjakun tëndë, 250
gjakun tëndë të dhunuam.
Ti ke t’ikësh do-a-mos,
i shkarzier si qen!”
Ndër të thënët, halnarin
preu murxharit me kordh, 255
e qëndrisi, e lavosi
aqë vrap, sa Badheri
as e pa, as e ndëlgoi.
I qëndrisur, i lavosur

- Kur të tjerët prapa tyre
panë shokët copëtuar
edhe vdekjen krahëzezë,
që mbi kokë u fluturonte, 230
krejt të ngrirë e të tromaksur
u tmerruan e u kthyen.
- Buzagaz, duke u tallur,
ia dëftoi Niku Badherit:
“Pa shiko, o derëzi, 235
si nxitojnë burrat e tu,
veç prej një vashe përzënë
dhe një gozhde, që shkëlqen!
Hajt! Hidh shpatën dhe mburojën
E me ta priru dhe ik!” 240
- Ai dëgjoi e s’u përgjigj,
porse befas e qëllloi
drejt me shpatën përmbi krye.
Niku e prapsi me mburojën,
që kumboi porsi këmborë, 245
e tri copash shpata u ça.
Si ia pa të zhveshur dorën,
prapë me buzën më gaz
e përçmoi: “I paturp!
Unë s’e dua gjakun tënd, 250
gjakun tënd të turpëruar.
Do a s’do, ti ke të ikish
si një qen i shkarëzyer!”
Duke thënë këto, ia preu
frerin murgjarit me kordhë, 255
e shpoi edhe e plagosi
aqë shpejt, sa Badheri
as e pa, as e kuptoi.
I shpuar dhe i plagosur

edhe rripeshit lëshuar,	260
kali u pruar si era	
e si miegull perëndoi,	
tue shkelur vdekurit	
me nkalorin më të.	265
Kurë u njoh nd'udhë dhunie	
e me t'ikurit përzier,	
pse shoqëzit e pasin,	
tue trëmbur, tue thirr,	
i rrëmaksëm çë m'ish,	270
rrahu kriet, grisi gjirin,	
tue shtën nëm e gjëm,	
kripdriza, sishpëtuar,	
të shkëlqieme si di ur,	
feksur natën grafomës.	275
Por murxhari vo-i-llavur	
më bërtet e më rrieth.	
Tanët, dal pjellës egër,	
mprapa i van me kordh në shal,	
tuke prer ata të shprishur	280
thel-thel, cop-cop.	
Pra ndë vorë, se Niku i thirri,	
gjaku citur.e mumbitur,	
vrap u mblodhën si ulqit,	
kurë mblidhen nka stani,	285
thertur dele e përzën qen.	
Pra çë u paps pak e pak	
krisa e luftës e bërrimi	
langu, langu te shkretira,	
vajza, cikëz e le,	290
posht shkëmbit karceu	
e me sit plo-lot,	

	dhe me rripat të lëshuar,	260
	kali u kthye porsi era	
	e si mjegull perëndoi,	
	duke shkelur mbi të vdekur,	
	dhe duke shpërndarë ushtarët	
	me kalorësin mbi të.	265
Kur pa veten në udhë të turpit	e me të ikurit përzier,	
	se edhe shokët pas i shkonin,	
	gjithë të trembur duke thirrur,	
	ngaqë ish dhe zemërak,	270
	kryet rrahu, gjirin grisi,	
	nëmë e gjëmë duke shtënë,	
	flokët si driza, sytë të dalë,	
	të shkëlqyeshëm si dy urë,	
	që feksin natën nga shpella.	275
	Por murgjari i tmerruar	
	rend më shumë, kur ai bërtet.	
Tanët, dalë grykës së egër,	pas u vanë me kordhë në dorë,	
	duke prerë ata të shprishur	280
	thela-thela, copë-copë.	
	Por më pas, kur Niku i thirri,	
	me gjak nginjur edhe ngjyer	
	vrap u mblodhën, si kur ujqit	
	mblidhen nga stani, ku kanë shqyer	285
	dele e qentë përzënë i kanë.	
Si u qetua pak nga pak	krisma e luftës e bërtima	
	atje larg te shkretira,	
	vajza, fluturëz e lehtë,	290
	poshtë prej shkëmbit kërceu	
	e me sytë mbushur me lot,	

ndër të qeshur, ndër të klar, porsi re proseksur diellit, se shkëlqen edhe hidhet, e me gjirithin suval, e mbriturëz, e nkuqurëz, zëkëputur i tha:	295
“Mori trim, mori bular, çë të varfërën, të vieturën, të harruamen nd’angon, duarshit qenëvet lirove e i ruate gjell e bes. Mbre! Paç truar nderjen time, se u mëmëzën e sbora, se u prind nëng kam e vëllezëret han bot...	300
Mbre! Ti klofshe mëma ime, po ti vet prind, vëlla! Mbre! Më ndihshie, më ruashe si një motrëz tek ti!”	305
..... (Këtu lipset nj’etër pjes.)	310

më të qeshur, më të qarë, si një re e ndritur diellit, që shkëlqen edhe derdh shi.	295
E me gjithin porsi dallgë, e trishtuar dhe e skuqur, i tha me zë të këputur:	
“More trim, more bujar, që bonjaken e braktisur,	300
të harruar në një skaj, duarve të qenve e lirove, dhe i mbrojte jetë e besë, truar të paça nderin tim,	
se unë mëmëzën e bora,	305
as baba unë nuk kam e vëllezërit hanë dhé...	
Deh! Ti mua m’u bëfsh nënë, ti baba e ti vëlla!	
Oh! Më ndih edhe më mbro si një motër në shtëpi!	310
..... (Këtu mungon një tjetër pjesë.)	

Pjesa e katërt

E KATËRTA PJES

I

DITA E VALKALIT

Stogu natën rrëkoi	
majës sterevet e Petës	
e gjithë frushkullit e malit	
iu përgjegjën së largu.	
U le dielli pa rëmbe,	5
keq i kuq e ngjier gjaku	
te një qiell si hi.	
Një oht e rënd ra mbi jet;	
së frij erë, së tundej flet;	
as një zogëz pupitëj.	10
Veç qitherëza lënguame	
bëj brumbull ndë shpat	
e me të një zëth i holl	
si kumborëz e ergjënd	
atje lart ndë lakoté.	15

PJESA E KATËRT

I

DITA E VALKALIT

Huti natën seç rënkoi majë kullave të Petës e gjithë bishat e malit për së largu iu përgjigjën. Lindi dielli pa një rreze, keq i kuq e ngjyer në gjak në një qiell porsi hi.	5
Ra mbi botë një afsh i rëndë, s'frynte erë, s'tundej fletë, asnjë zog nuk pipëtinte. Veç kumria po lëngonte, brumbulliste mu në shpat e me të një zëth i hollë si këmborëz e argjerndtë atje lart në çardak.	10 15

II

KËNKA E BERATIT

“Se Berat, se Berat!”¹

¹ Berati, katund i Arbrit. Tri vjet më par se lufta e Valkalit, pse Berati mënoi ndër duarët e turkut, Skanderbegu i vate me ushtrën, sa t’ë mirrëj. Turqit, që ndodheshin abrëndaz katundit, pse ishin të pakëz, u trëmbën e bën këshill, sa të gënjein t’arbreshin. E, si e than, iu godit se, mos i arrëft pas gjashtmbëdhjet dit ndihma, dein të jipëshin ndë duart e Skanderbeut. Skanderbegu i pat bes e u mbet me limonti pa u ruatur nka armiqët, pse dij se Davleti u kish nisur prej amahin, që kish me perëndorin i Trepzuntës. Por turqit beratiot ndë fëshehët shkruatin Davletit tue kallëzuar dren tire. U godit se Davleti, pas që pajtoi me perëndorin i Trapezuntës, prirej, kurë e arrejtë e shkruamja e beratiotëve e ahierë ndë mend u mbajti, mblodhi ushtrën e truat Sebalit (Barketi e kluan Sebalias), ushtor plak e i urt, e e dërgoi ndihëm Beratit. Sebalit vate aq i qetëm e shpejt, sa gënjeu Skanderbeun e i ra asipra i papritur, i paproksur, ndë sbeit. Ushtra e arbreshëve ndodhej e ndajtur mbë di pjes: njera me Muzaqin Topien, të kunatin i Kastoriotit, pse e shoqja ish Mamëza (e vogëlëzë e të motravet e Mbretit) e me Tanuzin Topien, ndehej prej fushat, që reshten mballa Beratit e kishin bashk ndihorët litinj, dërguar nka Ferrandi i Aragoës, mbretit i Napolit, mikut i Kastoriotit. Tjetëra pjes e ushtrës me Skanderbeun rrij më e qasur ilës e ledhit i katundit, mbi rehjet. Tek-ai që kopit e gjindja e Muzaqit e Tanuzit, do hain, do loin, do fliin, njo se pa ditur si arrejtin turqit e u shtun mbi tanët, që ndodheshin të pakujdesshëm e edhe të xheshur, e i rasbisën, i çajtin e i peleqisën. Athun Muzaqi e Tanuzi ndë atë triqimi të papritur me thirm e gji reshtën suvalat të buruame të armiqëve, se i pari, tue luftuar trimërisht, ra i vrar e i diiti shpëtoi pa hir e edhe i lavosur. Dësh Perëndia se Sebalit të sfalëj, pse vu krie t’ikurëve e Muzaqit e Tanuzit e s’u kujtua Skanderbeut, cili, rëmbier herën, iu vërshua mprapa me gjith gjinden e tij të tër e të prërët e i shkuli duarshit mundjen, e lëroi sa ushtor të Muzaqit qëndruan të gjall. Nata ndajti luftën e Skanderbeu u sukulis të zij udhën e të mblidhej Kroj i përgjakur e i helmuam prej vdekjen e të kunatit e shumë trimash, që u kalbën te livadhi i shkret. Pse te dita e Beratit ran më shumë se pes mil të krështenj, napolitanët të gjith. Sebalit mbi të nesërmen, pas që athun pasi Skanderbeun, u pruar Berat me gëzim të math, se ajo kle e para e e sprasëma her që turqit pan krahët e Skanderbeut. Pra nka vapa e çelur, të vdekurit, shtun këtu e këtë, qelbëshin tue farmëkosur erën, urdhëroi sa të pritëshin cop-cop e të shprishëshin gjithasajtëna, sa t’i hain bishkat. Andaj u le kënga e Beratit.

II

KËNGA E BERATIT

“O Berat, o Berat!”¹

¹ Berati - qytet i Arbërisë. Tre vjet para luftës së Valkalit, kur Berati ishte ende në duart e turkut, Skënderbeu shkoi atje me ushtri, që ta merrte. Turqit, që ndodheshin brenda qytetit, pasi ishin të paktë, u trembën dhe vendodën ta gënjenin arbëreshin. E si thanë, u shkoi mbarë, se u morën vesh me të që, në rast se nuk do t’u arrinte ndihma pas gjashtëmbëdhjetë ditësh, do t’i dorëzoheshin Skënderbeut. Skënderbeu u besoi dhe qëndroi pa vepruar, pa u ruajtur nga armiqtë, sepse dinte që sulltani ishte nisur për në luftën, që kishte me perandorin e Trapezuntës. Por turqit e Beratit i shkruan fshehurazi sulltanit, duke i kallëzuar drojen e tyre. Qëlloi që sulltani, pasi u pajtua me perandorin e Trapezuntës, po kthehej, kur i mbërriti e shkruara e beratasve. Atëherë menjëherë qëndroi, mblodhi ushtrinë dhe ia besoi Seb-Alliu (Barleti e quan Sebalias), ushtar i vjetër e trim, dhe e dërgoi në ndihmë të Beratit. Seb-Alliu shkoi aq fshehurazi e shpejt, sa e gënjeu Skënderbeun dhe i ra përsipër papritur e pa u kuptuar, në befasi. Ushtria e arbëreshëve ndodhej e ndarë në dy pjesë; njëra me Muzak Topinë, të kunatin e Kastriotit, sepse e shoqja e tij ishte Mamica (më e vogla e motrave të Mbretit), e me Tanush Topinë, ishte shpërndarë nëpër fushat, që shtrihen përballë Beratit; ata kishin me vete edhe ushtarët ndihmës latinë [=italianë], të dërguar nga Ferrandi i Aragonës, mbret i Napolit dhe mik i Kastriotit. Pjesa tjetër e ushtrisë me Skënderbeun në krye rrinte më afër mureve të qytetit, përmbi kodrat. Ndërsa trupat dhe njerëzit e Muzakut e të Tanushit hanin, luanin ose flinin, papritmas arritën turqit e u sulën mbi tanët, që ndodheshin të pakujdesshëm e të zhveshur, dhe i shpartalluan, i prenë e i copëtuan. Në atë trazirë të madhe Muzaku e Tanushi më kot u përpoqën me të thirrur e me gjoks të ndalnin valët e armiqve sulmues, sepse i pari mbeti i vrarë duke luftuar trimërisht dhe i dyti mezi shpëtoi i plagosur. Dësh Perëndia që Seb-Alliu gaboi, se vendosi të ndiqte të ikurit e Muzakut e të Tanushit dhe nuk u kujtua për Skënderbeun, i cili, duke përfutur nga ky rast, iu vërsul nga prapa me të gjithë njerëzit e tij të çlodhur dhe i rrëmbëu nga duart fitoren., duke shpëtuar sa kishin mbetur gjallë nga ushtarët e Muzakut. Nata i dha fund luftës e Skënderbeu shpejtoi të zinte udhën e të mblidhej në Krujë, i përgjakur e i helmuar nga vdekja e të kunatit dhe e shumë trimave, që u kalbën në fushën e shkretë, sepse ditën e Beratit ranë më shumë se 5.000 të krishterë, napolitanët të gjithë. Të nesërmen Seb-Alliu, si ndoqi më kot Skënderbeun, u kthye në Berat me gëzim të madh, se ajo që e para dhe e sprasmja herë që turqit i panë krahët Skënderbeut. Pastaj, meqë nga vapa e madhe të vdekurit e shtrirë këtu e këtej qelbeshin, duke prishur ajrin, ai urdhëroi që ata të priteshin copë-copë e të shpërndaheshin gjithandej, që t’i hanin bishat. Nga kjo lindi Kënga e Beratit.

(Këntoi Mara atë menat)	
Sa të varfër ti lure,	
sa të vea tue shkukur krip!	
Dit vramje, dit e zez,	5
mos u priershe ndë jet!	
Nata e vdekja të qulloft!	
Mos dielli të gëzoft!	
Katër angonashit e jetës	
viin shqipun llojë-llojë;	10
gjith spellëshit e malëvet	
russhin bishka këtu e këtë;	
gjak nd'erë, gjak ndë re,	
gjak nd'ujë, gjak ndë dhe;	
gurë nka gurë një shqer mish	15
krie a llore njëi trimi kish!	
Zonja Mamëz atë nat	
pat një ëndër keq e gëlat,	
se iu duk i zoti i verdh	
me gjith kurmin xar-xar	20
e kurorëzit mbi shtrat	
i pështroi me shqep të zi;	
holq unazën për martes	
e ia ndajti mbë di pjes,	
një e mbajti, një ia dha,	25
pra u humb e gjë ng'i tha.	
Natë e dit ajo vajtoi	
e nka varri s'e rrëzoi."	
Ashtu Mara më këntoj,	
së këntoj, po rëkoj;	30
e m'e gjegji nka polia	
zonja Len e m'e qërtoi:	
"E përlepëme, zonja nuse,	
t'u çel kënka somenat;	

(Këndoi Mara që menatë)	
Sa bonjakë ti ke lënë!	
Sa të veja shkulën flokët!	
Ditë vrasje, ditë e zezë,	5
mos ardhsh kurrë më në jetë!	
Nata e vdekja të mbuloftë!	
Dielli kurrë mos të gëzoftë!	
Nga të katër anët e dheut	
tufa-tufa vinin skifterët	10
e nga gjithë shpellat e maleve	
zbrisnin bisha këtu e këtje;	
gjak në erë, gjak në re,	
gjak në ujë, gjak në dhe;	
gur më gur një copë mish	15
kreje a llëre trimash kish!	
Zonjë Mamica atë natë	
pa një ëndërr keq të gjatë,	
se iu duk i shoqi i verdhë	
me gjithë kurmin copëtuar	20
e kurorezat mbi shtrat	
i mbuloi me shqep të zi;	
hoqi unazën e martesës	
e ia ndau në dy pjesë,	
një e mbajti, një ia dha,	25
pra u zhduk e gjë s'i tha.	
Natë e ditë ajo vajtoi,	
por nga varri dot s'e zgjoi."	
Ashtu Mara më këndonte,	
nuk këndonte, por rënkonte;	30
që nga oda e dëgjoi	
zonja Lenë e ma qortoi:	
"E përzishme, zonja nuse,	
t'u çel kënga qëmenatë;	

ndo-mos nj'ëndërrëz të keqe a vdekurit ti pe?"	35
- As m'ërth nj'ëndërrëz të keqe, as vdekurit u pash, por kam zëmërrën të thier e pa hir më hidhen lot.	40
Sado shoh, e shoh mbë zi... Bobo, bobo! Niku in, kurë u nis, m'u helmua edhe unazënë më desh!...	45
Vemi,mo, vemi ndë rahj, tek sblonen gjith fushat, ndo se Niku na u pruart - Van të nximet mbi rahj e vërein drej e shtrëmbër, sa me trastën e me astenin,	50
pan përderësin se klaj. "Se i përderës mavri, paç uratën pse kla? Ndo mos kafshën të vjedhur, a kalivëzën të djegur,	55
a it birëthi t'u sbuar ndër këta amahjez të shkret?" - As kafshën, as kalivën, as birëthin u kla...	60
Sit time u bën lum, çë prej Arbrit kullon... - "Fol ti, zë i fatit keq, (thirri vasha, se i zu pik) çë bushtëri pe nd'ushtrë? Si ra Arbri ndë lip?	65
Fol! Ndër flamurat e luftës qiftin Petës e prosekse?"	

mos ndonjë ëndërr të keqe a të vdekurit ke parë?”	35
- As ndonjë ëndërr të keqe, as të vdekurit s’kam parë, por zemrën e kam të thyer e pa hir më rrjedhin lot.	40
Çfarëdo shoh, e shoh mbë zi. Ububu! Ky Niku ynë, kur u nis, seç u helmua dhe unazën më kërkoi!...	45
Vemi, nënë, vemi mbi kodër, tek zbulohen gjithë fushat, mbase Niku po na kthehet! -	
Vanë të nxirat mbi kodër e vërejtën djathtas, majtas, kur përderësin me shkop e me trastë panë që qante.	50
“O përderës derëzi, paç uratën, përse qan? A mos kafshën ta kanë vjedhur, a kalidhen ta kanë djegur, apo birthi të humbi në këto luftëra të shkreta!”	55
- As kafshën e as kalidhen, as dhe birthin s’po qaj... Sytë e mi u bënë lumë, që për Arbërin kullon... -	60
“Fol ti, zë i fatit të keq! (thirri vasha, se i ra zali) Ç’gjëmë pe në ushtri? Si ra Arbëri në zi?	65
Fol! Ndër flamurët e luftës qifin e Petës a e pe?”	

U përgjeq krieziu:

“Thom, u thom se dje menat ¹	
atje lart nka Muzëkat	70
gjegjshin gjëm e llumbardat;	
gjëmëshit, llumbardashit	
gjith jeta më gjëmoj,	
kamënoi dufeqevet	
gjith malët miegulloj,	75
sbardhëllimit cabievet	
gjith fushat më shkëlqein,	
gjakut ushtorëvet	
mblonëshin lumërat;	
copëshit stillëvet	80
bënëshin urë e stisëshin;	
shtronëshin sheshe ndë Valkal	
e mbi sheshe ngrihëshin mal.	
Si suvala e deitit bie	
e pra priret ndë thell,	85
e si arat të blerëme	

¹ Këta të para trimbëdhjet vjershe e përderëzit ndodhen përzier ndër Kënkat e Pleqëris me njëtër kënk, prën Pallac Adrian më vorë, kur erdhën Koronenjë, që sosën:

Thot ndër ta një ushtor:
 Kuj juve zëmëra i jep
 derës Napiot t’i bier?
 U përgjeq njëri ndër ta:
 “Mua zëmëra më jep,
 derës Napiot t’i bie
 jo një her, po tri her,
 e Kuronit e Mushkovit
 e pra Napiot burraz të mir.”

Kënkat të moçëme, tue shkuar dor nka dor e gol nka gol, u kan trazuar e përzier njera me tjetrën e u ka dashur një kujdes e madhe, sa të mblidhëshin arn mbi arn Kënkat e Balës.

U përgjigj ai derëziu:

“Them, unë them se dje menatë ¹	
atje lart nga Muzëkatë	70
ndiheshin gjëmë e gopedra;	
nga gjëmimet e gopedrat	
gjithë bota seç gjëmonte,	
tymi i dyfeqeve	
gjithë malet mjegullonte,	75
zbardhëllimit të shpatave	
gjithë fushat seç shkëlqenin,	
gjakut të ushtarëve	
mbusheshin lumenjtë;	
nga copat e ushtave	80
bëheshin e ngriheshin ura;	
shtroheshin sheshe në Valkal	
e mbi sheshet ngriheshin male.	
Si tallazi i detit bie,	
pastaj kthehet në thellësi,	85
e si arat e bleruara	

¹ Trembëdhjetë vargjet e para të përderësit ndodhen të përziera ndër “Këngët e Pleqërisë” me një këngë tjetër, të sjellë në Pallac Adrian më vonë, kur erdhën koronianët. Ajo mbaron kështu:

Thotë një ushtar ndërë ta:
Cilit nga ju i bën zemra,
derës Napiot t’i bjerë?
U përgjigj njëri ndër ta:
Mua zemra më bën,
derës Napiot t’i bie
jo një herë, por tri herë,
e Koronit e Mushkovit,
e pra Napiot, o burra të mirë!

Këngët e moçme, duke kaluar dorë më dorë e gojë më gojë, janë trazuar e përzier njëra me tjetrën e është dashur një kujdes i madh, që të mblidheshin arnë mbi arnë Këngët e Balës.

¹ Dukagjinët ishin di, Niku e Pali, e zotëroin mbi horët prej Drinit, ndë Zadrimeën të siprëmen, njera te sinorët e Shklerëvet (Barletius). Ngë njihet cili i të di Dukagjinëvet kle krie-ushtrie te lufta e Valkalit.

¹ Dukagjinët ishin dy, Niku e Pali., dhe zotëronin mbi viset përtej Drinit, në Zadrimën e sipërme, deri te kufijtë e sllavëve (Barleti). Nuk dihet se cili nga të dy dukagjinët qe kryeushtar në luftën e Valkalit.

dhjet drangor ran mbi shpor, dhjet gjëm ndë dredhuri, e ndë mesët u pataksën, reshtur stilët si stavar, shtun, vran, peleqisën,	120
ngritin mal këtu përtej, mal vdekurësh e lavosurësh. Hapën dier të gjër, shtruan një udhë keq e gëlat si vulak ndër të mbiella.	125
Ashtu Drini i Zi ndë dimbrit, plot përrenjëshit e malëvet, arren fritur e trëbuam, përpjek ujërat liqerit, i merr xar e ndan ndish;	130
ngrihet lart suvala e bardh e rreth rrëzavet gjëmon. Por si ujërat e liqerit, pas çë ndajtur u kthien, priren vrap e bënjën shesh,	135
si edhe lumin pështrojën, ashtu bëri kopea e bushtë, (par të pakët ç'e shtitën), se e mbledhurë e shtuame mprapa dhjetëvet u mblli.	140
Mbreti ahiera e Dukagjini, shprishur tjerët, u pruarën e ran bashk mbi Badherin mballa, aprapa, këtej, përtej. Peleqisur e rasbisur,	145
qeni i shkret zu e u sbith, por pa i sgëlidhur e i tër brënda vaut u mblloth,	

dhjetë drangonj u ranë shporeve,
dhjetë rrufera në stuhi,
u vërvitën mu në mes;
shtrirë ushtat si purteka,
shtinë, vranë, copëtuan, 120
ngritën pirqje këtu e përtej
me të vdekur e të plagosur;
edhe hapën dyer të gjera,
shtruan një udhë keq të gjatë,
si një brazdë ndër të mbjella. 125
Ashtu Drini i Zi në dimër,
mbushur nga përrënjtë e maleve,
vjen i fryrë e i tërbuar,
përpjek ujërat e liqerit,
i merr zvarrë e i ndan dysh; 130
ngrihet lart tallazi i bardhë
e rreth brigjeve gjëmon.
Por si ujërat e liqerit,
që, si ndahen, prapë kthehen,
kthehen vrap e bëjnë shesh, 135
sa edhe lumin e mbulojnë,
ashtu bëri hordhia e bushtër,
(si pa që pak po sulmonin),
duke u mbledhur dhe shtrënguar,
pas të dhjetëve u mbyll. 140
Mbreti atëherë e Dukagjini,
si thyen të tjerët, u kthyen
dhe tok ranë mbi Badherin
para, prapa, këtej, përtej.
Copëtuar e dërrmuar, 145
qeni i lig zu e u zbyth;
por i pazgjidhur dhe i tërë
brenda vaut seç u mblodh,

gëlar ariut i Tomorit,
 se, delmershit përzën, 150
 njërin vret, tjetrin shqier,
 e ndo i gërrisur e i përgjakur,
 po pa dre ndë zëmërën madhe
 priret shpatit, nka duall,
 citur gjaku e citur mishi. 155
 Pra çë u ngris, Mbreti u holq
 me gjith ushtërën ndë fush;
 çeli zjarmërat e natës,
 lavosurëvet dha mal..."
 - Mos të zëft nëma e zez! 160
 (Thirri Mara si një e llavur).
 Qift'i Petës më u mbloth,
 e prosekse ndër lavosur? -
 Ai u qet e s'u përgjeq,
 u verdhua me si ndë truall 165
 e i biin lot pik-pik.
 Ndëlgoi vasha e me një ulërim
 dreq udhës m'u rus,
 jo se u rus, m'u rrogomis
 e prej malëvet perëndoi. 170

 (Edhe lipset një pjes)

Gjith natën, gjith ditën
 me nkalorët të mi
 u rriodha pa u papsur;
 e përshkova nënd fusha,
 nënd fusha e nënd mal, 175
 take prer, take vrar
 qenët shprishur e shpëtuar.
 Pra çë sprasëmet sfelukën

si ariu i Tomorit,
 që, i përzënë nga delmerët, 150
 njërin vret e tjetrin shqyen,
 dhe i grisur e i përgjakur,
 por pa frikë në zemër të madhe,
 kthehet shpatit prej nga doli,
 nginjur gjaku e ngopur mishi. 155
 Si u ngrys, Mbreti u tërhoq
 me gjithë ushhtinë në fushë,
 ndezi edhe zjarret e natës,
 u kujdes për të plagosurit.
 - Mos të zëntë nëma e zezë! 160
 (Thirri Mara si e çmendur)
 Qifti i Petës a m'u mblodh?
 A ma pe ndër të plagosur? -
 Ai heshti, s'u përgjigj,
 u zverdh e me sy në truall, 165
 lotët i binin pikë-pikë.
 Kuptoi vasha e drejt udhës
 zbriti duke ulëritur;
 jo, nuk zbriti, u rrokullis
 e nga malet perëndoi. 170

 (Edhe këtu mungon një pjesë)

Gjithë natën, gjithë ditën
 me kalorësit e mi
 unë brodha pa pushuar;
 e përshkova nëntë fusha,
 nëntë fusha e nëntë male, 175
 duke prerë, duke vrarë
 qentë e shprishur dhe të ikur.
 Si u zhdukën dhe të sprasmit

përtej brinjës e Mokreut e që dita m'u serpos, holqa shoqët e u prora. Më që qasëshim livadhit, vrëhej, errej zëmëra e ime, velur vramjes trazuame, pas që zjarmi u shua ndë hi, se gjith drizat e barishtet ishin lier ndë të kuq e vuleqet e handaqet bisgël gjakut të piksur. Afër vaut ndë Valkal, tek lufta bushtër u çel, rriin vdekurit mal-mal e ndër malët e vdekurvet ulq e qen buzngjier gërrisin, shqirin barkë e zorrë, tek-ai që me bërrim pështroin diellin si re rape e sorra me shqipun.	180
Sa e bukur trimëri, se edhe dje haj ret, sot qetet për mon, posi plëh shtën ndë dhe! Mbë sa vjershe vdekja e shkret m'u dëftua nd'ata sivon! Këtu një ushtorëth i ri mbliti sit tuke klar, kujtuar mëmën se e prit! Alëmëno e athun e prit! Këtje armiku nkrah armikut zën ahj si di qen, se edhe vdekur do vrisëshin!	185
	190
	195
	200
	205
	210

përtej brinjës së Mokreut, edhe dita si u err,	180
hoqa shokët e u ktheva. Sa më shumë i qaseshim fushës, vrëhej, errej zemra ime, prekur vrasjes së trazuar, pasi zjarri u shua në hi,	185
se gjithë trimat e barishtet ishin lyer në të kuq, edhe brazdat e hendeqet ishin plot me gjak të piksur.	190
Afër vaut në Valkal, ku u ndez e ashpër lufta, stivë-stivë ishin të vrar, e ndër stivat e të vrarëve ujq e qen buzëngjyer	195
grisinin, shqyenin bark e zorrë, ndërsa, duke krakëllitur, si re diellin mbulonin korba, sorra e skifterë.	
Sa e bukur djalëri, që deri dje përpinte retë,	200
sot ka heshtur për gjithmonë porsi pleh i shtënë në dhe! Në sa trajta vdekja e shkretë m'u dëftua në ato pamje!	205
Këtu një ushtar i ri mbylli sytë duke qarë, mëmëzën duke kujtuar, që e priste, oh, më kot!	
Këtje armiku krah armikut, si dy qen duke u kafshuar, se edhe të vdekur do të vriteshin!	210

Nakatosur e i helmuar,	
prora sit nka pamja e keqe,	
prora sit e afër urës	
pash ndë sbeit një murxhar	215
me kriet ult ndë truall,	
me halnarët ndër këmb,	
me mutafën xar-xar	
e me shal nën bark.	
U iu qasa jo pa dre,	220
se mutafa krisomeni	
më rrëzoi drueti të lik,	
se qëndisur më duku	
lefa-lefa ndë të gjelbër.	
Nd'an murxharit një ushtor	225
me dhjet akul ndë gji	
ish shtun si ka thertur.	
Shtrëngoj flamurin me dhëmb,	
mbaj kordhën me grusht	
e, prier qiellit me ball,	230
edhe vdekjen shkarzej.	
Jo sa pendëshit ainit,	
jo kumburës t'ërgjënd,	
po sa vetullashit të shtuame	
e sa sizit sgardhëlluar,	235
Pal Golemin u njoha;	
e karceva ndo t'ish gjall	
e e holqa me kujdes	
tek barëthi më i shkrift;	
e, prer rripet e kumburës,	240
klita dorën mbi zëmër	
e m'u tund ndën dor.	
Riodha shpejt te lumi,	
mora e solla një pik ujë	

I trazuar dhe i helmuar,
hoqa sytë nga pamja e keqe,
ktheva sytë dhe afër urës
pashë papritmas një murgjar 215
me kryet ulur mbi truall
e me frerët nëpër këmbë,
me mutafën copë-copë
e me shalën ndënë bark.
Unë iu qasa jo pa droje, 220
se mutafa në ar qëndisur
një dyshim të lig më ngjalli,
se e qëndisur m'u duk
me luanesha në të gjelbër.
Pranë murgjarit një ushtar 225
me dhjetë heshta në gji
shtrirë ish si ka i therur.
Me dhëmbë flamurin shtrëngonte,
kordhën e mbante në grusht
e me ballin kthyer qiellit 230
edhe vdekjen e përbuzte.
As nga pendët e zhgabonjës,
as nga kumbura e argjendtë,
por nga vetullat kalesshe
e nga sytë e zgurdulluar 235
Pal Golemin unë e njoha;
e kërceva mos ish gjallë;
e tërhoqa me kujdes
ku ish bari më i shkrifët;
e, si i preva rripat kumburës, 240
i vura dorën mbi zemër
e ajo m'u tund nën të.
Shpejt vrapova deri te lumi,
mora e solla një pikë ujë

e ia derdha mbi volit.	245
Ai u shtrik me një shërtim	
si njeri ndë gjum rënd;	
smoli kriet, m'u pruar,	
më llojasi e pa lëngim,	
me zë humbët më tha:	250
“Le vdekurit ndë vend,	
lem të flë për gjith mon	
te ki shtrat i nderjes sime,	
këtu tek eshtrat e të vrarëvet,	
e të vrarëvet kësaj dor,	255
gjith mon më jan kuror.	
Xa këtë flamur e Mbretit	
të m'i thuash këta fjal:	
- Pal Golemi edhe i vdekur	
llavi armiqtë me sit	260
e, pas çë ikën, pra ra. -	
E t'u thuash shoqëvet mi:	
- Pal Golemi së vdiq;	
po e rëzofit zëri i luftës,	
e po klofshin me ju	265
krahu, kordha e zëmëra e tij. -	
Nani, Bal, nd'atë lis	
virë lavutën e kumburën,	
shtoji karkalin të zeshk	
e mbi ta kordhën time.	270
Pra, kurë dielli shkëlqeft	
e me rëmbat i stëlloft,	
nka shkrepimazit të tire	
rafshin piksur me tarak	
sa m'u trëmbën ndë jet;	275
e ndër qetmet e natës	
ata hekura e çeliku,	

e ia derdha përmbi faqe.	245
Ai u shtriq me psherëtimë	
si njeri në gjumë të rëndë,	
tundi kryet e m'u kthye;	
si më njohu, pa lëngim,	
me një zë të thellë më tha:	250
“Lër të vdekurit në vend,	
lërmë të fle për gjithmonë	
te ky shtrat i nderit tim,	
mu tek eshtrat e të vdekurve,	
që janë vrarë prej kësaj dore	255
e gjithmonë më janë kurorë.	
Na këtë flamur e Mbretit	
të m'i thuash këto fjalë:	
- Pal Golemi edhe i vdekur	
i tmerroi armiqtë me sytë	260
e, si ikën, pra ai ra, -	
E t'u thuash shokëve të mi:	
- Pal Golemi nuk ka vdekur,	
zëri i luftës do ta ngrejë,	
e do jenë gjithmonë me ju	265
krahu, kordha e zemra e tij. -	
Tashti, Balë, në atë lis	
var mburojën dhe kumburën,	
shtoju karkalin e zi	
e mbi to edhe kordhën time.	270
Pra, kur dielli të shkëlqejë	
e me rreze t'i qëllojë,	
prej shkreptimave të tyre,	
kapur tmerrit, do të bien	
gjithë sa m'u trembën në jetë;	275
e në qetësinë e natës	
ato hekura e çeliku,	

tundur erës e Mokreut, klofshin një ushtrë gjall e e tër qenit qasur nd'errësiir.”	280
Foli e kriet i ra ndë gji, shtrëmboi sit e u resht ndë dhe me të gjithën kurmëri.	
U u ngreva, se m'u sos, e prej shoqëvet u prora, sa t'i stisënjim një varr. I prosekta atje posht, tue prën një të lavosur, bër djepën me llor.	285
Pra çë u afruan, më zu zali, tek pash qiftin t'arët, cepngrehur, krahshtuell mbi atë karkal halkomi.	290
Ish i bardh si një qëri, kriet njomur mbi mushk, helqur grundën për dhe, gjaku i hidhej pik-pik shirit hapët si shëg, mbledhur gjellën ndë si.	295
Si më pa, me lipisi më vërrejti e më qeshi: “Mos më klaj, vëllauthi im, mos më klaj ndë zulmën time, ndë këtë dit flamurare, ndë këtë dit e Arbrit tën!	300
Po priru ushtrës e t'i thuash, e t'i thuash edhe Darës: - Malli i mirë ndë trimëri isht si valët e hëlnarit; Niku dhëndërith i ri	305
	310

tundur erës së Mokreut, ushtri e gjallë do t'i duken qenit të qasur në errësirë.”	280
Foli e kryet i ra në gji, shtrembëroi sytë e përdhe me tërë kurmin u shtri.	
Unë u ngrita, se m'u sos e nga shokët më t'u ktheva, që t'i hapnim tok një varr. Aje poshtë m'i zuri syri, duke prurë një të plagosur; tezgën bërë kishin me llërë.	285
Si u afruan, u zalisa, kur pashë giftin e artë, sqepin ngritur, krahët hapur mbi atë karkal prej bronzi.	290
Ishte i bardhë si qiri, kryet varur i ish mbi shpatulla, grunda i ngiste përdhé, gjaku i rridhte pikë-pikë qafës së hapur si shegë, jeta mbledhur i ish në sy.	295
Si më pa, me dhembshuri më vërejti e buzëqeshi: “Mos më qaj, vëllathi im, mos më qaj në zulmën time, në këtë ditë flamurtare, në këtë ditë të Arbrit tonë!	300
Po në ushtri priru e thua ju e t'i thuash edhe Darës: - Malli i mirë në rini është si vajtë e kandilit; Niku dhëndërit i ri	305
	310

ndërroi darësmet për luftën e kangjelet për Valkal. Njëqint qen m'u viershuan e të qint han bot; pra Badheri gënjëtari për së largu më stëlloi.- E t'i thuash edhe mëmës: - Niku u nis e do mënonj; e ti, mo, mos m'e prit, pse për birëthin, çë sbore, po një bilëz të la, t'e paç truar për mon! - Ngjitu pra mbi lakoten, të m'i falesh së bukurës, së bukurës e Lalës, tek-ai çë më llojasën, më llojasën me zëmërën: - Këtë unaz të dërgoi Niku it, se t'u martua, u martua me një plak, me një plak keq e zez, e ti, e bukurë, t'i martonesh.”	315
Sosi fjalën e m'u shua si hëlnarëthi pa val, si një lulëz e këputur, se edhe veshkët ka merë.	320
Tek-ai çë llojasim t'i varrosim ndë varr, më-kët'an urës një vash na u dëftua si një hje. Kish kripët ndërliksur, sit humbur ndë ball, me cilonëzën xarr-xarr	325
	330
	335
	340

dasmën e ndërroi me luftën edhe vallet me Valkalin. Njëqind qenër m'u vërsulën e të njëqind dhë po hanë; por pastaj Badher tradhtari që nga prapa më qëlloi.- E t'i thuash edhe mëmës: - Niku u nis e do mënojë; por ti, nënë, mos e prit, se për birthin, që humbe, një bijëz ai të la, ty ta ka truar për jetë! - Pra lart ngjitu në çardak, nuses sime të m'i falesh, vashës së bukur të Lalës, ndërsa ajo më kujton, më kujton me zemër-o: - Këtë unazë ta dërgoi Niku yt, se t'u martua, t'u martua me një plakë, me një plakë keq të zezë, e ti e bukur t'i martohesh, -	315
Sosi fjalën e m'u shua si kandili, kur s'ka vaj, si një lulez e këputur, që edhe e fishkur erë mban.	320
E, ndërsa ne po mendonim që në varre t'i mbulonim, përkëtej urës një vashë na u dëftua si një hije. Flokët i kish të ndërliksur, sytë të futur thellë në ballë, me fustanin copë-copë	325
	330
	335
	340

e me këmbëzit përgjakur:	
“Se ju, ushtorëz, vëllezër,	345
se po klofshit të lum!	
Pat, thomse, ndë këtë fush	
një nkalorëth të ri	
me një karkal të arët,	
tek qifti fluturon?	350
Ari i karkalit përzihet	
me një grundëz të blerëme,	
e me ballëtë si dielli,	
ka di si si di shkëndile,	
di shkëndilez e shkeptimës,	355
e ka golëzën unaz	
edhe fjalëzën të ëmbël	
posi holi i paraverës...	
Mbre! Ju lus m’e kallëzoni!”	
Na u vërrejtim si ndër si,	360
se na u mbitën ndë lot,	
helmit buza na u qep.	
U verdhua, na vështroi	
e u pruar e, sa pa	
të vdekurin ndë dhe,	365
shtu një thirm e nkrah i ra	
e fëtohet si borë.	
Vam t’i flisim, s’u përgjeq;	
vam t’e ngisim, nëng u smol;	
vam t’e ngriim e na vdiq.	370
Zëmëra e plot Nikut saj,	
ritur mallit e hares,	
pra që u rënd ai helm i keq,	
më ng’e nxejti e iu plas.	
Jan di varre ndë Valkal,	375
fle te njeri Pal Golemi	

e me këmbëtë përgjakur:	
“O ushtarë, o vëllezër,	345
ju përherë të lumë qofshi!	
Mbase patë në këtë fushë	
një kalorës trim të ri	
me një karkal-o të artë,	
ku një qift i fluturon?	350
Ari i karkalit përzihet	
me një grundëzë të verdhë,	
e ka ballin porsi dielli,	
ka dy sy si dy shkëndija,	
dy shkëndija të shkrepitës,	355
e ka gojën si unazë,	
edhe fjalëzën të ëmbël	
porsi hojet e pranverës...	
Oh, ju lutem, më tregoni!”	
Ne u vërejtëm sy ndër sy,	360
në lot sytë na u mbytën,	
helmi buzën na e qepi.	
Ajo u zverdh e na vështroi,	
e u kthye dhe, sa e pa	
të vdekurin përdhe shtrirë,	365
dha një britmë e në krahë	
e ftohtë si borë i ra.	
Vamë t’i flisnim, s’u përgjigj,	
vamë ta preknim, nuk lëvizi,	
vamë ta ngrinim e na vdiq.	370
Zemra e mbushur me Nikun e saj,	
rritur me mall e hare,	
si u rëndua helmit të keq,	
më s’i nxuri dhe i plasi.	
Janë dy varre në Valkal;	375
fle te njëri Pal Golemi	

e mbi të u bi një lis
me të gjith fletat zeza.
Fle te tjetëri Nik Peta,
Vasha e Lalës i fle nd'an, 380
se si dehshin ndë jet,
ashtu duhen nën dhe;
e iu bi një qepariz,
e iu bi një mollë e bardh!
Kurë të thahet qeparizi, 385
edhe thahet molla e bardh!
Mori bil, bil e Lalës,
mori e bukurëz, e mbriturëz,
pse më solle ndë mon shkua?

S O S I

e mbi të mbiu një lis
me gjethet gjithë të zeza.
Fle te tjetri Niku i Petës,
vasha e Lalës i fle pranë, 380
se, si u deshën në jetë,
ashtu duhen edhe nën dhé;
atje mbiu një qiparis,
mbiu edhe një mollë e bardhë!
Kur të thahet qiparisi, 385
do thahet edhe molla e bardhë!

Mori bijë, bijë e Lalës,
moj e bukur, e trishtuar,
pse më çove në kohë të shkuar?

FUND

F J A L O R T H

Shkurtimet

as. = emër i gjinisë asnjane.
dësh. = mënyrë dëshirore.
f. = emër i gjinisë femërore.
jokal. = folje jokalmtare.
kal. = folje kalimtare.
lidh. = lidhëz.
m. = emër i gjinisë mashkullore.
mb. = mbiemër.
nd. = ndajfolje.
pakr. = e pakryer.
par. = parafjalë.
pasth. = pasthirrmë.
përmb. = emër përmbledhës.
pj. = pjesore.
pjesëz = pjesëz.
pldh. = përëmër lidhor.
ppac. = përëmër i pacaktuar.
sh. (numër) shumë.
urdh. = mënyrë urdhërore.
vetv. = (diatezë) vetvetore (= joveprore).

adhiasëm (i) mb. = i rregulluar.
ahëm (i) mb. = i fuqishëm, trim.
ahj (shih zë ahj).
ain-i m. = shqiponjë
aj (shih marr aj).
akcili ppac. = akëcili, ndokush.
aksëm (i) mb. = i shkathët, guximtar.

akul-i m. = shigjetë.
 ailëmeno pasth. = vaj! medet!
 amah-i m. = luftë, betejë.
 andaj nd. = (që) andej, andaj.
 angonë-a f. = kënd, skaj.
 angurë-a f. = zinxhiri i anijes.
 apolë-a f. = lindje.
 aposhtaz nd. dhe mb. = poshtë, i poshtëm.
 Arbër-i m. = Arbëri-a, Shqipëri-a.
 arbëresh (i) mb. dhe em. = arbëresh, shqiptar.
 arçer (i) mb. guximtar, ngërrestar.
 argomë-a f. = ugar.
 arse-nj kal. = largoj, ndjek.
 arsi-s ~ arsi-t-a kal. mohoj, ndaloj.
 arshër-a f. = ushtëri.
 arrënj jokal. = arrij.
 asipra nd. dhe mb. = sipër, i sipërm.
 asten-i m. = hosten, shkop.
 atëri-a f. = atdhe.
 atihi-a f. = mjerim, fatkeqësi.
 athun nd. = më kot.
 besëm (i) mb. = besnik.
 bëgat (i) mb. = i pasur.
 bëmë-a f. = gjest, vepër heroike.
 bërrim-i m. = britmë.
 bier ~ bor-a kal. = humbas.
 bil-i m. = bir.
 bilë-a f. = bijë.
 bisgël-a f. = pizgë, curril, çurg (këtu: plot).
 botë-a f. = tokë, dhe.
 bretëk-u (sh. bretëq) m. = mashkulli i bretkosës.
 brimë-a f. = brymë.
 brumbull-i m. = brumbull, zhurmë.

brumbullisur pj. = goditur nga rrufeja.
buhua ~ buho-i m. = pluhur.
bular-i m. = bujar.
bulëreshë-a f. = bujareshë.
bulëri-a përmb. = bujari-a.
burg-u m. = kështjellë.
buro-n jok. = buron, rrjedh me shumicë, tepron.
buruam (i) mb. = i shumtë.
bushtër (i) mb. = i egër, nizor.
bushtëri-a f. = mizori-a.
bushtëronet vetv. = egërsohet
cabie-a f. = shpatë, pallë.
cep-i m. = sqep.
cëno-nj kal. = qëlloj, godis, plagos.
(ndë) cik nd. = shpejt.
cikëz-a f. = zog kryezi i familjes së bilbilave.
cilis-em vetv. = dridhem (nga frika).
cilonë-a f. = kotull, fund.
cinor-a f. = qepallë.
ciqe-ja (shih cikëz-a).
citur pj. = ngirë, ngopur.
çë pldh. dhe lidh. = që.
çëdo ppac. = disa.
çëmo-nj kal. = përçmoj, qortoj.
ço-nj kal. = gjej.
daft dësh. = dashtë.
dej pakr. = donte.
dëlpëko-nj kal. = palos.
dërmak-a f. = thërrime, drudhe.
djalishk-u m. = djalëth.
do ppac. = do, disa.
domat-i m. = demet, vandak.
drangua ~ drangor-i m. = dragua.

dre-a f. = droje.
dredhuri-a f. = dredhë, erë e marrë që fryn duke u sjellë rrotull.
drejt (i) mb. = i djathtë.
drem (i) mb. = i tmerrshëm, i frikshëm.
dreq nd. = drejt, djathtas.
dri-a (shih dre-a).
droe-ja f. (shih dre-a).
dromidhe-ja f. = qilim, sixhade.
drosi-a dhe dhrori-a f. = kënaqësi, ushqim.
drovolis kal. = zbatoj.
drueti-a f. = droje, dyshim.
duro-n jokal. = zgjat.
durrudhiar mb. = me flokë kaçurrela.
dhafën-a f. = dafinë.
dhri-a f. = hardhi.
dhrom-i m. = rrugë.
dhrosis kal. = kënaq, ushqej.
dhunuam (i) mb. = i turpëruar, me dhunë.
elefteri-a f. = liri.
ergë-a f. = djallë.
ëndë-a f. = maja e miellit, esencë.
falem vetv. = përshëndes.
fanëm (i) mb. = me fat, fatmir.
farmëk-u m. = farmak, helm.
fekset vetv. = feks, zbardhëllon.
filaqi-a f. = burg.
fillëm (i) mb. = i vetëm.
flamurar mb. = flamurtar, i lavdishëm.
flojerë-a f. = fyell.
fluturakë-a f. = kordele.
forë-a f. = vrull, gjallëri.
forëm (i) mb. = kryelartë.
frais kal. = shkatërroj.

frëshkullo-nj jokal. = fishkëllej.
 frushkull-i m. = shtazë e egër.
 fragamosm-i m. = reçel.
 ftesë-a dhe ftesëz-a f. = faj, gabim.
 gale-ja f. = anije, lundër.
 gavnar mb. = i guximshëm.
 gazavajt-i m. = gazavaj, gëzim i madh.
 gëlar pj. = ngjarë.
 gëlasëmë-a f. = ngjasim.
 gënjëtar mb. = gënjeshtar, i pabesë.
 gëris kal. = përçaj.
 (u) godit vetv. = qëlloi, ndodhi.
 grafomë-a f. = shpellë.
 grahmë-a f. = thirrme, britmë.
 grundë-a f. = flokë, balluke.
 grundzi mb. = flokëzi.
 gùrpar-i m. = kulpër.
 gjallë-t asnj. = të gjallë-t, jetë.
 gje-a f. = gjah.
 gjegj-ënj kal. = dëgjoj.
 gjelbër (i) mb. = i gjelbër, i freskët, i gjallë.
 gjellë-a f. = jetë.
 gjë-a (shih gje-a).
 gjëmë-a f. = gjëmë, gjëmim, rrufe, bubullimë
 gjithalkom mb. = gjoks bronzi.
 gjithoni-a f. = fqinjësi.
 gjithasajtena nd. = gjithandej.
 gjuator-i m. = gjahtar.
 gjuko-nj jokal. = ligjëroj, flas.
 haidhi-a f. = përkëdhelje, gëzim, hijeshi.
 haidhiar mb. = i përkëdhelur, i bukur, i hijshëm, i gëzuar, i qeshur.
 halkom-i m. = bronz.

halnar-i m. = fre, kapistër.
hamodraq mb. = makut, i pangopur.
haps-i m. = burg.
hare-a f. = hare, gëzim.
harepsur mb. = i gëzuar, i dashur.
harom-i m. = para, çmim.
hekurimëti mb. = i hekurt, prej hekuri.
heretis kal. = nderoj, sajdis.
herë- f. = kohë, çast.
hëlnar-i m. = kandil.
hënëtar mb. == hënor, i hënës.
hifitir mb. = ngjyrë hiri.
himë-a m. = greminë, hon.
hisur pj. = skalitur.
hivur-i m. = shpellë, guvë.
hjon-i m. = hon, greminë.
hol-i m. = huall.
horë-a f. = vend, fshat, qytet i vogël.
horiat mb. = vendës.
hroazë- f. = pikturë, ikonë.
humbet vetv. depërton, futet thellë.
humbët (i) mb. = i thellë.
humbëtohem vetv. = trishtohem, dëshpërohem.
humbje-a f. = luginë e thellë.
hundshtuara mb. = hundëngritur.
ier pj. = endur, thurur.
ilë-a f. = ijë.
jes ~ jet jokal. = jetojë banoj, qëndroj.
jetë-a f. = botë, jetë.
kacamite-ja f. = sorkadhe, kaproll.
kaciqe-ja f. = kec-e.
kaluar ~ kalor-i m. = kalorës.
kamastër-a f. = zinxhir.

kamënua ~ kamëno-i m. = tym.
kangjel-i m. = këngë, valle me këngë.
karavë-a f. = lundër, barkë.
karkal-i m. = emblemë zakonisht prej metali, që ngjitej sipër tarozës a përkrenares.
keq nd. = keq, tepër.
kezë-a f. = kësulë kadifeje e kuqe a jeshile, e qëndisur me ar, që vënë në kokë gratë arbëreshe.
kërr-a f. = pulë pa pupla.
këshill-i m. = këshillë, qëllim, mendim.
këshshprishur mb. = gërshetashprishur.
klua-nj kal. = quaj.
kllitur pj. = kallur, këllitur.
kodhele-a f. = rrotullim.
kolloqis kal. = kapërdij, gëlltis.
konë-a dhe konëz-a f. = ikonë.
kopé-a f. = çetë, grup.
kopil-i m. djalë, çun.
kopilëri-a f. = djalëri, rini.
kopilëz-a f. = vashëzë.
kopiz-i m. = tradhtar.
kopus-i m. = mjerim.
koqis kal. = mbledh koqe-koqe.
korrëz-i m. = korrës.
krafosur (i) mb. = i plagosur.
krahrrënkët mb. = krahfortë.
krekëz-a f. = dru i gjinisë së panjajve, që rritet deri 15 m. i lartë.
krip-i m. dhe asnj. = flokë.
kripdrizë mb. = me flokë si driza.
kripshprishur mb. = flokëshprishur.
krisomeni mb. = i qëndisur me ar.
kúcar-i m. = cung, trung.
kufi-a f. = qëllim, mendim.

kukudh-i m. = kolerë.

kumbim-i m. = mbështetje, bazë.

kumburë-a f. = veshje lëkure a metali, që përdorej motit ndër beteja.

kurmëri-a f. = kurm, trup.

kusuvalet vetv. = mendoj.

kuvent-a f. = kuvend.

lakotë-a f. = ballkon, çardak.

langua ~ langor-i m. = lingua.

lavomë-a f. = plagë.

lavosem vetv. = plagosem.

lavutë-a f. = mburojë.

leçit-ënj kal. = botoj.

ledh-i m. = mur kalaje, ledh.

lefë-a f. = luan, luaneshë.

lefëri-a f. = liri.

lefëris kal. = liroj.

lefëros-em vetv. = lirohem.

lemje-a f. = lindje.

lepushë-a f. = (këtu) shkronjë, tingull.

lerëm-i m. = hije, shpirt i keq.

leth nd. = lehtë.

lën (i) mb. = i lënë, i çmendur.

lënësi-a f. = marrëzi, çmenduri.

liga-t f.sh. = të ligat, shtrigat.

limonti-a f. = plogështi, kotësi.

lip-i m. = zi, helm.

lipisi-a f. = dhembshuri.

lipset vetv. mungon.

lipsiar mb. = i dhembshur.

liq (kam) = (kam) të drejtë.

litinjtë-t m.sh. = (këtu) italianët.

livis-em vetv. = nxitoj, iki me nxitim.

los-ënj kal. = shkrij, tres.
losnik-u m. = mallotë, leshnik.
luftarik-u m. = luftëtar i keq.
lun pj. = lënë (nga folja lë).
lur-a = la-sh-ë.
llav-ënj kal. = tremb, shqetësoj.
llavur (i) mb. = i çmendur, i turbulluar.
llojas kal. = mendoj, kuptoj.
llojë-llojë nd. = tufë-tufë.
lloro-nj kal. = përqafoj.
llumbardë-a f. = e shtënë artilerie.
mal (dha) = u kujdes.
margùr mb. = tradhtar.
marmur-i m. = mermer.
martrizë-a f. = dëshmitare.
marr aj = (këtu) kafshoj.
mballa par. = përballë.
mbërritur (i) = (shih: i mbritur).
mbëshon jokal. = rëndon, vjen rëndë.
mblo-nj kal. = mbush.
mblli-nj kal. = mbyll.
mboli-a f. = shartesë.
mbritur (i) mb. = i zyrtë, i hidhëruar.
mek = me kë, me të cilin.
melur pj. = shkruar [= parashikuar].
menat-a f. = mëngjes.
mend-i m. = çast.
mend (ndë) = (në) çast.
merë-a f. = erë.
mënd jokal. = mund.
mëno-nj jokal. = mënoj, vonohem, qëndroj.
mënor-i m. = musafir, mik.
mëruam (i) mb. = i hidhëruar, i trishtuar.

mirencie-a f. = fëmijë.
 mir-këshilli mb. = që mendon mirë.
 mosgjë (njeri) = (njeri) pa vlerë.
 moti i mesëm = koha e mesme, mesjeta.
 movorier (i) mb. = i turpëruar, i nxirë.
 mpërparen vetv. = qëndrojnë përpara.
 mumbitur mb. = i njomur, i ngjyer.
 mumbush mb. = i butë.
 mundje-a f. = mundësi, fitore, fuqi.
 murxhar-i m. = murgjar, murgjan.
 mushk-u (sh. mushq) = sup, shpatull.
 mutafë-a f. = mbulesë kuajsh me lesh dhie.
 naforis kal. = kushtoj, bëj fli.
 nani nd. = tashti, tash.
 ndeje < n-teje (rasë rrjedhore) = teje.
 ndële-nj kal. = ndej, fal.
 ndëlgo-nj kal. = kuptoj.
 ndëlguam (i) mb. = i kuptueshëm, inteligjent.
 ndënd kal. = (këtu) ngrë, vndos.
 ndërloksur (i) mb. = i magjepsur.
 ndihor-i m. = ndihmës.
 ndo-mos nd. = ndoshta.
 ndo se lidh. = ndonëse.
 ndrell-a f. = marramendthi.
 ndreq-em vetv. = drejtohem.
 nenjë-a f. = nyjë.
 ngales-em vetv. = grindem.
 ngalko-nj kal. dhe jok. = ngarkoj, i hipi kalit.
 ngë pjesëz = nuk, s'.
 ngëlat (i) mb. = i gjatë.
 ngëlat-em vetv. = ngjatem, zgjatem.
 nglat (i) mb. = (shih ngëlat).
 ngjeth ~ ngjodh-a kal. = ngjesh, shtrëngo.

nie-ja f. = nyjë (shih edhe nenjë).
ninëz-a f. = bebëza e syrit.
nio-nj kal. = mohoj, nuk pranoj.
nka par. = nga.
nkalko-nj (shih ngalko-nj).
nkall-on-et vetv. = ngallon, lëshon kalli, lulëzon.
nkuq kal. = nguq, skuq.
noeri-a f. = mendim.
nomotis-em vetv. = quhem, përmendem.
noti-a f. = lagështi.
njetër ppac. = një tjetër.
njo pjesëz. = ja! qe!
njom (i) mb. = i dobët.
njom kal. = dobësoj, zbus.
ofiqi-a f. = fyerje.
oht-a f. = ngrohtësi, zagushi, afsh.
opolips-i m. = urtësi, arsyë.
oratë-a f. = uratë, bekim.
ordonkaf-i m. = gjembaç.
pafanëm (i) mb. = i pafat.
paftesëm (i) mb. = i pafaj.
pakluar (i) mb. = i panjohur, i pafamë.
pallojasur (i) mb. = i pavënë re.
pameta nd. = përsëri.
pandëlesëm (i) mb. = i pafalshëm.
pandëlgim (i) mb. = i pamend, budalla.
pandëlguam (i) mb. = i pakuptuar, i panjohur.
papërzet mb. = i papërzier.
paproseksur (i) mb. = i padalluar.
paps kal. = qetësoj.
papsur (i) mb. = i qetë.
pa pupitur = pa u ndier.
pa u papsur = pa pushuar.

paqërdhesëm (i) mb. = i poshtër, i paturp.
 parathënëme-a f. = parathënie.
 parathirë-a f. = dritare.
 pas-ënj ~ pas-a ~ pas-ur kal. = ndjek, pasoj.
 pashallar-i m. = pasha.
 pashishëm (i) mb. = i pandjeshëm.
 pataks-em vetv. = hidhem, vërvitem.
 patërshor-i m. = patërshanë.
 pelator-i m. = sorkadh, kapoll.
 peleqis kal. = copëtoj.
 perëndeshë-a f. = perandoreshë.
 perëndi-a f. = perandor.
 perivol-i m. = kopsht.
 petëk-u m. = pronë, pasuri,
 pëlhurë-t f.sh. = vela-t.
 pëlor-i m. = pluar.
 përbashkur (i) mb. = i bashkuar.
 përderës-i m. = përderës, lypës.
 përdishëm (i) mb. = shumë i ditur.
 përlip-em vetv. = pikëllohem, vishem në të zeza.
 përlipëm (i) mb. = i përzishëm.
 përpar-ënj kal. = nxjerr përpara, paraqis.
 përthom kal. = përsëris.
 përvesh kal. = (këtu) përkthej.
 përvesh-em vetv. = pështjellohem, trazohem.
 përveshur pj. = pështjelluar, trazuar.
 përzi-h-em vetv. = bashkohem.
 përzit-a f. = bashkim.
 pështëlluar pj. = mbështjellë.
 piell-i m. = grykë mali, shteg.
 (tue) pier = duke pyetur.
 pies nd. = pjesërisht.
 pik (i zu) = (i ra) pika.

piks kal. = mpiks, bashkoj.
 piksur (i) mb. = i ngrirë.
 pîrg-u m. = pîrg, kullë.
 pîrgjim-i m. = kalbësirë, qelbësirë.
 pis-a f. = ferr.
 pisëruam (i) mb. = si prej ferri.
 plono nd. = plot.
 po nd. = gjithmonë.
 poli-a f. = dhomë.
 ponis kal. = nderoj, respektoj.
 ponisëm (i) mb. = i nderuar.
 porsun-a-t f.sh. = porosi-të.
 porr-i m. = bulë.
 pra nd. = pastaj.
 pra çë lidh. = pasi.
 prana nd. = pastaj.
 prapathënëme-a f. = pasthënie.
 preivestar-i m. = pararojë.
 prej par. = prej, drejt, për, afër
 prënk-u m. = princ.
 prërët (i) mb. = i prehur.
 prir-em ~ u pror-a vetv. = kthehem.
 proft-i m. = liman, skelë.
 proseks kal. = vështroj, shoh.
 puhiz-a f. = puhi, fllad.
 qell kal. = sjell, shpie.
 qesho-nj kal. = tall, përqesh.
 qet-em vetv. = hesht.
 qetëm (i) mb. = i heshtur, i qetë.
 qetmi-a f. = heshtje, qetësi.
 qëlloi (gjum) = zuri (gjumi).
 qëlluar (i) (ndë gjum) mb. = i përgjumur.
 qëndris kal. = çpoj, nxis, cys.

qift-i m. = fajkua.
qitherëz-a f. = turtulleshë.
qosëm (i) mb. = i pasur.
qullo-nj kal. = përgjum.
qush-i m. = fshatar (i ulët).
rahj-i (sh. rehje) m. = kodër,
rap-i m. = korb.
rasbis kal. = shpartalloj, thyej keqas.
ratikë- f. = barishte.
rehje-rehje = kodër më kodër.
resht kal. = shtrij, largoj.
resht-em vetv. = shtrihem, largohem.
rezeh-u m. = gjigant.
rëfiks-et vetv. = fishket, thahet.
rëkut-em vetv. = strukem, futem.
rëmaksëm (i) mb. (shih: i rrëmaksëm).
rëmor mb. = i poshtër.
rëzo-nj kal. = zgjuaj, ngre.
rimët (i) mb. = i kaltër.
rimët-a-t (të) f.sh. = hapësirat e kaltra të detit.
rogomin-a f. = greminë, hon.
rogomis-em vetv. = rrokullisem.
rolje- a f. = përpjekje.
ropi-u m. = rob.
roposi-a f. = formë (pamje) njeriu.
ruiz-i m. = ruajtës, rojë,
rus-em vetv. = zbres me vrap.
rrahader-i m. = endacak.
rreth-ur (i) mb. = i rrethuar.
rreks-i m. = div, gjigant.
rrëmaksëm (i) mb. = i vrazhdë, zemërak.
rrëmb-i m. = rreze.
rrëni-a f. = të ulurit, ulje.

rrënkët (i) mb. = i shëndoshë, i fuqishëm.
 rëzo-nj (shih: rëzo-nj).
 rrieth ~ rrodh-a jok. = bredh.
 rimët (i) (shih: i rimët).
 rruaz-a f. = perlë.
 salaftog-a f. = gjineshtër.
 sanua ~ sano-i m. = bar i thatë, sanë.
 saravilusht mb. = i mëndafshët.
 sbeit (ndë) nd. = befas.
 sbeit (i) mb. = (këtu) i marrë, i çmendur.
 sbier ~ sbor-a kal. = zbjerr, humbas.
 sdredh-em ~ u sdrodh-a vetv. = kthehem ~ u ktheva.
 sdredhur (i) mb. = i kthyer, i ndryshuar.
 sdreq-em vetv. = zdergjem, bie me barrë.
 se = 1) se; 2) që; 3) o!
 serpos-et vetv. = ngryset.
 sfal jok. = gaboj, bëj gabim.
 sfeluk-em vetv. = zhdukem
 (u) sfluks vetv. = u zhduk.
 sfrajis kal. = shkatërroj.
 sgardhëlluar pj. = zgurdulluar.
 sgëleth ~ sgëlodh-a kal. = lexoj, zgjedh.
 sihjeni-a f. = qelbësirë.
 sinor-i m. kufi.
 sivas-ënj kal. = bind, kënaq, ngushëlloj.
 sivasur (i) mb. = i pëlqyer.
 sivon-a f. = pamje, fytyrë.
 si-vo-th-in m. = syth-in (sy).
 skakumis kal. = thyej.
 spakërdhiks-ënj jok. = hidhem përpjetë.
 skareps kal. = hidhëroj, zemëroj.
 skondaps kal. = shqetësoj.
 smol-ënj kal. = ngre lart.

somenat nd. = sot mëngjes.
 sonëm (i) mb. = i sotëm.
 sosur uri = i uritur.
 spav-em vetv. = zhdukem.
 spell-a f. = shpellë.
 sprasëm (i) mb. = i fundit.
 spudhi-të f.sh. = studime-t.
 sqot-a f. = stuhi.
 stamëng (ndë) = në të majtë, nga e majta.
 stavar-i m. = shulicë, direk.
 ster-i m. = pallat, oborr.
 stigmi-a f. = çast.
 stihji- f. = stih.
 stëllo-nj kal. = qëlloj, hedh heshtën.
 stil-i m. = heshtë, shtizë.
 stis kal. = ndërtoj, bëj.
 stog-u m. = hut, buf,
 stoli-a f. = stoli, veshje.
 streh-em vetv. = endem, vij rrotull.
 streks kal. = (këtu) mendoj.
 sukulis-em vetv. = (këtu) nxitoj, shpejtoj.
 suval-a f. = dallgë, valë.
 shapëk-a (edhe shapëkëz-a) f. = përkrenare, helmetë.
 shëndet-ja f. = shpëtim.
 shëndo-h-em vetv. = vrenjtem.
 shënduam (i) mb. = i shëmtuar.
 shënk ~ shëng-u m. = shenjë, simbol.
 shërbes-i m. = send, gjë.
 shir-i m. = zverk, qafë.
 shkarze-nj kal. = përbuz, përçmoj.
 shkept-i jokal. = shkrepëti-u.
 shkëlboz-a f. = copëzë (metali etj.).
 shkëluhëz-a f. = pushkë.

shkëndil-a f. = shkëndijë.
 shkëndie-n jokal. = shndrit, shkëlqen.
 shkëndier (i) mb. = i shndritshëm.
 shkëptim-a f. = shkrepimë, vetëtimë.
 shkler-i m. = sllav, serb.
 shkluam (i) mb. = i shquar.
 shkrëmb-i m. = shkrumb, zjarr më të shuar.
 shkruaz-i m. = shkrues.
 shpërvier-i m. = tendë, çadër.
 shpi-h-et vetv. = shtjellohet.
 shprior ~ shprior-a kal. = rikthej, shpërndaj etj.
 shprish kal. = shpërndaj.
 shqep-i m. = napë e hollë, cipë e hollë.
 shqer-a f. = copë, thelë.
 shqerr (i) mb. = i shqyer, i grisur.
 shqipun-i m. = sqifter.
 shqit-a f. = pjerrësi.
 shtrëmbër nd. = majtas.
 shtrëmbo-nj kal. = shtrëmbëroj.
 shtrush-i m. = zhurmë.
 shtuara nd. = në këmbë.
 shtu-n kal. = (ata) shtinë.
 taksur (i) mb. = i premtuar.
 tarak-a f. = tmerr, tronditje.
 taraks kal. = bëj dikë të dridhet.
 tas pjesëz = ja! qe!
 tat-a m. = atë, babë.
 tejadhen (deiti) = (deti) përtej dheut [=deti Jon].
 tek-ai çë lidh. = ndërsa.
 tër-i m. = dem.
 tëtimit-i m. = të ftohtë-t.
 tramaksur (i) mb. = i tmerrshëm
 trapos kal. = ndreq, rregulloj.

trashëgim-i m. = gëzim, kënaqësi.

trëmbësar mb. = frikacak.

trimëri-a përmb. = rinia, trimat.

triqimi-a f. = zhurmë.

trivosi-a f. = fatkeqësi, mjerim.

trizet = gjashtëdhjetë.

true-nj kal. = porosis, jap të ruhet.

tru-h-em vetv. = lutem.

thamas kal. = habis, çudis.

thelim-a f. = leje, mundësi.

thell-a f. thellësi.

thiello-nj kal. = kthielloj.

thiellt (i) mb. = i kthjellët.

thomse pjesëz = ndoshta.

ungjël-i m. = ungj.

ur-i m. = urë zjarri.

ushtër-a f. = ushtri.

uvri-u m. = urth.

vabëk mb. i vobektë.

val-t asnj. = vaj.

varfër (i) mb. = bonjak, jetim.

varrom mb. = erëqelbur.

vel-a f. = thellësi.

veshkët mb. = i fishkur.

veshshtuara mb. veshngritur.

vet nd. = vetëm.

vëldim-i m. = lëvdim.

vëldor mb. = mburracak.

vëlduar (i) mb. = i lëvduar.

vëronj-a f. = drizë.

vien-me-rar = do me thënë.

vien-me-thën = do me thënë.

vierr pj. = varur, vjerrë.

vietur (i) mb. = i braktisur.
virë urdh. = var!
vjersh-i m. = varg, pamje.
vllak-u m. = lajmëtar, i dërguar.
vllamje-a f. = vëllazëri.
voli-a (dhe voliz-a) f. = faqe.
volimoll mb. = faqemollë.
volinkuqur mb. = faqueskuqur.
vorë nd. = vonë.
vukull-a f. = mbërtheckë, kapëse.
vulak-u (sh. vuleq-e) = brazdë, vijë uji.
vrap nd. = shpejt.
vrel-/vriel (sh. vrile) = xunkth.
xa pasth. = na!, ja!
xarris kal. = zvarris.
zahar-i m. = sheqer.
zakonis-et vetv. = bëhet zakon, përdoret.
ze-a f. = shpirt.
zeks-i m. = zekth, trill, dëshirë.
zeps kal. = fus/shtie në zgjedhë.
zeshk (i) mb. = i zi.
zë ahj kal. = kafshoj.
zëgua ~ zëgo-i m. = zgjedhë.
zmol-ënj kal. = ngrë në këmbë, turbulloj.
zografisur pj. = pikturuar.
zotëri-a f. = zotërim, sundim.
zulm-a f. = famë, lavdi.

Gavril Dara (i Riu)
KËNGA E SPRASME E BALËS
2006

Botues
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
Valon Fetahu

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 16¼ tabakë shtypi
Tirazhi: 500 copë
Formati: A5 (14x20 cm)

Shtypi:
GRAFOPRINT
Prishtinë

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-13

Dara, Gavril (i Riu)

Kënga e sprasme e Balës / Gavril Dara (i Riu), transkribuar dhe përshtatur në shqipen e sotme nga Shaban Demiraj. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2006 (Prishtinë : “GrafoPrint”). - 260 f. ; 21 cm. - (Botime të veçanta LXXV) (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë : Libri 32)

Dy fjalë / Shaban Demiraj : f. 9-10. - Gavril Dara ... / Shaban Demiraj : f. 11-40. - Literaturë e përzgjedhur : f. 41-43. - Fjalorth : f. 241-259

ISBN-13: 978-9951-413-52-7
ISBN-10: 9951-413-52-8